



**5** Kosova me strategji për lobim



**13** Dhuna në shkollë-dukuri...



**17** Studentët blejnë testet e provimit



**28** Rrethimi i Konstantinopojës



**32** Fenomeni i dihatjes së qenit

**Portreti i muajit:** Fitimtar drejt qëllimit ..... 2

**Avni Avdiu:** Arvizu-Dell-Riker ..... 3

**Osman D. Gashi:** 'Kërko shumë, që të marrësh diçka!'.. 4-5

**Muhamet Jahiri:** Kosova me strategji për lobim 5-6

**Mr. sc. Flamur Hyseni:** E drejta për shtetësi dhe sfida për ta fituar atë..... 7-8

**Astrit Rrahmani:** Kushtetuta apo vetëdija që duhet ndryshuar..... 9

**Besnik Boletini:** Varfëria skllavëron fëmijët..10-11

**Arta Jusufi:** Rreth një mijë krime nga të miturit 12

**Përparim Bublaku:** Dhuna në shkollë - dukuri shqetësuese për të gjithë ..... 13

**Lulzim Ahmeti:** Mosmarrëveshjet me FMN-në në pasojë zinxhirore.....14-15

**Drita Vitia:** Maturantët shpresojnë në arritjen e suksesit.....16-17

**Drita Slivova:** Studentët blejnë testet e provimit... 17

**Lumnije Maloku:** 300 euro për master, nuk pritet ulja e çmimit..... 18

**Fatos Shala:** Qumëstharët në krizë .....18-19

Intervistë me Vlora Çitakun.....20-22

**Ndriçim Hoxhaj:** Kriminaliteti kërcënon turizmin ..23-24

**Linda Berisha:** Kur mbarojnë hetimet? ..... 24

**Arsim Jonuzi:** Erdogani shënoi sërish fitore ..... 25

**John Esposito:** Fjalimi i Obamës për Lindjen e Mesme: një hap i rëndësishëm përpara, por një rrugë e gjatë për të shkuar ..... 26

**Adelina Avdullahu:** Mes jetës dhe të vërtetës..... 27

**Muhamed J. Kajolli:** Rrethimi i Konstantinopojës .28-31

**Prim. dr. med. sc. Ali Iljazi:** Fenomeni i dihatjes së qenit.....32-34

**Mr. ph. Gzonit Salihaj:** Sëmundjet ngjithëse të sistemit të tretjes.....34-35

**Valon Gërbeshi:** Jetë studentore, me një "ëndërr" të vetme jetësore ..... 36

Intervistë me Burim Mexhuani .....37-38

**Albion Sherifi:** "Dyshimi karteziian" ..... 38

**Naser Shatrolli:** Besoj në filmin vendor..... 39

**Alban Bilalli:** Premtimi u bë realitet, Majlinda mbron ngjyrat e Kosovës..... 40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,  
KULTURË, ARSIM, ETIKË  
Viti VI / Nr. 55  
19 qershor - 19 korrik 2011  
Botues  
Zëri Ynë  
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor  
**Muhamed Jusufi - KAJOLLI**  
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës  
**Avni AVDIU**  
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës  
**Flamur MALOKU**  
flamuraloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika  
**Osman D. GASHI**  
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore  
**Mimoza SINANI**

e-mail:  
revistapaqja@gmail.com  
revistapaqja@hotmail.com  
http://www.zeri-yne.org

Adresa:  
**Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,**  
**përballë teatrit Dodona,**  
**Prishtinë, Kosovë**

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

# FITIMTAR DREJT QËLLIMIT

**A**li Ahmeti u lind më 4 janar të vitit 1959, në fshatin Zajaz të Kërçovës së Maqedonisë. Angazhimin e tij politik e filloi prej shkollës së mesme, duke arritur qysh atëherë të vendoste përdorimin e gjuhës shqipe në gimnazin e tij në Kërçovë. Në vitin 1979 i filloi studimet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës, ku diplomoi më 1983. Gjatë viteve 1981 dhe 1983 u bë ndër bartësit e lëvizjes studentore, qëllimi i së cilës ishte përmirësimi i statusit politik të shqiptarëve në Kosovë dhe Maqedoni. Ndhimoi në organizimin e protestave studentore në Prishtinë, aktiviteti i cili kulmoi me arrestimin dhe dënimin e tij me një vit burg. Në vitet 1984/86 ka ndihmuar në ripërtëritjen e lëvizjes studentore dhe popullore në Kosovë. Në vitin 1986, Ahmeti fitoi azil politik në Zvicër, ku jetoi deri në vitin 2001 dhe veprroi si koordinator i grupeve të ndryshme il-

gale. Në vitet 1988/89 ai ishte njëri nga udhëheqësit e protestave të minatorëve dhe studentëve, të cilat për herë të parë e sfiduan më seriozisht regjimin e Sllobodan Miloseviqit. Në vitet 1989/90 ai ka qenë njëri nga organizatorët e protestave masive të diasporës shqiptare nëpër Evropë. Mbështetjen e tij politike gjatë këtyre viteve Ahmeti e ka pasur në Lëvizjen Popullore të Kosovës. Në vitin 1986 ai u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, me detyrë ndërlidhjen ndërmjet Kosovës dhe Evropës. Në vitin 1988 u zgjodh anëtar i Kryesisë së Lëvizjes Popullore të Kosovës, funksion në të cilin u rizgjodh më 1993, me detyrë speciale sektorin ushtarak. Në vitin 1996, në vllugun e rritjes së presionit dhe dhunës kundër shqiptarëve të Kosovës, Ahmeti ka qenë njëri ndër themeluesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në fillim të luftës më 1998, u zgjodh anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të

Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në vitin 2001, Ahmeti u zgjodh Komandant Suprem dhe Përfaqësues Politik i Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni. Pas Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, të nënshkruar në gusht dhe shpërbërjes së Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, në shtator atij viti, Ahmeti u angazhua aktivisht në procesin e implementimit të Marrëveshjes Kornizë. Për këtë qëllim, në fillim të vitit 2002 ai e inicioi Këshillin Koordinues që bashkonte partitë politike shqiptare në Maqedoni dhe strukturat e mëparshme të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në një platformë të dizajnuar për ta shtyrë përpara implementimin e marrëveshjes paqësore. Në qershor të vitit 2003, Ahmeti e themeloi Bashkimin Demokratik për Integrim dhe u zgjodh kryetar i kësaj partie. Në shtator të vitit 2002, Bashkimi Demokratik për Integrim e fitoi besimin e shumicës dërrmuese të elektoratit shqiptar në zgjedhjet parlamentare të Maqedonisë. Ali Ahmeti u zgjodh deputet i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, ndërsa Bashkimi Demokratik për Integrim hyri në koalicionin qeveritar me LSDM. Në zgjedhjet e 5 korrikut 2006, koalicioni BDI-PPD, që e udhëhiqte Ali Ahmeti, fitoi 17 deputetë. Megjithatë në qeveri hyri partia humbëse në bllokun shqiptar PDSH, gjë që e iritoi BDI, e cila kërkoi zgjedhje të parakohshme parlamentare 2008, të cilat i fitoi me moton 'Me ne fitimtar'. Në zgjedhjet e sivjetme, BDI-ja, me në krye Ali Ahmetin, i fitoi përsëri zgjedhjet, duke lënë nën hije gjashtë partitë e tjera shqiptare dhe duke marrë pjesën dërrmuese të votave të elektoratit shqiptar. Ali Ahmeti arriti të përballonte valën e fuqishme të kritikave të oponentëve, shpifjet e PDSH-së për dosjet e fabrikuara dhe një mori akuzash të tjera për pasivitet dhe mosangazhim të duhur. Përderisa pritej që thumbat e kritikës të dëmtonin seriozisht BDI-në, vota e popullit e befaso i shumicën e politikanëve dhe analistëve. Edhe kësaj here kritikati i bën hajr Ali Ahmetit dhe e forcuan pozicionin e tij. Moto e tij kësaj radhe ishte 'Bashkë drejt qëllimit'. Duke e lidhur me moton paraprake, mund të thuhet se Ali Ahmeti po shkon si fitimtar drejt qëllimit të tij, qëllim rreth të cilit janë bashkuar shumica e votuesve shqiptarë në Maqedoni. ■



Porterti i muajit

# Arvizu - Dell - Riker



## Avni AVDIU

**S**'kam idenë se çfarë do të kishim bërë pa amerikanët. Pa hyrë shumë në histori vlen të kujtojmë vetëm qëndrimin kur presidenti Uilson (1856-1924) mbrojti me këmbëngulje interesat territoriale të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Versajë (1919-1920) dhe ndihmën e gjithanshme gjatë luftës së fundit të vitit 1999.

Në turbulencat e ndryshme politike, adresa e parë e orientimit për ndër-mjetësim është ambasada amerikane: në Shqipëri Aleksandër Arvizu, në Kosovë Kristofer Dell dhe në Maqedoni Filip Riker. Kështu formula më efikase që tashmë funksionon është pikërisht formula Arvizu-Dell-Riker. Ambasadat amerikane janë bërë çelësi i vetëm i zgjidhjes së kontesteve të ndërsjella ndërpartiake. Ato kanë kredibilitetin e mjaftueshëm për të stopuar shkarjen e ngërçeve politike në kahun e padëshirueshëm.

Për çfarëdo problemi politik, pyetja e parë që shtrohet është: 'çfarë thotë për këtë ambasada amerikane', big brother-i ynë. Prononcimi i kësaj ambasade merret si i mirëqenë, si fakt që duhet respektuar dhe një e vërtetë e pakontestueshme. Kush guxon pastaj të thotë se 'nuk pajtohem me mendimin e ambasadës amerikane', ai anatemohe me keq sesa të bënte sakrilegj a blasfemi. Pastaj stigmatizohet nga shoqëria civile

dhe media si një element destabilizues, antidemokratik dhe regresiv. Dhe mirë që është kështu. Po të mos ekzistonte edhe ky autoritet arbitrar, a thua çfarë do të ndodhte në gjithë ato momente kur asnjëra parti s'i lëshon udhë tjetrës, kur secila thirret në të drejtën e saj absolute dhe kur për secilën pala tjetër, siç shprehej Sartri, është ferr.

Nëse shkurtazi i hedhim një vështrim rolit dhe efektit të ambasadave amerikane në neutralizimin e tensioneve politike, shohim se si pa ndihmën e tyre, do të ishte e paimagjinueshme të mendohej se si do të tejkaloheshin disa kriza.

Mirëpo shtrohet pyetja: vallë kjo fuqi e zërit të ambasadave amerikane buron nga frika apo nga respekti, apo nga kombinimi i të dyja elementeve? Nuk ka dyshim se secili subjekt politik është i vetëdijshëm për autoritetin e SHBA-ve te shqiptarët, sa është i vetëdijshëm edhe për fuqinë diplomatike, ekonomike e të gjithanshme të këtij vendi. Kundërshtimi eventual i mendimit të ambasadës amerikane nga cilido subjekt qoftë, do të bartte reperkusione të pariparueshme në opinionin publik. Kjo do të ndikonte në zbehjen e mbështetjes së elektoratit dhe dekompozimit gradual të atij subjekti. Shpesh në zgjidhjen e problemeve involvohen edhe ambasadorë të vendeve evropiane, por jehona e impaktit të tyre në zgjidhjen e kontesteve është e papërfillshme në krahasim me ambasadën amerikane,

ndonëse si Shqipëria ashtu edhe Kosova synojnë integrimet evropiane.

Prandaj në gjithë fatin tonë të keq historik që u desh të kalonim nëpër kapërcyellin e procesit të tranzicionit demokratik dhe faktit se bartës të këtyre proceseve ishin edhe shumë politikanë të papërgjegjshëm, mund të thuhet se fati ynë i mirë ishte që sërish na u gjendenë amerikanët. Pa ndihmën e tyre do ta kishim tejet vështirë t'i tejkalonim disa situata të rënda krizalide me përmasa shkatërrimtare.

Edhe së fundi kur tensionet politike në Shqipëri në mes PS dhe PD janë në vlim të vazhdueshëm, është ambasadori Arvizu që në mënyrë simbolike përvjel mëngët; në Kosovë ishte merita e Dell-it në gjetjen e kompromisit për zgjedhjen e presidentes Jahjaga dhe është Riker në Maqedoni, i cili shpesh i ul kundërshtarët Ahmeti e Thaçi për t'u rrëfyer si te prifti për mëkatet e tyre. Siç shpalosi detaje Wikileaks, Ali Ahmeti i ishte rrëfyer Rikerit se ndihej i pafuqishëm përballë Gruevskit, kurse Menduh Thaçi i kishte thënë se platforma e marrëveshjes së tij të re nuk ishte diçka serioze, por me të kishte vetëm për qëllim ta rriste rejtingun e partisë së tij.

Është mirë kur ka kush i vë gjërat nën kontroll, por edhe më mirë do të ishte që të ngrihej vetëdija dhe pjekuria politike që vetë ta mbanim kontrollin në duart tona. Mirëpo për të ardhur kjo kohë, një herë përnjëherë, pak dritë shihet në tunelin e errët. ■



# ‘Kërko shumë, që të marrësh diçka’

**Në rast se do të arrihet deri tek imponimi për status të veçantë për veriun e Kosovës, pse të mos përdorim parimin ‘kërko shumë, që të marrësh diçka’, që edhe ne, si palë kosovare, të kërkojmë një status të veçantë për shqiptarët që jetojnë në Luginën e Preshevës dhe kësisoj të jemi në ofensivë dhe diplomacia serbe të detyrohet të zgjedhë se çfarë të bëjë?!**

**Osman D. GASHI**

**K**osova gjendet në fazën e bisedimeve ‘teknike’ me Serbinë, të cilat po realizohen nën patronatin e bashkësisë ndërkombëtare, ku edhe përkundër realitetit të ri të Kosovës, Serbia pas tërë atyre shuplakave që ka marrë, duke përfshirë fillimin e bombardimeve e deri te vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e drejtë të pavarësisë së Kosovës, ende nuk merr vesh dhe vazhdon me avazin e vjetër të qëllimeve dhe pretendimeve për zaptimin e territoreve të shteteve të tjera, ku zyrtarë të nivelit të lartë dhe udhëheqës serbë dalin me deklarata duke bërë thirrje për ndarjen e Kosovës. Kjo sjellje politike e udhëheqësve serbë, edhe pas tërë këtij ndryshimi të situatës në Kosovë, është sikurse sjellja e një fëmije të llastuar dhe kokëfortë, që edhe përkundër shuplakave që fiton si peshqesh për shkak të problemeve që bën, ai prapë vazhdon të sillet në të njëjtën mënyrë.

## **Parimi ‘kërko shumë, që të marrësh diçka’ në politikë**

Serbia ndjek një parim në politikën e saj që në shumicën e rasteve ka rezultuar funksional dhe i suksesshëm. Parimi ‘kërko shumë, që të marrësh diçka’ është një parim që përdoret në shumë sfera të jetës, por edhe në politikë gjen zbatimin e tij. Në luftën e fundit, që dërgoi

në shpërbërjen e ish-Jugosllavisë, pas ndërhyrjes nga politika ndërkombëtare, Serbia detyrohej të ulej në tavolinë dhe gjatë negociatave përdorte këtë parim. Marrëveshja e Dejtonit është një shembull i tillë nga e cila rezultoi në ndarjen e Bosnjës e Hercegovinës (BeH) në dy pjesë, ku 51% i takonte federatës së BeH, kurse 49% Republika Serpskës. Kjo situatë ka ardhur pas ndjekjes së këtij parimi nga politika serbe e prirë nga Slobodan Milosheviç. Dhe sot e kësaj dite, BeH nga kjo marrëveshje ndodhet e ndarë. Edhe pse janë bërë disa ndryshime në marrëveshje, prapëseprapë, këmbëngulësia dhe parimi i të kërkuarit shumë që të marrësh diçka nga ana e serbëve, ka bërë që BeH të jetë në gjendje të këtitillë.

## **Shembulli i Kosovës**

Nëse e kthejmë observimin në Kosovë për të analizuar se çfarë ka ndodhur, fare lehtë vërehet sukcesi i parimit ‘kërko shumë, që të marrësh diçka’. Si pasojë e këmbëngulësisë dhe kryeneçësisë së palës serbe, me një fjalë të ndjekjes së parimit që zbatohet në politikën e saj fqinjësore dhe ndërkombëtare, Kosova është e detyruar të zhvillojë vazhdimisht bisedime me Serbinë. Nëse bëhet një kronologji e pasluftës së Kosovës, shihet sukcesi i ndjekjes së parimit ‘kërko shumë, që të marrësh diçka’ nga pala serbe, që në një aspekt tjetër, palën kosovare gjithmonë e ka dërguar në defensivë

dhe kësisoj Kosova nuk ka pasur rastin të sulmojë diplomatikisht e as të mos ketë mundësinë që ta akuzojë Serbinë për gjenocidin që ka bërë në Kosovë. Enklavat serbe, eksterritorialiteti i manastireve, që përbëjnë 15% të territorit të vendit tonë, janë bërë të obliguara me Pakon e Ahtisarit që të realizohen. Këto obligime kanë dalë si rezultat i procesit negociues dhe këmbëngulësisë së palës serbe, duke ndjekur parimin ‘kërko shumë, që të marrësh diçka’.

Edhe veriu i Kosovës – jo vetëm Mitrovica veriore – që ka një vijë ajrore afërsisht prej 40km prej kufirit e deri në lumin Ibër, kontrollohet nga strukturat paralele serbe që sponsorizohen nga qeveria e Serbisë dhe që vëzhgohen nga misioni i Brukselit, EULEX-i. Në këtë pjesë të territorit të saj, qeveria e Kosovës nuk ka qasje, përpos qytetarëve që dalin të ‘bëjnë biznes’. Kjo gjendje që mbizotëron në atë pjesë të Kosovës ka shtuar apetitet e qeverisë serbe për t’ia aneksuar këtë pjesë Serbisë. Garancitë ndërkombëtare për mosndarje të Kosovës ekzistojnë me pakon e Ahtisarit, me qëndrimin e Grupit të Kontaktit, por që kjo pjesë e Kosovës është një problem i madh pranohet pa hezitim. Daniel Serwer, nga instituti amerikan për paqe dhe njohës i situatës në Ballkan, në një intervistë pranoi hapur që veriu i Kosovës është një problem i madh dhe zgjidhja e tij është e vështirë. Kosova ndodhet në situatën që kur



sh diçka!

Qeveria e Kosovës me një formë të re lobuese, për të shtuar numrin e njohjeve të reja

# KOSOVA ME STRATEGJI PËR LOBIM



Enver Hoxhaj - Ministër i Punëve të Jashtme të Kosovës

Atifete Jahjaga - Presidente e Kosovës

përmendet ndarja e saj e kap makthi dhe as që nuk mund të imagjinohet që të ndodh një gjë e tillë, kurse, nga ana tjetër, Serbia faktikisht kontrollon pjesën veriore të Kosovës duke shkelur kështu edhe marrëveshjen e Kumanovës dhe kërkon ndarjen zyrtare, që gjeografikisht kjo pjesë të paraqitet edhe në hartën politike të Serbisë.

## Çfarë duhet të bëhet?

Në këtë situatë dikotomike të veriut të vendit, duhet patjetër të gjendet një zgjidhje. Në një anë Kosova as që do dhe as që pranon të bëhet fjalë për shkëputje ose ndarje të kësaj pjese që historikisht ka qenë e saj, Serbia, në anën tjetër, me kryeneçësinë e saj dhe duke ndjekur parimin që i ka kryer gjithmonë punë 'kërko shumë, që të marrësh diçka' e kontrollon këtë pjesë, por do që edhe juridikisht e gjeografikisht të bëhet e vetja. Për t'i gjetur zgjidhje kësaj situatë të krijuar, duhet që palët të negociojnë për këtë problematikë e cila edhe mund të jetë në tavolinën e bisedimeve që po realizohen nga dy palët dhe nuk përjashtohet mundësia t'i imponohet palës kosovare nga bashkësia ndërkombëtare që veriu i Kosovës të ketë status të veçantë por përbrenda integritetit territorial të Kosovës. Në rast se do të arrihet deri tek imponimi për status të veçantë për veriun e Kosovës, pse mos të përdorim parimin 'kërko shumë, që të marrësh diçka' që edhe ne, si palë kosovare, të kërkojmë një status të veçantë për shqiptarët që jetojnë në Luginën e Preshevës dhe kësajsoj të jemi në ofensivë dhe diplomacia serbe të detyrohet të zgjedhë se çfarë të bëjë?!

## Muhamet JAHIRI

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar strategjinë për lobim të hartuar nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), në koordinim me presidenten, kryeministrin dhe faktorin ndërkombëtar.

Përfaqësuesit më të lartë të shtetit e kanë vlerësuar me notë pozitive hartimin e kësaj strategjie, përmes të cilës synohet shtimi i njohjeve të reja për Republikën e Kosovës.

Një vlerësim të tillë e ka bërë edhe kryeministri Hashim Thaçi, i cili ka thënë se lobimi i deritashëm, si edhe aktiviteti që pritet tash e më tutje me anë të kësaj strategjie, do t'i sjellin Kosovës njohje të reja. "Natyrshisht se këto takime do të jenë jashtëzakonisht inkurajuese për vazhdimin e procesit për njohje të reja për Republikën e Kosovës", - ka deklaruar Thaçi.

Ndërkaq, shefi i diplomacisë kosovare, Enver Hoxhaj, ka thënë se Strategjia për Lobim përfshin një analizë të detajuar të shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën, si dhe orientimet të cilat duhen ndjekur në mënyrë që të ketë shtim të numrit të njohjeve. "Ky dokument ka një plan të veprimit, i cili tregon se çfarë strukture e personaliteteve do të përfshihet në lobimin për shtimin e njohjeve", - ka deklaruar Hoxhaj. Ai ka thënë se lobimi për njohjen e pavarësisë së Kosovës vazhdon të

mbetet edhe më tutje prioritet i politikës së jashtme. "Çështja e njohjeve për shtetin e Kosovës edhe më tutje mbetet prioritet i lartë i politikës së jashtme, prandaj kemi hartuar një strategji për njohje, e cila do t'u mundësojë të gjitha institucioneve që të kenë një koordinim më të mirë dhe më të ngushtë. Kjo është vetëm pjesa e parë e përgjithshme e strategjisë, kurse dokumenti i ka rreth 300 faqe tekst", - ka thënë ministri i Jashtëm Hoxhaj.

Sipas tij, në bazë të këtij dokumenti, MPJ ka identifikuar pesë grupe të shteteve që përfshijnë shtetet që e kanë njohur Kosovën, shtetet që janë afër njohjes, shtetet që kanë dhënë sinjale për njohje, shtetet që kanë qëndrim neutral dhe grupi i pestë i shteteve që janë kundërshtarë të pavarësisë së Kosovës. "Për secilin shtet veç e veç është bërë një profil i veçantë në të gjitha aspektet, në mënyrë që të ketë njohuri të plota për secilin shtet, për ta gjetur pastaj mënyrën e qasjes së lobimit", - është shprehur Hoxhaj.

## Opozita e quan strategjinë të paefektshme

Në anën tjetër, partitë opozitare e kanë quajtur joefikase strategjinë e miratuar për lobim nga ana e Qeverisë së Kosovës. Përfaqësuesja e Lëvizjes Vetëvendosje, Puhie Demaku, ka thënë se kjo strategji do të jetë e dështuar për faktin se institucionet e Kosovës e kanë humbur rastin për shtimin e njohjeve



të reja, duke zgjedhur rrugën e dialogut me Serbinë. “Kjo strategji do të jetë e dështuar për faktin se Kosova ka pasur dy mundësi veprimi: të jetë shtet i konsoliduar, sovran e të kërkojë njohje, ose të zgjedhë dialogun me Serbinë, të cilin institucionet e Kosovës po e quajnë teknik, ndërsa BE-ja vetëm dialog”, - ka thënë Demaku.

Sipas Demakut, rruga të cilën kanë zgjedhur institucionet e vendit për të nisur bisedimet me Serbinë ka qenë e gabuar dhe kjo ka ndikuar në stagnimin e njohjeve të reja. “Institucionet e Kosovës kanë zgjedhur në këtë rast rrugën për dialog dhe kjo ka ndikuar që shtetet që nuk na kanë njohur të stagnojnë, sepse ne ju kemi treguar se kemi probleme të brendshme, kemi probleme me fqinjët tanë dhe nuk jemi ende shtet sovran”, - është shprehur ajo.

Sipas saj, strategjia e prezantuar nga ana Ministrisë së Punëve të Jashtme, edhe për nga ana përmbajtësore nuk është serioze, sepse përmban elemente qesharake. “Ne kemi parë një draft të strategjisë, të cilin mund ta quaj joefikas, për arsyen e thjeshtë se detyrat, të cilat parashihen aty të kryhen nga Ministria e Punëve të Jashtme, janë me të vërtetë qesharake. Aty shkruan se duhet të ketë takime dypalëshe, do të ketë pjesëmarrje në panairë, ndërkohë që edhe ndarja e shteteve për lobim nuk është kategorizuar siç duhet”, - është shprehur aktivistja e Vetëvendosjes, Puhie Demaku, duke shtuar se: “Në strategji do të duhej të ishin fillimisht shtetet të cilat janë afër njohjeve, më pas shtetet të cilat janë gati të na njohin mirëpo hasin në disa dilema dhe në kategorinë e tretë shtetet të cilat nuk e kanë në plan të na njohin, në mënyrë që mos të humbim kohë tani për tani me ato shtete”.

Ndërkaq, anëtari i kryesisë së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, ka thënë se strategjia nga Qeveria e Kosovës nuk do të ndikojë asgjë

pozitivisht për shtimin e njohjeve. “Institucionet e Kosovës tashmë kanë hasur në një bllokadë totale, nuk ka pasur strategji dhe nuk ka pasur veprim për lobim dhe besoj se edhe kjo strategji e sotme nuk do të sjellë diçka”, - ka thënë Tahiri, duke shtuar se kjo strategji është vetëm një arsyetim i qeverisë për mosnjohjen e Kosovës që një kohë të gjatë nga asnjë shtet.

Sipas tij, strategjia do të jetë e dështuar edhe për shkak të dëmtimit të imazhit të Republikës së Kosovës dhe problemeve të shfaqura me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimin Evropian. “Kjo strategji është për t’iu hedhur hi para syve shqiptarëve, sepse duke pas parasysh se shtetet të cilat nuk na kanë njohur, kur të marrin vesh se Kosova ka bllokadë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, kemi bllokadë prej Bashkimit Evropian, nuk është bërë asnjë investim i huaj, atëherë shtrohet pyetja elementare pse duhet të njihet Kosova”, - ka theksuar Tahiri, duke shtuar se lobimi nënkupton jo vetëm strategji, por edhe komunikim të drejtpërdrejtë, i cili është shumë i mangët.

### **Shala: Strategjia nuk mund të imponojë njohje për Kosovën**

Mendim të ngjashëm me partitë opozitare ka edhe analisti politik Behxhet Shala, i cili ka thënë se miratimi i strategjisë për lobim nuk do të ketë ndikim në shtimin e njohjeve për Kosovën, sepse një gjë e tillë varet prej interesave të vendeve që duan ta bëjnë një gjë të tillë. “Pavarësisht se mund ta kemi një strategji të mirë dhe të mrekullueshme, njohja e Republikës së Kosovës pikë së pari është interes i atij shteti i cili e njih, i cili bazohet mbi interesin e tij strategjik, ekonomik ose politik. Në qoftë se një shtet vendos për ta njohur Kosovën, ai bazohet mbi interesin e tij”, - ka thënë Shala, duke folur për miratimin e strategjisë për lobim të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Shala ka theksuar se institucionet e Kosovës vazhdimisht kanë tentuar ta shtojnë numrin e njohjeve për Kosovën, mirëpo nuk kanë pasur asnjëherë efikasitet. “Që nga koha e ministrit Hyseni, është dhënë maksimumi për ta shtuar numrin njohjeve për Kosovën, mirëpo nuk mund të themi se ka pasur efikasitet, sepse edhe ato shtete të cilat na kanë njohur, ka qenë rezultat kryesisht i lobimit nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të fuqishme evropiane”, - ka deklaruar Shala, duke shtuar se as diplomacia e tashme e Kosovës nuk mund të bëjë më shumë. “Edhe ministri i tanishëm Enver Hoxhaj, nuk besoj se do të mund të bëjë diçka më tepër, duke pas parasysh se edhe zëvendëskryeministri Pacolli, i cili është duke lobuar që dy muaj nëpër Afrikë, por nuk po ka ndonjë ndikim”, - ka thënë ai.

Analisti Shala ka theksuar se njohja e Republikës së Kosovës nuk mund t’i imponohet asnjë shteti dhe një rast i tillë më së miri mund të vërehet me vendet e BE-së, të cilat po hezitojnë në njohjen e shtetit më të ri evropian. “Shembulli më eklatant janë shtetet në kuadër të Bashkimit Evropian, nga të cilat pesë prej tyre nuk po e njohin Republikën e Kosovës, pavarësisht se shtetet më të fuqishme të Bashkimit Evropian e kanë bërë një gjë të tillë”, - ka deklaruar Shala.

Sipas tij, strategjinë për lobim do ta bllokojë edhe diplomacia e shtetit serb e cila, sipas tij, ka një ndikim të madh në shumë shtete të fuqishme botërore.

“Kemi shtetin e Serbisë, i cili ka një diplomaci të fortë e që lobon në gjitha vendet kundër njohjes së Kosovës, duke pasur në përkrahje edhe shumë shtete të fuqishme si: Kina, Rusia, India, por edhe shumë shtete në Afrikë do të ndikojnë negativisht në shtimin e njohjeve”, - ka thënë analisti Shala. ■



# E drejta për shtetësi dhe sfidat për ta fituar atë

E drejta e qytetarit për një shtetësi është e drejtë elementare e garantuar edhe me kushtetutë, ndërsa mënyrat e fitimit të kësaj të drejte janë të rregulluara në mënyrë të detajuar me ligj. Në Kosovë, Shqipëri, Serbi, Mal të Zi, Maqedoni, si edhe në të gjitha shtetet e tjera, mënyrat e fitimit të shtetësisë janë të rregulluara me ligjin për shtetësinë. Çështje e cila është mjaft brengosëse dhe sfiduese dhe që ka nevojë për një zgjidhje sa më të shpejtë është mbetja e një numri të madh të qytetarëve shqiptarë në Ballkan fare pa shtetësi

**Mr. sc. Flamur HYSENI**

**P**opulli shqiptar, përpos në Shqipëri dhe Kosovë, jeton edhe në tri shtetet të tjera ballkanike, ku jeton një numër i madh i popullatës shqiptare, si në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi/Lugina e Preshevës, por kjo pjesë e popullatës shqiptare, në këto tri shtete, ballafaqohet me pengesa të ndryshme sa i përket të drejtës së tyre për të pasur së paku një shtetësi, qoftë të shtetit ku jetojnë, ose të shteteve me të cilat i lidh gjaku, gjuha, kultura, përkatësia kombëtare, siç janë Shqipëria dhe Kosova.

Me të ndryshuar statusi juridiko-politik i Kosovës dhe shpallja e pavarësisë dhe njohja e saj ndërkombëtare nga një numër i konsiderueshëm i shteteve të rëndësishme, Republika e Kosovës miratoi ligjin për shtetësinë e Kosovës, i cili hyri në fuqi më 15 qershor 2008 (shih dokumentin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës të propozuar nga Presidenti Ahtisari, dokument i cili në listën e ligjeve, të cilat duhet t'i nxjerrë Kuvendi i Republikës, parasheh edhe nxjerrjen e ligjit për shtetësinë e Kosovës).

## Ligji i paqartë dhe problemet në praktikë

Si mënyra më të njohura të fitimit të shtetësisë janë: me lindje, me adaption, me natyralizim, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare ndërmjet shteteve, si dhe ndonjë mënyrë tjetër, varësisht prej rregullimit ligjor që kanë shtetet, të cilat janë si standarde që aplikohen te një numër i madh shtetesh.

Ligji për shtetësinë e Kosovës nr. 03/L – 034, i cili u miratua dhe hyri në fuqi më 2008, ka nevojë të amendamentohet, për arsye se në dispozitat për fitimin e shtetësisë së Kosovës janë bërë disa lëshime, si teknike ashtu edhe përmbajtjesore (shih kreun II, të ligjit për shtetësinë e Kosovës, përkatësisht nenin 9 dhe 10 të tij, që përcaktojnë natyralizimin si mënyrë të fitimit të shtetësisë).

Për ta fituar shtetësinë e Republikës së Kosovës, praktikisht paraqiten një mori problemesh, sidomos për qytetarët shqiptarë të Luginës së Preshevës, të cilët, pas vitit 1999 jetojnë në territorin e Kosovës, e sidomos në komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti, Fushë Kosovë, por edhe sot e kësaj dite një numër i

madh i tyre janë ende pa shtetësi dhe janë shndërruar në persona apatridë – pa shtetësi (shih disa statistika të Shoqatës “Vatra” e cila vepron në Komunën e Gjilanit). Atyre ju kërkohet të kenë një certifikatë që nuk janë nën hetime, por ata e kanë të vështirë ta sigurojnë këtë nga ana e gjykatave në Serbi, ndërsa është tejet e paarsyeshme të kërkohet kjo që të merret në këto gjykata, kur dihet se këta qytetarë jetojnë dhe veprojnë prej vitit 1999 në Kosovë dhe po e njëjta duhet kërkuar që të merret nga gjykatat e Kosovës dhe të aplikohet ligji, përkatësisht neni 10 paragrafi 1, pika b), ku thuhet se: është duke qëndruar rregullisht në Republikën e Kosovës që pesë (5) vite dhe posedon leje të vlefshme qëndrimi (shih nenin 9 dhe 10 të ligjit për shtetësinë e Kosovës nr. 03/L – 034). Për t'i evituar këto probleme që na paraqiten në praktikë, lidhur me aplikimin e këtyre qytetarëve për shtetësinë e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme duhet të nxjerrë një akt nënligjor, përmes të cilit do të sqaronte në mënyrë të detajuar procedurën e aplikimit për shtetësi të kësaj kategorie

të qytetarëve dhe do të mundësonte që ata të cilët kanë jetuar 5 vitet e fundit në Kosovë, certifikatën që nuk janë nën hetime ta marrin nga organet gjyqësore të Republikës së Kosovës dhe të mos trajtohen si qytetarë të huaj, pasi që edhe vetë ligji ynë, më në fund, e njeh të drejtën e dyshetësisë, edhe nëse ata veç e kanë ndonjë shtetësi tjetër.

## **Bashkëpunimi Shqipëri – Kosovë t’u mundësojë shqiptarëve që nuk kanë shtetësi të bëhen me shtetësi**

Numri i shqiptarëve pa shtetësi (apatridë) në Ballkan është në rritje e sipër, ndërsa shqiptarët kanë tanimë dy shtete në Ballkan dhe është paksa absurde të kemi një gjendje të tillë.

Duhet krijuar kushtet dhe mundësitë që qeveritë e të dyja shteteve, të Shqipërisë dhe Kosovës, ta mundësojnë lehtësimin e procedurave për fitimin e shtetësisë dhe të paktën në Ballkan të mos mbetet asnjë shqiptar pa shtetësi.

Shqiptarët të cilët kanë jetuar në Serbi/Lugina e Preshevës dhe që tanimë janë shpërngulur në Kosovë, ata që jetojnë në Mal të Zi dhe disa që jetojnë në Maqedoni janë të diskriminuar dhe janë ende pa shtetësi. Për këtë kategori të popullit shqiptar duhet të kujdesen qeveritë e dy shteteve: Shqipërisë dhe Kosovës (shih raportin e regjistrimit të popullatës në Maqedoni të vitit 2011, rezultojnë se rreth 50 mijë shqiptarë kanë mbetur pa shtetësi, ndërsa edhe më tutje vazhdon refuzimi i kërkesave të tyre për shtetësi nga ana e administratës shtetërore).

Qeveritë e të dyja shteteve, Shqipërisë dhe Kosovës, duhet ta bëjnë ndryshimin e ligjeve për shtetësinë, në mënyrë që të krijojnë mundësitë e fitimit të shtetësisë së shqiptarëve të cilët janë jashtë juridiksionit të këtyre shteteve dhe sidomos atyre që janë fare pa shtetësi, siç është rasti me disa shqiptarë të Luginës së Preshevës, të cilët jetojnë në Kosovë dhe me disa shqiptarë të Maqedonisë. Qeveria, si e Shqipërisë, ashtu edhe e Kosovës, duhet të ndjekë praktikën e shteteve fqinje se si interesohen ato për popullin e tyre jashtë shtetit dhe të mundësojnë që përmes ndryshimeve ligjore çdo shqiptar në tërë botën, duke plotësuar kushtet ligjore, të ketë mundësinë e fitimit të shtetësisë të Shqipërisë ose të Kosovës (analizo shembullin e shtetit të Maqedonisë për qytetarët maqedonas: Në vitet e fundit, Maqedonia, me të drejtë, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në përkrahje të bashkëkombësve të vet në Bullgari, Greqi, Kosovë dhe Shqipëri. Vite me radhë Qeveria e Maqedonisë angazhohet në mënyrë të veçantë për të përmirësuar jetën e qytetarëve të komunës Liqenas (Pustec) në Shqipëri. Në një vizitë më 2007, zv. Ministri i Jashtëm i Maqedonisë Petrov tha: "Kjo Qeveri përkujdeset në mënyrë të veçantë për maqedonasit jashtë Maqedonisë. Qeveria financon radion në gjuhën maqedonase në Pustec, u jep bursa shumë studentëve që regjistrohen në universitetet e Maqedonisë", duke premtuar ndihmë edhe në projektet infrastrukturore. Të gjithë 5.300 banorët e kësaj komune kanë shtetësi të dyfishtë, shqiptare dhe maqedonase, duke falënderuar ish-ministrit e brendshëm Ljube

donisë për qytetarët maqedonas: Në vitet e fundit, Maqedonia, me të drejtë, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në përkrahje të bashkëkombësve të vet në Bullgari, Greqi, Kosovë dhe Shqipëri. Vite me radhë Qeveria e Maqedonisë angazhohet në mënyrë të veçantë për të përmirësuar jetën e qytetarëve të komunës Liqenas (Pustec) në Shqipëri. Në një vizitë më 2007, zv. Ministri i Jashtëm i Maqedonisë Petrov tha: "Kjo Qeveri përkujdeset në mënyrë të veçantë për maqedonasit jashtë Maqedonisë. Qeveria financon radion në gjuhën maqedonase në Pustec, u jep bursa shumë studentëve që regjistrohen në universitetet e Maqedonisë", duke premtuar ndihmë edhe në projektet infrastrukturore. Të gjithë 5.300 banorët e kësaj komune kanë shtetësi të dyfishtë, shqiptare dhe maqedonase, duke falënderuar ish-ministrit e brendshëm Ljube



kovski, Drejtoria për Migracion e Maqedonisë lehtëson procedurat për gjithë diasporën maqedonase për t’u pajisur me shtetësi të Maqedonisë dhe pasaporta në vendin ku jetojnë. Kjo mundësohet nga neni 11 i Ligjit për nënshtetësi sipas të cilit qytetarët me prejardhje maqedonase mund të pajisen me nënshtetësi pa plotësuar kushtin e jetesës së pandërprerë për 8 vite në Maqedoni dhe pa hequr dorë nga nënshtetësia që kanë në shtetet ku jetojnë. Gjithashtu, me ndryshimet dhe plotësimet e fundit të kodit zgjedhor, qytetarët e Maqedonisë në diasporë mund të marrin pjesë në zgjedhjet e përgjithshme dhe presidenciale. Vota e tyre siguron 3 deputetë, të cilët do t’i përfaqësojnë interesat e votuesve nga diaspora në kuvendin e Maqedonisë). Duke analizuar këtë

shembull sa politik, aq më tepër edhe kombëtar, atëherë shtrohet pyetja, si nuk paska mundësi Ministria e punëve të brendshme e Republikës së Kosovës ta iniciojë procedurën e ndryshimit të nenit 9 dhe 10 të ligjit për shtetësinë, ose të nxjerrë një akt nënligjor, veçanërisht për këtë kategori të popullatës, siç janë shqiptarët e Luginës së Preshevës të shpërngulur në Kosovë prej vitit 1999?

## **Të aplikohet modeli "Jus sanguinis" për të gjithë shqiptarët**

Shtetësia është lidhje juridike mes qytetarit (personit fizik) me shtetin, që do të thotë se, ka të drejta dhe obligime reciproke. "Jus sanguinis" nga latinishtja do të thotë 'drejta e gjakut', që sot aplikohet në shumicën e shteteve të Evropës, sa i përket mënyrës së fitimit të shtetësisë sipas gjakut, ndryshe njihet edhe si modeli gjerman i fitimit të shtetësisë.

Mënyra e fitimit të shtetësisë sipas "Jus sanguinis" shërbeu si model i fitimit të shtetësisë nga ana e qytetarëve gjermanë me rastin e bashkimit të dy Gjermanive, ku qytetarët e Gjermanisë lindore me bashkimin në një Gjermani të vetme fituan automatikisht shtetësinë e Gjermanisë, të cilën e kishin humbur pas Luftës së Dytë Botërore dhe, në këtë mënyrë, u bë përmirësimi i një gabimi historik (analizo mundësinë e këtij shembulli gjerman, se si ka mundësi kjo e drejtë e gjakut të shfrytëzohet edhe te rasti i shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Malit të Zi dhe Maqedonisë, lidhur me fitimin e shtetësisë së njërit shtet, Shqipërisë ose Kosovës, kur dihet se ne jemi në një situatë edhe më të favorshme, sepse kemi dy shtete të të njëjtit komb).

Prandaj, mendoj se çështja e fitimit të shtetësisë së disa shqiptarëve që kanë mbetur pa shtetësi të asnjërit shtet, Shqipërisë dhe Kosovës, duhet të merret seriozisht nga qeveritë e dy shteteve të kombit shqiptar, sepse është obligim kombëtar, kushtetues dhe ligjor, sepse kujdesi për qytetarin e vet dhe ofrimi i shtetësisë atij nga ana e shtetit bën që të ngrihet ndjenja e dashurisë të qytetarët për kombin dhe shtetin (shih traditën amerikane, se çfarë bën shteti amerikan për shtetasin e vet, por edhe shtetasi çfarë bën për shtetin amerikan). ■

(Autori është Asistent në Katedrën e Shkencave Kushtetuese – Administrative në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës)

## KUSHTETUTA APO VETËDIJA QË DUHET NDRYSHUAR

**Astrit RRAHMANI**

**K**osova shpalli pavarësinë më 17 shkurt të vitit 2008, kurse më 9 prill, pra mbas dy muajsh, në një seancë solemne, në prani të 107 deputetëve nga 120 sa ka Kuvendi i Kosovës, u miratua Kushtetuta e Republikës së Kosovës, akti më i lartë juridik i shtetit. Mirëpo, vetëm pas tri vite jetë të kësaj kushtetute, lindi nevoja që të shqyrtohet dhe mbase edhe të rishkruhet edhe një herë pasi që diçka nuk është shkruar në rregull. Kërkohet që të ndryshohet neni 86 i Kushtetutës që ka të bëjë me zgjedhjen e Presidentit, i cili sipas ekspertëve ligjorë është paraparë që në Kosovë të zgjidhet drejtpërdrejt nga populli, e jo nga anëtarët e partive të koalicioneve ose Kuvendi siç ka ndodhur deri më tash. Zaten edhe kur ta analizosh një kërkesë të tillë mbi ndryshimin e kushtetutës, del e arsyeshme që ajo të ndryshohet.


Por përse të ndryshohet ajo? E po gjatë këtyre tri viteve akti më i lartë juridik dhe politik i vendit u sfidua e u nëpërkëmb nga institucionet politike të Kosovës, më konkretisht u shkel nga disa figura goxha të mëdha politike. Ja p.sh. në shtator të vitit 2010 Gjykata Kushtetuese konstatoi rastin e parë të shkeljes së Kushtetutës, ku presidenti i atëherëshëm Fatmir Sejdiu, krahas që ushtronte postin e Presidentit të Kosovës, në të njëjtën kohë, ushtronte edhe detyrën e kryetarit të partisë së tij, të LDK-së. Rasti tjetër që ishte po ashtu në kundërshtim me Kushtetutën ishte edhe ai i kryetarit të komunës së Rahovecit, Qazim Qeskës, i cili pasi që kishte dhënë dorëheqje nga posti i kryetarit, nën presionin e kryeministrit Hashim Thaçi, ishte kthyer sërish në punë, duke shmangur kështu zgjedhjet për kryetar komune në Rahovec. Ras-

ti tjetër, i cili gjeti po ashtu kundërshtime e mbase edhe shkelje kushtetuese, ishte edhe ai i pagesës prej tre mijë eurosh për Radio Televizionin e Kosovës (RTK), pra një ndërhyrje dhe kontrollim nga figurat politike në një medium të pavarur. Dhe rasti më i freskët dhe ndoshta më i rëndë nga të gjithë këta, shkelja e Kushtetutës nga Kuvendi i Kosovës me rastin e zgjedhjes së presidentit Behxhet Pacolli. Behxhet Pacolli u zgjodh president i vendit me vetëm 62 vota nga 67 deputet sa ishin në seancë gjatë votimit, pra mungonin një pjesë e madhe e deputetëve pa të cilët nuk mund të merrej një vendim siç ishte zgjedhja e presidentit të Kosovës. Mandej Pacolli ishte i vetmi kandidat që ishte i nominuar për president, gjë kjo që është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, më konkretisht me nenin 86.6.

Nga kjo shkelje shihet se sa e dinë dhe e respektojnë deputetët – përfaqësuesit e popullit të zgjedhur nga vota e lirë, Kushtetutën e Kosovës. Ndoshta disa nga deputetët mund të mos jenë në dijeni se presidenti, gjatë zgjedhjes në Kuvend, duhet të ketë një kundërkandidat, por kryetari i kuvendit nuk besoj që nuk e ka ditur këtë gjë. Ai madje ishte edhe ushtrues detyre si president i vendit kur gjykata e shpalli si shkelës kushtetute presidentin e atëherëshëm Fatmir Sejdiun, dhe nga ajo shkelje jo vetëm ai, por edhe kryeministri dhe shumë deputetë të tjerë duhet të kenë mbledhur mend dhe të kenë mësuar se kushtetuta nuk duhet shkelur. Asnjë vend në botë nuk është ideal dhe asnjë politikan në botë nuk është i pagabueshëm. Edhe në vendet e tjera demokratike shkelet kushtetuta, por pason dënimi, qoftë individual qoftë partiak. E këtu te ne nuk ka dënime. Dënimet te ne jepen vetëm për ata njerëz që bëjnë kundërvajtje

në trafik, e që polici që e shqipton atë dënim nuk e njeh kundërvajtësin, sepse po të ishte i afërm i policit sigurisht do të shpëtonte pa u dënuar.

Po kërkohet ndryshimi i kushtetutës. Kot. Ata mund ta ndryshojnë kushtetutën derisa shkelësit paraprakë t'ua kenë mësuar rrugën shkelësve që do të vinë më pas. Çfarë po ndodhka në rast se kushtetuta do të ndryshohet? Sigurisht që po ia vënkam një palë sy kushtetutës që ajo ta përcjellë çdo shkelje, apo po ia vënkam një armë kushtetutës që t'ia drejtojë atij që do ta shkel kushtetutën. Të kota janë përpjekjet që shkeljet të ndalen. Kushtetuta e ndryshuar mund të shkelet prapë. Dhe sa herë që të shkelet ajo, lind nevoja që të ndryshohet pastaj, sepse dikujt nuk do t'i shkojë përshtati as ashtu. Çfarë duhet të ndryshojmë atëherë? ...Vetëdijen tonë. Ajo është faktori kryesor i gjithë këtyre gjërave negative. Kur zgjedhësit e popullit nga vota e lirë të punojnë për hir të atyre që i votuan e i sollën deri aty ku janë, e me të vërtetë ta harrojnë interesin, atëherë shteti do të ishte më ndryshe, ligji do të respektohej më shumë, votat nuk do të vidheshin në prani të administratorit për të zënë pozita të larta, kur kryetari të japë dorëheqje, atë vendim ta çojë deri në fund, e jo ta ndërrojë mendjen sa herë që ai të dojë, sepse po të kishte një kulturë dhe vetëdije të ngritur, sikurse popujt perëndimorë, do ta dallonte të bardhën nga e zeza dhe të zezën nga e bardha. Andaj, ta respektojmë ligjin, të cilin e bëjmë me mendjen e me vullnetin tonë, ta respektojmë kushtetutën si njerëzit më të civilizuar në botë. Kushtetuta po, le të ndryshojë, por më shumë të ndryshojë vetëdija jonë në përgjithësi, filluar nga qytetari, nëpunësi, parlamentari e deri te kryeministri e presidenti. ■



Fëmijët po vuajnë më së shumti pasojat e varfërisë

# VARFËRIA SKLLAVËRON FËMIJËT

Varfëria po i detyron fëmijët që të punojnë punë të rënda, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e tyre fizik dhe psikik. Duke e marrë parasysh se numri i fëmijëve që punojnë punë të rënda, si në bujqësi, kërkim të lëmoshës, etj., po shënon rritje të vazhdueshme, institucionet e vendit duhet që të bëjnë më shumë që ta luftojnë këtë dukuri negative dhe deviante. Punët e rënda të cekura më lart ndikojnë te fëmijët që të jenë larg procesit mësimor, larg socializimit dhe, çka është më e keqja, ata mund të pësojnë ngecje të zhvillimit psikik dhe trauma psikike

## **Besnik BOLETINI**

**G**jendja e rëndë socio-ekonomike në vend dhe varfëria e skajshme, po detyron shumë fëmijë që të punojnë punë të rënda, punë të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e tyre psikik dhe fizik. Shumë nga fëmijët që jetojnë në varfëri të skajshme mundohen që të sigurojnë bukën për familjen e tyre, duke bërë punë të rënda dhe në këtë mënyrë largohen nga agjenset e socializimit, siç janë shkolla, grupmoshat, etj.

Puna e fëmijëve mund të definohet si punë që dëmton mirëqenien e fëmijës, pengon edukimin, zhvillimin dhe jetën e tyre të ardhme. Puna e fëmijëve është punë e cila me natyrën ose mënyrën sesi zhvillohet, dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën dhe i mohon fëmijës të drejtën për edukim. Aspektet kryesore që mund të dëmtojnë fëmijën përfshijnë: orë të gjata në punë, ngacmime fizike,

morale dhe psikologjike, që i shkaktojnë fëmijës pamundësi për të ndjekur shkollën dhe për të gëzuar të drejtën për rekreacion.

### **Përpjekjet për të eliminuar punën e fëmijëve**

Duke marrë parasysh rrethanat aktuale në vendin tonë, ka vështirësi të natyrave të ndryshme për të eliminuar punët e rënda të fëmijëve.

Musa Demiri, drejtor i Zyrës për Komunikim Publik në Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale (MPMS), thotë se kjo ministri është e përkushtuar për të eliminuar punët e rënda të fëmijëve. Ai thotë se ministri i MPMS-së është kryetar i Komitetit të Kosovës për Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve, ku në bashkëpunim me kuvendet komunale janë formuar Komitetet Lokale për Parandalimin dhe Monitorimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve. “Nga

shërbimet e ofruara të raportuara nga Qendrat për Punë Sociale (QPS-të) dhe Komitetet Lokale të Veprimt (KLV) për monitorimin e punës së fëmijëve janë: fëmijët të largohen plotësisht nga puna, këshillime për fëmijë dhe prindër, përfshirja në mësim të rregullt, edukim jo-formal, orë pas mësimt, pajisje të ndryshme shkollore, shërbime shëndetësore, referim në sistemin pensional-invalidor, referim për sistemin e punësimit, referim për sistemin e trajnimit”, - u shpreh Demiri.

Një program shumë i rëndësishëm për parandalimin e punës së fëmijëve është programi Ndërkombëtar i ILO-s për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO-IPEC), i cili vepron në Kosovë që nga viti 2004. Si rezultat i intervenimeve të ILO-IPEC në Kosovë, 695 fëmijë janë parandaluar dhe tërhequr nga format më të këqija të punës së fëmijëve, përmes ofrimit të shërbimeve edukative dhe jo-

edukative. Eliza Thana, asistente e programit në ILO-IPEC në Prishtinë, thotë se kjo organizatë ka siguruar asistencë teknike dhe financiare për autoritetet, partnerët socialë dhe shoqërinë civile për të eliminuar format më të këqija të punës së fëmijëve. Ajo thotë nuk ka statistika të sakta për numrin e fëmijëve që punojnë punë të rënda. "Sa i përket statistikave të fëmijëve që punojnë për momentin në Kosovë nuk ka statistika të sakta se sa është numri i fëmijëve që janë të përfshirë në format më të këqija të punës së fëmijëve (FKPF). Qendrat për Punë Sociale i identifikojnë fëmijët në punë, por ky numër nuk e përfaqëson aspak numrin e fëmijëve të përfshirë në punë. Po ashtu, mungesa e një studimi gjithëpërfshirës për shtrirjen dhe natyrën e punës së fëmijëve dhe mungesa e një databaze, e cila do të mblidhte dhe procedonte të dhënat e procesit të monitorimit të punës së fëmijëve (informacion i detajizuar mbi fëmijët e përfshirë në FKPF) ndikon që të mos ketë të dhëna të sakta mbi numrin e fëmijëve që punojnë", - thotë Thana.

### **Fëmijët që kërkojnë lëmshë, në rrezik të kontrabandohen**

Fëmijët që kërkojnë lëmshë janë të rrezikuar edhe nga kontrabanduesit, sepse këta fëmijë janë të pambrojtur, kështu që ekziston mundësia e madhe që rrjete të ndryshme kriminale të abuzojnë me këta fëmijë në mënyra të ndryshme. Për këtë arsye Policia e Kosovës, konkretisht njësitë Policia në Komunitet,

përveç që merret me largimin e tyre nga rruga, fokusohet në parandalimin e kontrabandimit të këtyre fëmijëve.

Brahim Sadriu, zyrtar për informim në Policinë e Kosovës, thotë se Policia e Kosovës është e angazhuar për largimin nga rruga të fëmijëve që kërkojnë lëmshë. Ai thotë se me këtë çështje, në mënyrë të veçantë, merret Policia në Komunitet, ndërsa nuk përjashton mundësinë që këta fëmijë të kontrabandohen për qëllime trafikimi nga rrjete të ndryshme kriminale. "Policia e Kosovës vazhdimisht ka pasur aktivitete policore me qëllim zvogëlimin e kësaj dukurie në vend. Në muajin prill të vitit të kaluar, Drejtoria e Policisë Rajonale Prishtinë, organizoi një plan operativ dyditor lidhur me largimin e lëmshëkërkuesve nga rrugët e Prishtinës dhe, si rezultat i këtij plani, janë sjellë në stacion policor të Prishtinës 37 lëmshëkërkues (36 prej tyre nga Shqipëria). Pas procesit të intervistimit të gjithë janë depërtuar në mënyrë të organizuar në Shqipëri", - theksoi Sadriu.

### **Vështirësitë për t'i risocializuar**

Fëmijët që kërkojnë lëmshë është shumë vështirë të risocializohen, për arsye se janë të paintegruar në shoqëri dhe që nga mosha e vogël qëndrojnë në rrugë. "Terre Des Hommes" është një organizatë që merret me risocializimin e fëmijëve që kërkojnë lëmshë. Artur Marku, shef i delegacionit të kësaj organizate në Kosovë, thotë se kjo organizatë merret me identifikimin e fëmijëve që

kërkojnë lëmshë dhe pas identifikimit të tyre, në bashkëpunim me institucionet relevante, fillon procesi i riintegritit të tyre. "Një nga iniciativat kryesore që ne bëjmë është identifikimi i fëmijëve në rrugë. Në bashkëpunim me autoritetet pastaj këto informacione kalojnë në qendrat për punë sociale, por edhe me autoritetet e tjera sidomos me policinë në komunitet dhe bëhen plane të tjera për nxjerrjen e këtyre fëmijëve nga rruga. Mandej identifikohet familja, bisedohet me familjen dhe pastaj vjen faza më e vështirë që është procesi i riintegritit. Në shifrat aktuale, në këtë proces të identifikimit, janë rreth 550 fëmijë në total, të cilët kërkojnë lëmshë ose lajnë xhamat e makinave në rrugë", - thotë Marku.

Ai thotë se në procesin e riintegritit ka vështirësi të shumta pasi që shumica e fëmijëve përfitojnë para nga kërkimi i lëmshës dhe kanë tendencë që të kthehen prapë në rrugë. Ai thotë një e katërta e fëmijëve që kërkojnë lëmshë vijnë nga Shqipëria, ndërsa e vetmja zgjidhje që u ofrohet atyre pas identifikimit është depërtimi prej nga kanë ardhur. Sipas tij, për vetë faktin që këta fëmijë rriten në rrugë, kur rriten ata kanë prirje të merren me kontrabandë. "Një pjesë e madhe e vajzave rrezikohen që të kontrabandohen, sepse kanë 'përvojë' në rrugë, ndërsa djemtë ka mundësi që të jenë pjesë e grupeve të organizuara, pra merren me udhëheqjen e grupeve të tjera, qoftë që lypin ose që kryejnë vepra në kundërshtim me ligjin", - theksoi Marku. ■





**Rritet delikuenca e fëmijëve**

# Rreth një mijë krime nga të miturit

**Arta JUSUFI**

**R**reth një mijë krime janë kryer këtë vit vetëm nga të miturit. Këto të dhëna shqetësuese kanë dalë nga Policia e Kosovës. Veprat penale që shkaktohen më së shpeshti nga fëmijët janë kryesisht rrahjet, vjedhjet dhe grabitjet e ndryshme. Toger Brahim Sadriu, zyrtar për informim në Policinë e Kosovës, deklaroi se vetën në tremujorin e parë të këtij viti, policia ka evidentuar 928 raste penale nga llojet e ndryshme, prej tyre 913 raste penale janë shkaktuar nga meshkujt e mitur, kurse 15 prej tyre kanë qenë femra.

“Kryesisht kemi raste të natyrës së lehtë, që do të thotë se janë raste të rrahjeve mes të miturve, kemi raste të vjedhjeve ku të miturit janë të përfshirë si persona të dyshuar, por ka raste, sidomos viteve të fundit, kur persona të mitur janë përfshirë në grabitje të çantave, sidomos të femrave nga dora”, - ka thënë Sadriu.

Në kuadër të Policisë së Kosovës vepron edhe njësisia e veçantë, e cila e trajton në mënyrë profesionale delikuençën e fëmijëve.

Policia e Kosovës ka kapacitet profesional për t'i trajtuar këto raste, ka njësi të specializuara, të cilat merren kryesisht me raste të tilla kështu që mund të themi që, shumicën e rasteve, të miturit që kanë qenë të dyshuar ose viktimë, janë trajtuar konform ligjit dhe rregulloreve të punëve të policisë dhe konform të gjitha kompetencave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”, - ka shtuar toger Brahim Sadriu.

## Sjelljet devijante kthehen në delikuençë

Mënyra e sjelljes devijante e njëpasnjëshme të një i mitur mund të kalojë shumë shpejt në delikuençë - kështu thotë psikologja Fatmire Bellopoja-Pllana. Sipas saj, sjellja delikuyente nuk mund të përcaktohet nga mosha, pasi që njeri kalon nëpër shumë etapa, që nga fëmijëria deri në pleqëri.

Delikuentët mund të jenë nga secila moshë, varet në cilat pozita gjenden, sepse secila moshë i ka karakteristikat e veta të zhvillimit, prej femërisë deri në pleqëri. Në qoftë se një fëmijë në fëmijërinë e hershme rritet në një familje që

nuk ka edukatë dhe nuk ka rregulla të mirëfillta, atëherë ai fëmijë e ka frymën e një sjellje devijante, sepse ka shumë faktorë që ndikojnë në atë sjellje”, - ka thënë psikologja, Fatmire Bellopoja - Pllana.

Gjendja e rëndë ekonomike dhe edukata familjare janë faktorët kryesorë që një i mitur, së pari, të fillojë me sjelljet devijante, nga të cilat shumë shpejt kalon në delikuençë. ■



Analizë: Dhuna në shkollat e Kosovës

# DHUNA NË SHKOLLA - DUKURI SHQETËSUESE PËR TË GJITHË

**Përparim BUBLAKU**

**D**huna në shkollat fillore dhe të mesme, në Kosovën e pasluftës, ka shënuar një rritje të madhe. Kjo dukuri shumë shqetësuese ka marrë edhe me dhjetëra jetë nxënësish.

Vetëm në gjysmë vjetorin e parë të vitit 2010, sipas të dhënave të policisë, janë shënuar 210 raste të shfaqjes së dhunës në nivel të Kosovës, prej të cilave edhe me pasoja të rënda.

Ndërkaq, zënka e fundit e cila i kushtoi me jetë një nxënësi të shkollës 'Sami Frashri', në Prishtinë, tregon se kjo dukuri vazhdon të jetë ende shqetësuese, përkundër deklarimeve të atyre që janë të angazhuar për sigurinë në shkolla se kjo dukuri po shënon rënie.

Institucionet e vendit më saktësisht, Ministria e Arsimit, së bashku me Policinë e Kosovës, janë përpjekur që përmes disa planprogrameve të parandalojnë këtë dukuri, por kjo deri më tash nuk është treguar edhe shumë e suksesshme.

Por pse po ndodh një gjë e tillë në shkollat e Kosovës?

Arsyet janë nga më të ndryshmet. E para është se në shkollat tona mungon një komunikim i mirëfilltë prind, mësues, nxënës. Fatkeqësisht kjo lidhje është shumë e largët, ndonjëherë për fajin e prindërve, disa prej të cilëve ndodh që

fëmijët e tyre ta përfundojnë shkollimin dhe ata të mos vizitojnë asnjëherë institucionin arsimor ku fëmijët e tyre shkollohen. Por këtu duhen fajësuar edhe udhëheqësit e shkollave, të cilët nuk i kushtojnë shumë rëndësi mbajtjes së rregullt të mbledhjeve me prindërit e nxënësve.

Arsyeja e dytë është se afër shkollave, ose edhe brenda oborreve të shkollave, janë ndërtuar një numër i madh kafenesh, madje në kryeqytet është ndërtuar një kazino ngjitur me objektin e një shkolle. Këto kafene, të cilat më pas nuk frekuentohen vetëm prej nxënësve të shkollave, shpeshherë kanë qenë vendet ku kanë filluar zënkat, të cilat më pastaj shpeshherë kanë marrë zhvillim. Grupe të ndryshme nxënësish mbajnë edhe armë të ftohta me vete, e në disa raste edhe armë zjarri, me të cilat kanë qëruar hesapet në mes vete në objekte shkollore. Këto objekte do duhej që të mbylleshin dhe që shkollat të kishin bufetë e tyre brenda objektit, të cilat do të ishin në dispozicion vetëm për nxënësit e shkollave.

Gjithashtu, problem tjetër i cili ka qenë nxitës i dhunës në shkolla është edhe qëndrimi i personave, të cilët nuk janë nxënës, në oborret shkollore. Këta persona, duke qenë badihavaxhinj siç thotë populli, qëndrojnë në oborret e shkollave pa u penguar nga askush. Ata, shpeshherë,

janë provokues dhe nxitës të përleshjeve, si dhe pengues të procesit mësimor.

Institucionet arsimore duhet të jenë më të vendosura në parandalimin e këtyre dukurive, duke marrë masa konkrete. Objektet shkollore duhet të jenë të rrethuara në mënyrë që personat, të cilët nuk janë nxënës, të mos kenë mundësi që të hynë brenda objektit shkollor.

Gjithashtu, respektimi i uniformave shkollore nga nxënësit do duhej të ishte i domosdoshëm pasi kjo do të ndihmonte identifikim e tyre në mënyrë më të lehtë.

Ministria e Arsimit, si institucion përgjegjës për arsimin në Kosovë, do duhej që të siguronte kompani private për sigurimin e shkollave. Po ashtu, edhe objektet e shkollave përbrenda do duhej të ishin të pajisura me kamera të sigurisë.

Kjo dukuri e dhunës në shkolla duhet të jetë shqetësuese për gjithë, pasi kjo ndikon direkt edhe në cilësinë e mësimin, si dhe mund të ketë pasoja edhe te vetë nxënësit, të cilët shprehen se ndihen shumë të shqetësuar kur shohin akte të dhunës në shkollat e tyre.

Andaj këtu nevojitet një bashkëpunim i të gjithëve nga Ministria e Arsimit, organet e rendit, shoqëria civile, prindërit, si dhe nga vetë nxënësit për të dhënë kontributin e tyre për ndalimin e kësaj dukurie shumë të dëmshme për shoqërinë tonë. ■



# Mosmarrëveshjet me FMN

Mosvazhdimi i programit "Stand-By", nga ana e FMN-së, do t'i kushtojë Kosovës me humbjen e 156 milionë eurove gjatë këtij viti, si dhe kalimin nga kjo marrëveshje tepër e rëndësishme në një marrëveshje monitoruese, e cila do t'ia vështirësojë Kosovës rrugën për anëtarësimin në organizatat e tjera financiare.

## Lulzim AHMETI

Shkëputja e marrëveshjes mes Qeverisë së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, përveç që do të sjellë pasoja financiare për vendin, mund të sjellë edhe pasoja zinxhimore, duke e përfshirë edhe rrafshin politik. Mosvazhdimi i programit "Stand-By", nga ana e FMN-së, do t'i kushtojë Kosovës me humbjen e 156 milionë eurove gjatë këtij viti, si dhe kalimin nga kjo marrëveshje tepër e rëndësishme në një marrëveshje monitoruese, e cila do t'ia vështirësojë Kosovës rrugën për anëtarësimin në organizatat e tjera financiare ndërkombëtare. Gjatë këtij viti, përveç fondeve të FMN-së, rrezikohen edhe fondet e Bankës Botërore dhe Komisionit European. Shkëputja e kësaj marrëveshje me Fondin Monetar ka ardhur pas vendimit të Qeverisë për të investuar në Autostradën Vërmicë Merdarë, e cila për tri vjet do të kushtojë 225 milionë euro për çdo vit, e po ashtu edhe vendimi i Qeverisë për rritjen e rrogave për rreth 75 mijë shërbës civilë nga 30 deri në 50 për qind. Për këto dhe çështje të tjera, Qeveria e Kosovës ka dështuar ta bindë FMN-në se ka mundësi të bollshme për të mos gjeneruar ndonjë krizë buxhetore dhe financiare.

### Çfarë thotë FMN-ja në deklaratë?

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka njoftuar se marrëveshja 18 mujore e

quajtur Stand By Arrangement (SBA), e cila ishte miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FMN-së në korrik të vitit 2010, ishte ndërprerë më 2011. Në një deklaratë të publikuar në ueb-faqen e FMN-së, thuhet se "programi kishte për qëllim të rivë qëndrueshmërinë fiskale dhe të ruajë stabilitetin financiar, duke ushtruar kufizime në shpenzime dhe duke rritur depozitat e Qeverisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Elemente të buxhetit të vitit 2011, në veçanti rritja e madhe e pagave, kanë devijuar nga programi. Si rezultat, nuk do të përfundojë rishikimi i programit. Gjatë këtij misioni, personeli dhe autoritetet kanë arritur një marrëveshje në nivel të personelit mbi Programin e Monitorimit të Personelit, sipas të cilit do të krijohet një mekanizëm përcjellës, që mund të çojë në një marrëveshje të mbështetur nga FMN-ja më 2012", - thuhet në deklaratën e FMN-së.

Pavarësisht kësaj, kryeministri Hashim Thaçi ka thënë se me FMN-në është arritur pajtueshmëri për monitorimin e politikave ekonomike për vitin 2011 nga ana e FMN-së, kurse zbatimi i këtij monitorimi, do të mundësojë vazhdimësinë e mbështetjes së fondit. "Marrëdhëniet e Kosovës me FMN-në jo vetëm që nuk janë shkëputur, por përkundrazi janë vendosur në bazë të një partneriteti të fuqishëm", - ka deklaruar Thaçi.

Por ish-ministri i ekonomisë dhe financave, Haki Shatri, ka theksuar se mosrespektimi i marrëveshjeve finan-

**KE: Buxheti në rrezik**

Komisioni European (KE) ka theksuar rëndësinë e disiplinës fiskale si parakusht për mjedis stabil makroekonomik dhe investime në Kosovë. Komisioni ka shprehur brengën për "rrezikun që rrethon buxhetin e vitit 2011 dhe financimin e deficitit". Sipas zyrtarëve të KE-së, autoritetet kosovare kanë shpjeguar hollësisht programin ekonomik të miratuar së fundi nga Qeveria dhe planin shoqëruar të veprimit. "Komisioni theksoi nevojën për prioritizimin dhe radhitjen e masave të ndryshme të parapara dhe përvijimin e tyre me veprimet në kuadër të Planit të Veprimit të Qeverisë për Partneritet Evropian si dhe me strategjitë e tjera, që gjithashtu ndikojnë në aktivitetet ekonomike dhe të punësimit", - kanë thënë zyrtarë të KE-së.

ciare rrezikon dështimin e politikave buxhetore në vend. "Duke parë se nuk po përfillen rekomandimet e FMN-s nga ana e Qeverisë, ata, në njëfarë forme, janë tërhequr edhe nga premtimet për ofrimin e donacioneve. Afro 200 milionë euro të projektuara në buxhetin e Kosovës për këtë vit janë humbur", - ka thënë Shatri.

E, për drejtorin e Institutit "Riinvest", Lumir Abdixhiku, shkëputja e marrëveshjes me FMN-në dhe kalimi në program monitorues i ka kushtuar vendit me humbjen e 156 milionë euro, e kjo sipas tij "është goditja më e rëndë ekonomike që Kosova ka marrë që nga përfundimi i luftës". Ai ka thënë se tani është vonë për kthimin e 156 milionë eurove të humbura nga FMN-ja, Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian, por, sipas tij, Parlamenti i Kosovës duhet të reagojë dhe ta ftojë Qeverinë për sqarime, të cilat e sollën vendin në këtë pikë. "Është e do-



# N-në me pasoja zinxhirore


mosdoshme të kërkohet llogari nga Qeveria se pse në kohën kur çdo i dyti kosovar është i papunë, çdo i treti në varfëri e çdo i katërti në varfëri të skajshme, në kohën kur Kosova ka nevojë për para e kur problemet nuk kanë fund, ne vendosim t'i humbim plot 156 milionë euro. Institucionet tona duhet të reflektojnë tani në Buxhetin e 2011-ës dhe në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe, rrjedhimisht, të reflektojnë mbi ndryshimet e reja, aspak të mira”, - thekson Abdixhiku. Sipas tij, këtë vit Kosova mund t'ia dalë disi duke shfrytëzuar bilancin bankar, ose paratë e grumbulluara në 12 vitet e fundit, edhe vitin e ardhshëm, duke shfrytëzuar paratë nga shitja e PTK-së, por për vitet e tjera, siç tha ai, financimi i deficitit do të jetë i pamundur. “Ky ka qenë dhe argumenti kyç i Fondit. Ka shumë gjasa reale që në fund të këtij viti Kosova të përfundojë me më pak para në thesar se një bankë komerciale. Për stabilitetin financiar të vendit është një rrezik enorm dhe i paparë deri më tani”, - tha Abdixhiku. Nënshkrimi i Marrëveshjes “Stand-By” nga Qeveria e Kosovës që është thënë si suksesi më i madh i vendit që nga shpallja e pavarësisë dhe tani shkëputja e kësaj marrëveshje dhe kalimi në program monitorues, sipas Abdixhiku është goditja më e rëndë ekonomike që vendi ka marrë që nga përfundimi i luftës. “Kosova këtë javë ka kaluar nga një marrëveshje formale e përfituese në një marrëveshje joformale dhe jopërfituese. Rrjedhimisht ato 156 milionë eurot e famshme të FMN-ës, Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian janë tërësisht të humbura dhe të parikuperueshme. Ky fakt e vë vendin tonë para sfidave të rënda dhe tërësisht të panevojshme”, - tha ai. Marrëveshja e re me FMN-në, vlerëson Abdixhiku, është largim i Kosovës nga të gjitha institucionet ndërkombëtare, nga të cilat më i rëndësishmi, për të,

është ai i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e cila është financuese e jashtëzakonshme e projekteve zhvillimore.” Në të njëjtën kohë, Raporti i Progresit do ta evidentojë një ridizajnim të tillë si një regres ekonomik të vendit”, - tha eksperti Lumir Abdixhiku.

## Anëtarësimi në BERZH dhe OBT edhe më i vështirë

Përrjashtimi i Kosovës nga programi Stand By (SBY) të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për vitin 2011, e ka vështirësuar edhe më shumë anëtarësimin e Kosovës në mekanizma të tjerë financiarë ndërkombëtarë. Edhe pse ishte thënë gjatë vitit të kaluar se anëtarësimi i Kosovës në Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim (BERZH) është larg vetëm edhe një votë, tash për tash kjo nuk do të ndodhë pasi që dështimi me FMN-në e ka vështirësuar rrugën edhe më shumë. Po ashtu, vështirësi dhe pengesa do të ketë edhe anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Agron Demi, udhëheqës i Institutit për Studime të Avancuara GAP, thotë se mosrespektimi i marrëveshjes me FMN-në nga pala kosovare, do të jetë argument shtesë që disa nga shtetet anëtare të këtyre institucioneve të hezitojnë të votojnë pro anëtarësimit të Kosovës. “Kjo e dëmton kredibilitetin e Kosovës edhe në organizmat e tjerë, siç janë BERZH-i dhe OBT-ja. Në planin e punës së qeverisë në këtë vit parashihet që ekzekutivi të dorëzojë kërkesë formale për anëtarësim në BERZH. Prishja e marrëveshjes së FMN-së do të shërbejë si argument shtesë për shtetet, të cilat janë duke u luhatur për ta dhënë votën pro ose kundër anëtarësimit të Kosovës në

këtë mekanizëm”, - thotë Demi. Sipas tij, pala kosovare duhet ta zbatojë këtë marrëveshje, në mënyrë që të mundësohet vazhdimësia e mbështetjes së FMN-së. Rrjedhimisht, shton ai, do të përmirësohet edhe imazhi i Kosovës karshi institucioneve financiare ndërkombëtare. “Gjatë këtij viti do të duhej të arrihej një performancë shumë më e mirë, me qëllim që vitin e ardhshëm të merret fondi i FMN-së - ashtu siç thuhet edhe në deklaratën e lëshuar nga ky institucion. “Po ashtu, edhe marrëveshja me Komisionin Evropian për një kontroll më të mirë buxhetor dhe për publikimin e shpenzimeve buxhetore që është arritur vitin e kaluar, duhet të respektohet me rregull”, - deklaroi Demi. Kurse, Muhamet Sadiku, ligjërues në Universitetin e Prishtinës (UP) ka thënë se përrjashtimi i Kosovës nga program Stand By (SBY) i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për vitin 2011, e ka vënë vendin në një situatë tjetër të rëndë. Sadiku thotë se nga ky përrjashtim Kosova ka humbur direkt në mjete financiare, ashtu edhe indirekt në dhënie të referencave. Sipas tij, Kosova ka pasur dhe ka pretendime për t'u anëtarësuar në BERZH, por, sipas tij, pas veprimit të fundit të FMN-së, rruga e Kosovës për anëtarësim në këtë institucion është zgjatur tej mase. “Unë nuk di se kur Kosova mund të llogarisë në këtë anëtarësim. Por, sipas meje, duhet një energji e madhe për të riparuar punët me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Stabilizimi i punëve me FMN-në është çelësi i zgjidhjes së problemit të anëtarësimit të Kosovës në BERZH”, - deklaroi ai. Sadiku thotë se normalizimi i relacioneve me FMN-në është hap i domosdoshëm edhe për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë, por edhe në institucione të tjera financiare ndërkombëtare. ■



Më shumë se njëzet e gjashtë mijë maturantë kanë hyrë në provimin e maturës

# MATURANTËT SHPRESOJNË NË ARRITJE

Më shumë se njëzet e gjashtë mijë maturantë nga mbarë vendi, të cilët i janë nënshtruar Provimit Shtetëror të Maturës, shpresojnë se do të kenë sukses në këtë provim dhe se do të vazhdojnë në shkollim të më-tutjeshëm. Në suksesin e nxënësve nuk dyshojnë as mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, të cilët thonë se kanë punuar mjaft me nxënësit dhe se presin sukses nga ta

## Drita VITIA


**R**rëth 26 mijë maturantë nga e gjithë Kosova, të cilët i janë nënshtruar Provimit Shtetëror të Maturës 2011, janë në pritje të rezultateve të këtij provimi. Mirëpo, para se t'i shohin rezultatet, nxënësit janë të bindur se do ta kalojnë këtë sfidë, edhe pse ka të atillë që ankohen për pyetjet e 'vështira' të provimit. "Unë besoj shumë që do ta kaloj provimin sepse kam punuar mjaft mendoj, edhe pse pyetjet kanë qenë të vështira për ne, sepse disa nga to ka ndodhur që nuk i kemi dëgjuar kurrë më parë. Por, megjithatë shpresoj që do ta kaloj provimin", - është shprehur Qëndresa, e cila i është nënshtruar provimit në Gjimnazin "Xhevdet Doda", në Prishtinë. Njëjtë si Qëndresa mendon edhe Leutrimi, i cili thotë se së paku 60% të pyetjeve i ka plotësuar të sakta. "Unë shumicën e pyetjeve i kam ditur dhe i kam plotësuar vetë, edhe pse kemi pasur mundësi edhe të flasim në klasë me shokët e klasës, të konsultohemi sepse nuk kemi pasur edhe aq shumë kontroll. Mirëpo, me të vërtetë, shumicën i kam ditur vetë dhe shpresoj shumë që provimin do ta kaloj me sukses", - është shprehur Leutrimi, i cili i

është nënshtruar provimit në Gjimnazin "Sami Frashëri" në kryeqytet. Mirëpo, në suksesin e nxënësve besojnë edhe vetë mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave. Drejtori i Gjimnazit "Sami Frashëri", Osman Beka, ka thënë se shpreson shumë që nxënësit do të arrijnë një kalueshmëri të kënaqshme, pasi siç shprehet drejtori, përveç mësimit të rregullt, nxënësit kanë mbajtur edhe mjaft orë shtesë rreth përgatitjeve për këtë provim. "Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet paraprake me nxënësit, po ashtu kemi mbajtur edhe orë shtesë që nga mbarimi i mësimit të rregullt dhe besoj që nxënësit janë mjaft të përgatitur për këtë provim", - është shprehur Beka. Mirëpo, ai ka shtuar se këtë vit pret kalueshmëri edhe më të lartë të nxënësve, pasi siç shprehet Beka, ky është edhe synimi i tij. Megjithatë, Gjimnazi "Sami Frashëri", tash e sa vjet të organizimit të maturës, ka qenë një ndër shkollat me kalueshmërinë më të lartë, kurse vitin e kaluar në këtë shkollë kalueshmëria ka qenë 94%.

## Zihen kopjesit

Mirëpo, me gjithë organizimin shumë të suksesshëm, sipas zyrtarëve të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe

Teknologjisë, gjatë provimit të maturës, maturantët kanë pasur mundësi edhe të kopjojnë. Një gjë e tillë është vërtetuar në disa shkolla në Kosovë, ku disa maturantë janë zënë duke kopjuar dhe atyre u është anuluar provimi. Rregullat e provimit të maturës janë shkëlqur në Komunën e Deçanit, përkatësisht në gjimnazin e këtij qyteti. Sipas të dhënave të MASHT-it, në këtë komunë janë vjedhur fletëtestet dhe janë nxjerrë jashtë klasës duke u bërë kopjime, kanë thënë zyrtarët e MASHT-it. Kryetari i Komisionit Qendror Shtetëror të Maturës, Nehat Mustafa, ka thënë se testet e zëna në këtë komunë, janë shkëputur nga kopertina e provimit, janë nxjerrë jashtë klasës përmes banjave të shkollës dhe i janë dhënë dikujt jashtë objektit të plotësohet, pastaj janë kthyer brenda. Testet e nxjerra jashtë, po ashtu, janë të plotësuar me kimik, gjë që është e ndaluar në këtë provim, pasi këtë lloj plotësimi nuk e njeh as makina lexuese, e cila bën vlerësimin e nxënësve. Mirëpo, Mustafa është shprehur se në këtë qendër të testimit, si dhe në të gjitha qendrat e tjera ku vërtetohen parregullsi dhe kopjime të këtij lloji, anulimi i provimit është ndëshkimi më i vogël që



# EN E SUKSESIT

Rezultatet më 15 qershor

Rezultatet e Provimit të Maturës pritet të shpallen më 15 qershor, ndërsa edhe këtë vit testi përmbante 100 pyetje, prej të cilave nxënësit duhet të japin përgjigje të sakta në më së paku në 50 për qind prej tyre, për të dalë të suksesshëm. Testi është hartuar edhe në gjuhët e komuniteteve, përfshirë këtu edhe atë serbe.

do të bëhet, pasi siç ka thënë ai, këta maturantë janë të rrezikuar ta humbin të drejtën e provimit tërësisht për afatin e qershorit dhe të mbeten pa u testuar deri në gusht.

## Makinat korrigjuese

Ndërkohë, udhëheqësi i Divizionit për Vlerësim dhe Standarde në MASHT, Mustafë Kadriu, e ka bërë publike edhe mënyrën e korrigjimit të testeve për revistën. Testet e maturantëve, tash e disa vite, korrigjohen me makina elektrike, të cilat e bëjnë vetë vlerësimin e testit. Ndërkohë, askush nuk mund ta identifikojë ndonjë test të caktuar për shkak të mënyrës së plotësimit të testeve. Mirëpo, secili test futet në aparatit regjistruar, i cili e nxjerr emrin, mbiemrin e nxënësit dhe rrumbullakimin e secilës pyetje. Shembull, pyetja e parë, A, pyetja e dytë, D e kështu me radhë. Dhe krejt në fund, pas këtij regjistrimi, i cili bëhet drejtpërdrejt në kompjuter, statistikën e nxjerra nga fletët e plotësuara nga maturanti, hyjnë në një procedurë tjetër, e cila është ajo e vlerësimit. Në këtë proces, merren të dhënat e të gjithë maturantëve dhe kërkohet pyetja e saktë. I jepet komanda makinës vlerësuese për secilën pyetje dhe automatikisht nxirret secila përgjigje e saktë ose e pasaktë për secilën pyetje të provimit. Gjatë korrigjimit, anëtarët e KQSHM-së, këtë vit kanë hasur edhe në teste të plotësuara me kimik, të cilat nuk i njeh aparati, por, zyrtarët e këtij komisioni kanë thënë se të gjitha ato teste vlerësohen pasi të përfundojë procesi i korrigjimit, ngase, për një gjë të tillë interesohen edhe vetë maturantët. ■

Studentët shfrytëzojnë testet e fotokopjeve për t'u përgatitur për provim

# STUDENTËT BLEJNË TESTET E PROVIMIT

Një numër i konsiderueshëm i studentëve të Universitetit të Prishtinës hyjnë në provim me aq dije sa mund të marrin nga një test i gatshëm që e sigurojnë nga fotokopjet e qytetit. Se i përdorin ato e pranuan vetë studentët e anketuar, disa duke u shprehur se është e domosdoshme e disa të tjerë duke e ditur se kjo formë e dijes mund të jetë kalimtare për ta. Prorektori për mësim në Universitetin e Prishtinës ka thënë se kjo formë është e ligjshme, mirëpo profesori duhet të jetë ai që mos të tolerojë keqpërdorimin e literaturës

## Drita SLIVOVA

**K**ohët e fundit ka filluar praktika e marrjes së notave nga studentët e Universitetit të Prishtinës nëpërmjet testeve që i sigurojnë nga fotokopjet, e që sipas studentëve të anketuar nuk është mënyrë e duhur, por është thjeshtë e domosdoshme për ato lëndë ku ka ngarkesë të literaturës.

Dardan Vuniqi, student i fakultetit juridik, ka thënë se “nuk është mënyrë e mirë, por për ne është lehtësuese për arsye se deri-diku orientohemi se çfarë pyetjesh mund të qëllojnë në test. “Ta them të drejtën unë vetë e kam praktikuar të mësoj nga këto teste, mirëpo jam në dijeni se nuk është mënyrë e mirë për të mësuar”, - ka thënë ky student. Edhe Mensur Neziri, student i Fakultetit Ekonomik, ka thënë se këto teste mund të gjenden shumë lehtë, por sipas tij, edhe pse ndonjëherë e ka marrë një test të gatshëm, nuk i ka hyrë asgjë në punë. “Nuk është faji vetëm te studentët, profesorët janë ata që i lejojnë këto gjëra e që realisht nuk do të duhej të ndodhnin”, - ka shtuar student i Neziri.

## Profesorët ankohen

Edhe Flamur Hyseni, asistent në Fakultetin Juridik, ka deklaruar se kjo dukuri tashmë është vërejtur dhe

u shpreh shumë i zhgënjyer nga studentët, të cilën aplikojnë këtë metodë për të marrë notën. “Ne e kemi vërejtur një dukuri të tillë dhe thjeshtë mund t’iu them të gjithë studentëve që kjo nuk do të duhej të ndodhte për arsye se kjo metodë nuk është e duhur për të marrë notën. Do ju kisha sugjeruar studentëve që të largohen nga kjo formë e marrjes së notave sepse nuk është korrekte”, - është shprehur Hyseni.

## E ligjshme?!

Notimin e tillë me “reforma të shpikura nga vetë studentët” e ka vlerësuar si të ligjshëm prorektori për mësim në UP, Bajram Berisha. Sipas tij, asgjë nuk e ndalon studentin të marrë njohuri sipas mënyrës më të lehtë që gjen ai, por faji drejtpërsëdrejti, në këtë rast, bie mbi profesorët që lejojnë të kopjohet testi që ai e krijon më herët.

Askush nuk ua ndalon studentëve që të mësojnë sipas formave që ata i shohin më të përshtatshme. Këtë gjë thjeshtë nuk duhet ta lejojë profesori i lëndës së caktuar që testet të shpërndahen kudo nëpër fotokopje”, - ka thënë Berisha.

Ndonëse nuk kontrollon nga dikush dhe askush nuk ju bën presion, studentët e kanë mënyrën më të lehtë të përgatitjes së provimit. Me teste të gatshme marrin notën “express”. ■



**Studimet në master vlerësohen të shtrenjta nga studentët**

## **300 EURO PËR MASTER, NUK PRITET ULJA E ÇMIMIT**

**Çmimi i semestrit për studime master në Universitetin e Prishtinës vazhdon të jetë 300 euro. Siç kanë deklaruar zyrtarët e ministrisë së Arsimit, kështu do të mbetet akoma sepse sipas tyre ky çmim është mjaft i volitshëm, pasi që për të marrë dituri duhet të investohet. Por studentët e anketuar kanë thënë se krahasuar me standardin ekonomik në Kosovë, kjo shumë nuk mund të përballohet nga studentët**

### **Lumnije MALOKU**

**K**ushtrim Kadriu student i nivelit master në Fakultetin Filologjik është shprehur se çmimi prej 300 euro që ai e paguan për semestër është shumë i lartë dhe se ai nuk mund t'ia dalë pa ndihmën e prindërve.

“Kursesi nuk mund t'ia dal vetë pa më ndihmuar prindërit. Realisht për ne që nuk punojmë dhe nuk kemi të ardhura të tjera përveç atyre familjare, çmimi 300 euro për semestër mund të them se është marramendës”, - ka thënë ky student.

Ai ka shtuar se ka njohuri për çmimet që paguajnë studentët nëpër vendet e rajonit, që sipas tij paguajnë më shumë se në vendin tonë, mirëpo ka shtuar se Kosova me standardet jetësore që i ofron, natyrshëm nuk ia lejon një studentit një pagesë kaq të lartë. Sipas tij, rrogat mesatare që merren në Kosovë nuk mjaftojnë për të paguar çmimin semestral për studime master.

### **Ministria e Arsimit e quan çmim të arsyeshëm**

Këshilltari politik në Ministrinë e Arsimit, Nuri Bexheti, ka thënë se ky çmim është mjaft i volitshëm. Sipas tij, është puna më e mirë që ka vendosur deri më tash Ministria e Arsimit në bashkëpunim me menaxhmentin e Universitetit të Prishtinës.

“Në çdo vend paguhet për shkollim. Edhe te ne është njësoj. Çmimi prej 300 eurove është i arsyeshëm, duke u bazuar në atë se realisht studimet e masterit janë të një niveli më të lartë e që kjo kërkon investim”, - ka thënë Bexheti.

Ai ka potencuar se nuk ka fare njohuri nëse një ditë do të ketë ulje të çmimit, mirëpo sërish insistoi që ky çmim nuk është i lartë.

Studentët e masterit do të vazhdojnë akoma të paguajnë të njëjtin çmim për semestër, duke shtuar kështu edhe pagesën e provimeve. Për çdo provim studentët paguajnë 5 euro shtesë. ■

### **Fatos SHALA**

**K**riza ka kapluar prodhimtarinë e qumështit. Gjatë vitit të kaluar janë mbyllur rreth 25 ferma komerciale për shkak të vështirësive dhe problemeve që ato po hasin në punën e tyre. Prodhuesit e qumështit në Kosovë kërkojnë mbështetje nga qeveria. Ata kërkojnë heqjen e TVSH-së për këtë produkt, që, sipas tyre, po u sjell dëme të mëdha, duke i çuar deri te mbyllja e fermave. Milazim Berisha, kryetar i Shoqatës së Prodhuesve të Qumështit në Kosovë, thotë se përveç TVSH-së, ata kanë edhe shumë probleme të tjera që i hasin në plasimin e produkteve të tyre në tregun kosovar. Mungesa e subvencionimit nga institucionet e vendit dhe ngritja e akcizës për derivatet, sipas tij, i ka sjellë fermerët deri te mbyllja e fermave të tyre. “Është premtuar heqja e TVSH-së për qumështin, por kjo nuk ka ndodhur. Kjo situatë po i rëndon edhe më tej prodhuesit e qumështit dhe kjo gjendje ka sjellë një situatë të rëndë për fermerët kosovarë dhe vetëm vitin e kaluar janë mbyllur rreth 25 ferma komerciale”, - thotë Berisha. Të gjitha problemet që ata i hasin në prodhimtarinë e tyre, sipas tij, i kanë adresuar në institucionet përgjegjëse të vendit, por nuk kanë marrë mbështetje asnjëherë. Problemi kryesor, tha ai, mbetet TVSH-ja, të cilën kryeministri e kishte premtuar ta hiqte qysh para dy viteve, por kjo deri më tani nuk ka ndodhur. “Ne kemi kërkuar edhe përshkallëzimin e TVSH për produktet finale të qumështit, e cila do të lehtësonte prodhimin dhe përpunimin e qumështit. Pastaj kemi kërkuar subvencionimin për qumështin e freskët për 5 centë”, - është shprehur Berisha. Sipas tij një problem tjetër për prodhuesit e qumështit është edhe importi

# QUMËSHTARËT NË KRIZË

Konsumimi i qumështit 170 litra për person brenda vitit	
Kërkesat e tregut	339,500 ton
Prodhimi total vendor	257,500 ton/vit ose 76% nga kërkesat e totale
Përpunimi total vendor	34,000 ton-13% nga prodhimi i përgjithshëm
Importi	24% nga konsumimi (djathë dhe qumësht
afatgjatë nga Bullgaria, Sllovenia dhe Turqia)	
Nr. i produkteve të qumështit	19 njësi

i tepërt i qumështit nga të gjitha vendet përreth. Në anën tjetër, përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë thonë se kanë bërë kërkesë që të bëhet përshkallëzimi i TVSH-së për prodhuesit vendorë, por sipas tyre kjo kërkesë ende është duke u proceduar. “Në korrik të vitit të kaluar është miratuar Ligji i ri për TVSH-në dhe ne, si Ministri, duke u bazuar në nenin 26 dhe nenin 60, menjëherë në shtator kemi bërë kërkesë për përshkallëzimin e TVSH-së për prodhuesit vendorë, ku hyjnë edhe prodhuesit e qumështit, të cilët e furnizojnë industrinë përpunuese dhe tregun. Propozimi ynë ka qenë që përshkallëzimi të bëhet në kufirin më të ulët prej 5% dhe kjo kërkesë ende është në procedurë”, - ka thënë Adil Behrmaj, zyrtar i lartë për informim në Ministrinë e Bujqësisë. Ai me tutje ka bërë të ditur se kjo Ministri çdo herë ka përkrahur fermerët vendorë. “Mbështetja jonë është e fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës në fermë, përmirësimin e mekanizmave dhe pajisjeve bujqësore për ngritjen e standardit të cilësisë së qumështit dhe niveli i mbështetjes financiare për këtë sektor arrin në 2.847,894 euro në vitin 2010-të. Po ashtu, edhe gjatë këtij viti, mbështetja e përgjithshme financiare e MBPZHR-së për sektorin e blegtorisë do të jetë rreth 3 milionë euro. Vlen të theksohet se heqja e bazës doganore dhe TVSH-së për inputet dhe mekanizmin bujqësor, si dhe materialin biologjik, ka reflektuar pozitivisht në

ngritjen e të hyrave në fermë dhe në uljen e kostos së shpenzimeve”, - është shprehur Behramja.

## Bie importi i qumështit

Nëse bëhet krahasimi i dy viteve të fundit të importit të qumështit në Kosovë, sipas të dhënave të doganës kosovare vërehet një zvogëlim i importit prej përafërsisht 9 milionë litrave. Vetëm gjatë vitit 2010 në Kosovë janë importuar rreth 14 milionë litra qumësht, me një vlerë prej 9.5 milion euro. Gjatë vitit 2009 janë importuar 23 milionë litra qumësht, me vlerë prej 13.5 milionë euro.

Përkundër rënies së importit të qumështit, nuk vërehet se ka ndonjë ngritje të dukshme të numrit të fermave në Kosovë, që sillet prej 2 deri 3 për qind. Kryetari i Shoqatës së Përpunuese të Qumështit, Ramadan Mema, thotë se nuk ka rritje të sasisë së prodhimit të qumështit vendas. “Sa i përket prodhimit të qumështit në Kosovë, për fat të keq, ai vazhdon të ketë një stabilitet në kuptimin e mosrritjes së sasisë së qumështit i cili prodhohet në Kosovë. Kjo vjen si pasojë e asaj që ende nuk kemi mundur t’i tejkalojmë disa probleme me të cilat është duke u ballafaquar sektori i përpunimit të qumështit. Sa i përket gjendjes në terren vazhdon të kemi disproporcion të madh ndërmjet prodhimit vendas dhe produkteve, të cilat importohen nga vendet e ndryshme, kryesisht të rajonit dhe ky propor-

cion vazhdon të jetë 70 për qind importi, ndërsa ai vendas 30 për qind. Prej disa të dhënave që i kemi prej doganës në vitin 2010 ka pasur një rritje të importit. Vlera e importit është diku rreth 3.5 milionë më e madhe se sa që ka qenë një vit më parë”, - pohon Mema. Sipas të dhënave që posedon Ministria e Bujqësisë, në vend aktualisht janë rreth 4,086 fermerë të gjedhëve me 5 e më shumë krerë të lopëve qumështore dhe rreth 1,460 fermerë që posedojnë më shumë se 20 krerë të kafshëve të imëta.

Qumështi në tregun kosovar përpos si produkt i pastër paraqitet edhe në 19-të produktet e tjera të qumështit, ndër të cilat produkte kryesore janë: qumështi, jogurti, kosi, djathi i bardhë dhe kaçkavalli. Kostoja e prodhimit të qumështit në Kosovë është e lartë (2008) sipas kostos të lartë të furnizimit (70-80% e kostos totale në prodhimin e qumështit) dhe bagëtitë janë zakonisht në stalla, e më rrallë kullosin në livadhe. Mesatarja e çmimit me pakicë është 0.64 €/litër. ■

## Mbi 5 mijë fermerë në Kosovë

Sipas të dhënave që posedon Ministria e Bujqësisë, në vend aktualisht janë rreth 4,086 fermerë të gjedhëve me 5 e më shumë krerë të lopëve qumështore dhe rreth 1,460 fermerë që posedojnë më shumë se 20 krerë të kafshëve të imëta (dele dhe dhi). Numri i fermave deri më tani nuk ka pësuar ndonjë ngritje të dukshme dhe kjo ngritje sillet nga 2-3%, mirëpo është indikative rritja e madhësisë dhe e produktivitetit të tyre.

# KOSOVA MERITON LIBERALIZIMIN

## Intervistoi: Muhamet JAHIRI

**E**shtë ministre e integritimeve evropiane dhe shpreh haptas bindjen e saj se Republika e Kosovës njëanshëm i ka përmbushur të gjitha kriteret dhe meriton ta marrë udhërrëfyesin, i cili do t'i hapte rrugë heqjes së vizave dhe do t'u mundësonte qytetarëve lëvizjen e lirë.

“Po e ripërsëris se ne njëanshëm do ta bëjmë përmbushjen e kriteve dhe iu siguroj se nga momenti i marrjes së udhërrëfyesit në një afat rekord ne do t'u mundësojmë qytetarëve të Kosovës që të lëvizin pa viza. Ne nëse brenda këtij viti e marrim udhërrëfyesin, ju garantoj se në një afat më të shkurtër se njëvjeçar ne do t'i përmbushim të gjitha kriteret”, - ka thënë ajo.

Sipas saj, Bashkimi Evropian nuk po përdor ndaj Kosovës standarde të dyfishta, mirëpo i ka kthyer në kritere mësimet e nxjerra nga përvoja e përfshirjes së vendeve të rajonit në procesin e liberalizimit. Ka folur edhe për bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë duke thënë se këto bisedime do t'i ndihmojnë edhe Kosovës për t'u integruar më shpejt në Bashkimin Evropian. “Çdo hap që ne bëjmë në procesin e bisedimeve do t'i ketë edhe beneficinet e veta edhe në procesin e integritimit evropian”.

Ka shprehur bindjen e saj se pesë vendet e BE-së të cilat nuk e kanë njohur vendin nuk janë pengesë për integrimin e Kosovës në BE.


Për më shumë flet në një intervistë për revistën “Paqja”, ministria e Integritimeve Evropiane, Vlora Çitaku.

**PAQJA: Znj. Çitaku jemi afër njëqind ditëshit, kur keni marrë postin e ministres së Integritimeve Evropiane. Çfarë mund të na thoni për këtë fazë të punës?**

**Çitaku:** Kam fatin që jam përzgjedhur për ta udhëhequr një resor, pra Ministrinë e Integritimeve, institucion i cili është vënë në binarë të drejtë nga ministri i mëparshëm z. Beqaj dhe, së dyti, përfaqëson një resor i cili nuk ka ndonjë kontradiktë të brendshme politike. Mund të them lirisht se procesi i integritimit evropian është një emërues i përbashkët dhe njëra nga pikat në të cilën ka unitet gjithëpërfshirës të spektrit politik,

por edhe të mbarë qytetarëve. Rezoluta për integrim evropian, e cila kaloi para pak ditësh në Kuvendin e Kosovës, është njëri nga dokumentet e rralla, i cili është miratuar me një unitet të plotë mes spektrit politik në Kuvend. Kjo jep lehtësim në përmbushjen e synimeve në një anë, ndërsa në anën tjetër e shton përgjegjësinë për angazhim më të madh dhe më gjithëpërfshirës. Shpeshherë ka pasur një keqinterpretim rreth procesit të integritimeve, i cili është konsideruar si proces i jashtëm, por në fakt ky është proces i një dinamike të brendshme dhe ka të bëjë esencialisht me krijimin e mundësive evropiane në Kosovë. Kosova ka ende shumë probleme kronike, të cilat janë trashëguar me dekada, megjithatë progres i madh është shënuar deri më tani; sot Kosova nuk mund të krahasohet me Suedinë e as me Finlandën, por jemi në hap dhe në shumë pika jemi më të avancuar se vendet e rajonit.

**PAQJA: A mund të na thoni se cilat janë sfidat në të cilat jeni përqendruar kryesisht gjatë kësaj kohe?**



**Çitaku:** Qeveria e Republikës së Kosovës, menjëherë pas konstituimit të saj, ka marrë një varg masash në drejtim të avancimit të agjendës evropiane për Kosovën. Në njërin nga mbledhjet e para të qeverisë është marrë vendim për themelimin e departamenteve për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në të gjitha ministrinë e linjës. Po ashtu janë miratuar dhjetë objektivat strategjike në sferën e integritimit evropian, si dhe është miratuar plani i veprimit për partneritet evropian për këtë vit, i cili në esencë përbën një hap përpara si në aspektin kuantitativ, ashtu edhe në atë kualitativ. Janë paraparë edhe rreth 400 veprime me të cilat duhet të merren institucione, dhe secili prej këtyre veprimeve i ka indikatorët e tij, parametrat, dhe çfarë është e rëndësishme është i buxhetuar. Mbi 80 për qind e veprimeve të parapara për partneritet evropian për vitin 2011 janë të buxhetuara. Normalisht prioritet të qeverisë së Kosovës për integritime evropiane mbetet përmbushja e kriteve për liberalizimin e vizave dhe avancimi i agjendës për fillimin e negociatave për arritjen e marrëveshjes tregtare.

Për shkak të situatës së re të krijuar

pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së traktatit të Lisbonës, Kosova nuk përfiton nga masat tregtare, por shpresojmë se kjo çështje do të zgjidhet së shpejti dhe kemi biseduar edhe me Brukselin që kësaj çështjeje t'i jepet zgjidhje. Shpresojmë se Kosova do të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian këtë vit dhe shpresojmë se do të kemi sinjale pozitive edhe nga ana e Komisionit Evropian.

## Në qershor fushatë për integrimet në komuna

**PAQJA: Gjatë mbledhjes së Qeverisë është diskutuar disa herë për departamentet për integrimet që janë krijuar. Ka pasur thirrje që këto zyra të shtrihen edhe nëpër komuna. Cili është projekti i Ministrisë për drejtoritë nëpër Komuna?**

**Çitaku:** Ne kemi pasur dy takime me zyrtarë të nivelit komunal, të cilat kanë qenë takime konstruktive. Edhe kryeministri Thaçi ka pasur një takim me kryetarët e komunave, takim që është mbajtur para pak javësh, me ç' rast është diskutuar për gjetjen e formave më të avancuara për ngritjen dhe pozicionin e zyrtarëve për integrimet evropiane, në nivel komunal. Për këtë arsye do të mbahet edhe takimi për finalizimin e një rregulloreje të veçantë, në bazë të së cilës zyrat për integrim në nivelin komunal do të kthen në drejtori dhe njëri nga nënkryetarët e komunave do të ngarkohet ekskluzivisht me çështjen e integritimit evropian dhe riintegrimin e personave të adresuar. Në pjesën e dytë të qershorit, unë personalisht, bashkë me kolegët e ministrisë, do të kemi një fushatë nëpër komuna për rrugën e inte-

grimit të Kosovës në BE, ku do të kemi bashkëbisedim jo vetëm me pushtetin lokal, por edhe me shoqërinë civile.

**PAQJA: A besoni se këto zyra kanë arritur pjekurinë dhe kanë kapacitete të mjaftueshme për t'u shndërruar në drejtorate?**

**Çitaku:** Ky është një vendim i cili merret në nivel komunal, ne kemi një legjislacion, i cili u jep komunave kompetenca të mjaftueshme në përcaktimin e politikave kadrovike, mirëpo themelimi i drejtorive është vendim qeveritar, ndërkohë që emërimi i udhëheqësve i takon komunave.

## Kosova i ka përmbushur kriteret

**PAQJA: Ditë më parë edhe në Kosovë u shënuua Dita e Evropës, me ç' rast u panë qartë aspiratat tona për integrim në BE, mirëpo përkundër kësaj Kosova vazhdon të mbetet një vrimë e zezë në rajon duke mos u përfshirë në procesin e liberalizimit. Ç'mund të na thoni në lidhje me këtë?**

**Çitaku:** Përmbushjen e kriterëve, reformave dhe agjendën evropiane, ne ia kemi për borxh jo Komisionit Evropian, por qytetarëve të Kosovës. Ne njëanshëm, pavarësisht marrëdhënieve kontraktuale me BE-në, duhet të punojmë në thellimin e reformave, sepse ky është zotimi që e kemi bërë para qytetarëve të Kosovës. Pavarësisht se jemi vendi i vetëm në rajon pa marrëdhënie kontraktuale me BE-në dhe se qytetarët e Kosovës janë të vetmit që duhet të presin pranë ambasadave për viza, kjo nuk duhet të na dekurajojë për t'i kryer obligimet tona. Procesi i integritimit evropian dhe ai i liberalizimit është proces politik, por mbi të gjitha është proces teknik, prandaj ne duhet t'i kryejmë detyrat e shtëpisë dhe të prodhojmë argumente për partnerët e Kosovës, miqtë tanë që ta shtyjmë përpara agjendën për Kosovën. Ne kemi përmbushur shumë kriterë njëanshëm, kemi miratuar ligjin për riadresim vitin e kaluar, kemi miratuar strategjinë për riintegrimin e personave të adresuar, kemi alokuar një fond në nivelin qeveritar për riadresimin e personave, kemi funksionalizuar zyrat komunale për riintegrim, pra kemi shënuar shumë hapa përpara.

**PAQJA: Sipas jush janë bërë shumë hapa dhe plotësime të kriterëve teknike, por a mund të na thoni se a po përdor BE-ja**

## standarde të dyfishta për Kosovën?

**Çitaku:** Ne duhet ta qartësojmë një gjë, se i tërë koncepti i integritimit në BE bazohet në mësimet e marra. Kjo nënkupton se mësimet të cilat BE-ja i ka nxjerrë nga praktikatat e deritashme të pranimit të vendeve të reja, i kthen në standarde për vendet, të cilat presin integrimin. Mësimet e marra nga procesi i liberalizimit të vizave në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi, Shqipëri, Bosnje janë kthyer në kritere për Kosovën. Normalisht, për ne do të jetë shumë më rigoroz, por ky është koncepti mbi të cilin BE vepuron dhe ne nuk kemi asgjë kundër.

**PAQJA: A është e drejtë një gjë e tillë?**

**Çitaku:** Nuk mund të gjykoj a është e drejtë a jo, por kjo është praktika mbi të cilën funksionon Bashkimi Evropian. Ne kemi të drejtë të insistojmë se është koha për fillimin e procesit të integritimit. Ne e dimë se Kosova nuk është e gatshme të jetë anëtarë e BE-së, por e dimë se Kosova sot është e gatshme të filloj procesin integruar, Kosova s'mund të krahasohet me Finlandën, por është në të njëjtin stad të zhvillimit me vendet e rajonit.

## S'na pengojnë mosnjohjet nga pesë vendet e Be-së

**PAQJA: Një nga pengesat që i krijon barriera Kosovës është edhe mosnjohja e saj nga pesë vendet e BE-së. Sa po e pengon kjo integrimin e Kosovës dhe a keni ndonjë koordinim me Ministrinë e Jashtme për ta shtuar presionin mbi këto vende?**

**Çitaku:** Ka pasur deklarime edhe publike nga vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, por që janë pjesë e BE-së, në raport të perspektivës evropiane të Ballkanit perëndimor janë pro përfshirjes edhe të Kosovës. Kam parasysh këtu projektin e kryeministrit grek Papandreu për integrimin e Ballkanit në vitin 2014, së fundi edhe deklaratën e Ministrisë së Jashtme të Sllovakisë. Një frymë të njëjtë lehtësuese kemi po ashtu nga të gjitha vendet e BE-së, përfshirë këtu edhe pesë vendet që nuk na kanë njohur. Për të qenë të sinqertë, për procesin e liberalizimit të vizave nuk janë problem pesë vendet që nuk na kanë njohur, por janë shqetësimet e disa vendeve anëtare, të cilat nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me Kosovën, por me kërkesën e azilkërkuesve dhe refugjatëve në tërësi.



## Dialogu me Serbinë, ndihmon integrimin

**PAQJA:** *Znj. Ministre, tashmë Kosova ka nisur bisedimet me shtetin serb dhe këto bisedime janë vlerësuar si lehtësim për shtetin serb për të vazhduar rrugën drejt integritimeve evropiane. A ka ndonjë kërkesë edhe nga ana e Kosovës që të përfitojë konkretisht nga këto bisedime për rrugën e saj evropiane?*

**Çitaku:** Nuk besoj se këto bisedime janë për lehtësimin e rrugës së Serbisë, por bashkëpunimi rajonal është parakusht për integrimin evropian. Edhe Kosova duke u përfshirë në këtë proces vetëm po e përmbush një kriter të vetin. Kosova dhe Serbia shqyr më në fund do të jenë vetëm fqinj, prandaj duhet të fillojmë të mendojmë për t'i normalizuar marrëdhëniet mes dy popujve. Dialogu mes Prishtinës dhe Beogradit nuk zhvillohet në vakum, në atë tryezë janë të ulur edhe zyrtarë nga Komisioni Evropian - Sekretariati për Zgjerim, ne kemi të ftuar edhe përfaqësuesit e SHBA-ve që të jenë aty. Çdo hap që ne bëjmë në procesin e bisedimeve do t'i ketë edhe beneficinet e veta edhe në procesin e integritimit evropian.

**PAQJA:** *Edhe pak muaj kanë mbetur deri te publikimi i Raportit të Progresit, a pritni që të jetë raport më pozitiv sesa ai i vitit të kaluar, kur kemi parasysh se aty ka pasur shumë vërejtje?*

**Çitaku:** Publikimi i Raportit të Progresit këtë vit do të jetë mjaftë sfidues për institucionet e Republikës së Kosovës dhe kjo për shumë arsye. E para ne kaluam nëpër një proces të gjatë elektoral dhe u desh shumë kohë deri në konsolidimin e institucioneve të Kosovës. Këtë vit Raporti i Progresit, për shkak të marrëveshjes së Lisbonës, publikohet më herët dhe institucioneve të Kosovës u jep shumë më pak kohë për t'u angazhuar, për t'i përmbushur sfidat, të cilat dalin nga raporti. Një gjë duhet të saktësohet se Raporti i Progresit nuk është skanim i vetëm i punës së qeverisë edhe pse është krijuar përshtypja për një gjë të tillë, por ky raport vlerëson paraqitjen e të gjitha institucioneve të Kosovës: Qeverisë, Kuvendit, Gjykatave, Policisë, shoqërisë civile, partive politike, pra është raport shumë kompleks dhe shumë dimensional.

**PAQJA:** *Pavarësisht kësaj përgjegjësie më e madhe i bie Qeverisë së Kosovës. Sa janë bërë përgatitjet për një paraqitje*



*dhe qasje sa më pozitive në këtë raport?*

**Çitaku:** Po punojmë me një dinamikë jashtëzakonisht të madhe. Kemi arritur që të riadresojmë dhe identifikojmë pikat kyçe në të cilat jemi përqendruar dhe në të cilat besojmë se do të kemi sukses. Besoj se Raporti i Progresit do të evidentojë progresin që kemi shënuar gjatë kësaj periudhe kohore. Por duhet ditur sesa më afër të jetë Kosova ndaj Bashkimit Evropian, aq më kërkuar bëhet Komisioni Evropian në raport me Kosovën. Mjafton të lexohen raportet e progresit të vendeve të rajonit, pra të lexohet raporti për Kroacinë dhe ju do të vëreni sesa më afër integritimit me BE-në aq më të mëdha janë kërkesat që parashtrihen për vendin i cili ka aspirata. Jam e bindur se do të shënojmë progres, mirëpo nuk kam iluzione.

**PAQJA:** *A do ta marrë Kosova këtë vit udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, apo ka të paktën ndonjë shenjë pozitive në këtë drejtim?*

**Çitaku:** Ka shenja pozitive, megjithatë nuk dua të japë data e kohë. Ju e dini se nga viti i kaluar kur është publikuar Raporti i Progresit, komisioneri Fyle ka deklaruar se shumë shpejt Kosovës do t'i jepet udhërrëfyesi dhe nga ai deklarim kanë kaluar shtatë-tetë muaj dhe udhërrëfyesi ende nuk ka ardhur. Dua të përsëris se arsyeja se pse Kosovës nuk i ka ardhur udhërrëfyesi nuk lidhet më përmbushjen e kriterëve nga ana e Kosovës, sepse kriteret i kemi mbushur, nuk ndërlihet as me bllokadën në kuadër të KE-së, por janë shqetësimet e disa vendeve të BE-së lidhur me politikën e liberalizimit të vizave

në përgjithësi. Pavarësisht kohës se kur do të merret udhërrëfyesi, ne, njëanshëm, po bëjmë përmbushjen e kriterëve p.sh, t'i marrim pasaportat biometrike dhe pajisja e qytetarëve me to është një fazë integruese, e cila duhet të përmbushet shumë më vonë, ndërkohë që ne njëanshëm do të nisim pajisjet me pasaporta në muajin tetor etj. Jam e bindur se Kosova pas marrjes së udhërrëfyesit, në një afat rekord do të jetë në gjendje që t'i përmbush kriteret e mbetura.

**PAQJA:** *Po këto vendet të cilat po pretendoni se po pengojnë liberalizimin e vizave, a janë vende që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës apo janë vendet e tjera?*

**Çitaku:** Jo nuk janë pesë vendet e BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën, pengesë për çështjen e liberalizimit, por janë vende të cilat janë goditur ditët e fundit nga valë të mëdha refugjatësh, të cilat tash kanë shprehur hapur qëndrimin e tyre për politikën e liberalizimit. Ne duhet t'ua sqarojmë qytetarëve se kjo nuk është e orientuar kundër tyre, e as nuk është ndonjë konspiracion, ose politikë antiKosovë, por thjesht janë shqetësime. Kosova assesi nuk mund të mbetet vrimë e zezë dhe një gjë e tillë as nuk do të lejohet, Kosova është pjesë integrale e BE-së, ne jemi evropianët e rinj dhe assesi nuk do të lejojmë që të mbetemi ishull i izoluar.

**PAQJA:** *Znj. Çitaku, qoftë nga premtimet e Qeverisë së kaluar, qoftë nga premtimet që janë bërë nga subjektet politike, të gjithë kanë deklaruar se viti 2012 është viti kur qytetarët e Kosovës do të lëvizin pa viza. Ka qenë premtim apo thjesht një gjë e tillë do të ndodhë?*

**Çitaku:** Po e ripërsëris se ne njëanshëm do ta bëjmë përmbushjen e kriterëve dhe u siguroj se nga momenti i marrjes së udhërrëfyesit në një afat rekord ne do t'u mundësojmë qytetarëve të Kosovës që të lëvizin pa viza. Ne nëse brenda këtij viti e marrim udhërrëfyesin ju garantoj se në një afat më të shkurtër se njëvjeçar do t'i përmbushim të gjitha kriteret.

**PAQJA:** *Do të thotë viti 2012?*

**Çitaku:** S'do të doja të jap datë sepse nuk varet nga ne se kur do ta marrim udhërrëfyesin, por unë u siguroj se prej momentit kur do ta kemi udhërrëfyesin, brenda një viti, do t'i përmbushim kriteret. ■

# KRIMINALITETI KËRCËNON TURIZMIN



**Ndriçim HOXHAI**

**P**ërderisa qeveria shqiptare ka bërë dhe po bën përpjekje serioze për krijimin e kushteve të volitshme për mbarëvajtjen e sezonit të sivjetmë turistik, janë disa raste alarmante të cilat mund ta cenojnë dukshëm turizmin në Shqipëri. Rrugaçëria, vandalizmi, kriminaliteti dhe sjelljet devijante psiko e sociopatologjike mund të paraqesin kërcënim serioz për turizmin. Elementë të ndryshëm keqbërës që e frekuentojnë ende Shqipërinë, me sjelljet e tyre kanë shkaktuar akte të tilla të pështira, që vit pas viti mund ta lënë Shqipërinë pa asnjë turist.

Nga ana tjetër dihet se shteti shqiptar ka investuar dhe investon gjithnjë e më shumë në këtë sektor ekonomik, prej të cilit të hyrat janë më të mëdha.

Për t'i eliminuar dukuritë negative, forcat e rendit po ndërmarrin aksione të ndryshme për të krijuar ambient sigurie në prag të fillimit të vërshimit të valës më të madhe të turistëve anekënd botës.

Kështu policia është vënë në gjurmë të disa personave që kanë kryer vepra të rënda ndaj shtetasve të huaj, të cilët kanë qëndruar në Shqipëri si turistë.

Pesë vjet pas përdhunimit të një turisteje çeke në Qafën e Zvezdës në Korçë, policia ka prangosur njërin prej kryerësve të veprës penale. Ai ishte shpallur në kërkim menjëherë pas identifikimit të tij të "kryerjes së marrëdhënieve sek-

suale me dhunë" dhe "vjedhje me dhunë". Burimet zyrtare të policisë lokale kanë bërë të ditur se Maljan Mecolli, 24 vjeç nga fshati Zvezdë, u arrestua në pikën e kalimit kufitar të Kapshticës, pasi ishte shpallur në kërkim për përdhunimin e turistes çeke, Alena Kodakova. Ndaj tij rëndon edhe akuza e vjedhjes së turistes dhe bashkudhëtarit të saj. 24-vjeçari përdorte identitet të rremë prej disa vitesh. Ai jetonte në Greqi që nga viti 2006 dhe u kap pas një operacioni policor, të organizuar pas indikacioneve të marra për vendndodhjen e tij. 24-vjeçari është identifikuar më pas nga policia, ndonëse është paraqitur në pikën kufitare me identitet tjetër. Në gusht të vitit 2006, opinion publik në Korçë u shokua kur dy turistë çekë iu drejtuan policisë me një denoncim fillimisht për vjedhje me dhunë. Më pas, turistja çeke në prani edhe të një përkthyesi, ka deklaruar se ishte përdhunuar nga dy persona. Robert Tropek dhe shoqja e tij, Alena Kodakova, kishin ardhur si turistë për të vizituar disa ditë zonën e Prespës dhe të Liqenasit. Ata kishin vendosur të lëviznin në këmbë për të shijuar bukuritë natyrore të zonës. Në ndërkohë përderisa ishin ndalur në fshatin Zvezdë të Korçës për të drekuar, dy turistët kanë njohur dy të rinj të zonës, të cilët janë ofruar për t'i 'ndihmuar' në rrugëtimin e tyre turistik. Maljan Mecolli, atëherë 18 vjeç, bashkë me shtetasin Redion Terolli, në atë kohë i mitur, vetëm 15 vjeç, u kanë ngritur

kurth turistëve çekë. Autorët u kanë sugjeruar dy turistëve të huaj të vizitonin zonën e Liqenasit dhe janë shprehur të gatshëm për t'i shoqëruar në këmbë në mungesë të një makine. Në afërsi të qafës së Zvezdës, në mes të pyllit, ata kanë ushtruar dhunë fizike ndaj Robert Tropekut, për t'i vjedhur paratë dhe sendet që kishte me vete. Pasi u kanë marrë një aparat fotografik dhe telefonat celularë, adoleshentët i kanë detyruar me dhunë turistët t'u japin paratë që kishin në çanta. Ata kanë arritur të marrin 200 dollarë, 70 euro dhe 250 korona, si dhe një sasi dinarësh dhe më pas përmes dhunës fizike e kanë lidhur turistin e huaj në një pemë. Më pas dy adoleshentët kanë kryer marrëdhënie seksuale me dhunë me turisten, që atëherë ishte 19 vjeçe.

Pas krimit, autorët e krimit i kanë lënë dy të huajt në pyjet e parkut kombëtar dhe janë larguar me mjetin e tyre tip "Mercedes Benz" drejt kufirit me Greqinë. Policia në atë kohë arriti t'i identifikonte autorët e ngjarjes, nga mjeti që kishin përdorur, i cili u gjet disa ditë më pas i braktisur. Dy turistët çekë bënë edhe denoncimin në Policinë dhe Prokurorinë e Korçës në gusht të vitit 2006. Autori Maljan Mecolli është dënuar në mungesë me 8 vjet burg dhe është kapur mëngjesin e së martës si person i shpallur në kërkim, ndërkohë që bashkëfshatari i tij Redion Terolli ndodhet në burg. Ai u kap disa muaj pas ngjarjes dhe u dënua në vitin 2007 me tetë vjet heqje lirie.

# KUR MBAROJNË HETIMET?



**Linda BERISHA**

Në gusht të vitit 2006, dy autorët e përdhunimit të shtetasës çeke, Alena Kodakova, u shpallën në kërkim policor. Ata u larguan për në Greqi, menjëherë pas ngjarjes. Në atë kohë u kryen shumë kërkime në zonë dhe në fshatrat përreth, madje u kontrolluan edhe shtëpitë e braktitura në të cilat mund të strehoheshin autorët, por nuk u gjet asnjë gjurmë e tyre. Në gusht të vitit 2008, dy vjet pas ngjarjes, Redion Terolli, në atë kohë 17 vjeç u kap nga policia në Athinë dhe u ekstradua për llogari të Interpolit të Tiranës. Në datë 22 janar të vitit 2007 ai u dënua në mungesë bashkë me autorin tjetër Maljan Mecolli me tetë vjet heqje lirie. Ky i fundit është kapur këto ditë në saje të operacionit të koduar "Identiteti i Rremë". Mësohet se ai ka qëndruar gjatë gjithë kësaj kohe në Greqi dhe duke përfituar nga koha e gjatë, kishte vendosur të kthehet në fshatin e vet, tashmë me identitet të falsifikuar.

Në prill të vitit 2004, shtetasja italiane, Anna Ferrari, 49 vjeçe, ra pre e rrëmbimit, grabitjes dhe përdhunimit prej dy personave. Gjatë rrugës për në Jug të Shqipërisë, në vendin e njohur si "Rrepet" në Fier, 49-vjeçarja është takuar me Artan M. 34 vjeç, nga qyteti i Fierit, i cili udhëtonte me Gëzim B. 25 vjeç, nga fshati Mbyet i Fierit. Ata i kanë ofruar asaj transportin drejt qytetit bregdetar të Vlorës, por më pas e kanë grabitur dhe përdhunuar në Qafën e Shkozës, dy kilometra larg qytetit të Fierit. Më pas ata e kanë braktisur në rrugë pranë fshatit Levan.

Dhe së fundi në datën 17 maj të këtij viti, Policia e Dibrës arrestoi një person të dyshuar për përdhunimin e një shtetaseje të huaj. Andrea Izvira, 43 vjeç, nga fshati Çerenec, i Komunës së Gjoricës në Rrethin e Bulqizës, u ndalua nga policia pasi akuzohet se ka përdhunuar një turistë nga Maqedonia. Ngjarja ka ndodhur dy vite më parë në vendin e quajtur Ura e Çerenecit. Mësohet se gruaja ka denoncuar përpara policisë në atë kohë se ka qenë duke udhëtuar në një mbrëmje vonë në rrugën nacionale drejt qytetit të Peshkopisë, kur ka rënë pre e dhunës seksuale.

Të gjitha këto dhe aktet e ngjashme ndaj shtetasve të huaj turistë në Shqipëri, nga element keqbërës mund të ndikojnë tejet negativisht në targetimin e Shqipërisë si vend i farvorshëm për t'u vizituar. Prandaj prioriteti i qeverisë shqiptare këtë vit mbetet siguria dhe luftimi i pakompromis ndaj këtyre veprimeve të ulëta që i japin imazh negativ vendit. ■

**NË KRYE TË SHTETIT TONË, TANI KEMI NJË FEMËR!** Sa bukur tingëllon kjo për veshin e një femre kosovare. Si duket kjo epokë na përket neve dhe vetëm neve. Kështu mund të mendojnë shumë nga femrat që jetojnë në shtetin e ri të quajtur Kosovë, por jo edhe realiteti është i tillë. Pozita e femrës në këtë shoqëri dhe shumë shoqëri të tjera që pretendojnë të jenë demokratike, nuk ka ndryshuar shumë nga shekujt e kaluar. Sot jemi dëshmitarë të shkeljeve të mëdha në aspektin gjinor dhe, po ashtu, edhe atë njerëzor.

Derisa ne filluam të ndihemi më të fuqishme dhe më të respektuara në rrethin tonë shoqëror, sepse tani më kemi një femër që i prin gjithë shtetit, në kryeqytetin tonë Prishtinë, vritet një femër në pikë të ditës dhe askush nuk çan kokën për këtë. Çdo ditë dëgjojmë deklarata nga institucionet vendore se Kosova është vend i sigurt, se në Kosovë respektohen të drejtat dhe liritë e njeriut, se Policia e Kosovës, po kujdeset mjaft mirë për ruajtjen e rendit dhe qetësisë. A thua të vritesh është e drejtë njerëzore apo të turbullosh një shoqëri të tërë është qetësi dhe rend?!

Para pak javësh në Prishtinë, ndodhi një vrasje e rëndë. U vra një femër e zonja, e bukur, e vendosur për të kërkuar shumë nga vetja dhe nga jeta dhe, mbi të gjitha, një nënë e një femre tjetër. E ndjera Dijanë Kastrati kishte kërkuar

shumë herë mbrojtje nga Policia e shtetit të saj, i cili s'që në gjendje të bëjë asgjë për të. Sido që të jetë ajo nuk jeton më, sepse rrugëtimi i saj në jetë u ndërpre nga një person pa karakter, pa ndërgjegje, pa asgjë përveç idiotësisë, një njeri i cili për teket e tij lë një fëmijë jetim, një familje dhe shumë miq të pikëlluar për mungesën e Dijanës.

Shpesh thuhet se duhet të tërhiqet vëmendja për gjërat para se të ndodhin dhe këtë e kishte bërë Dijana disa herë, duke trokitur në dyert e policisë e gjyqësisë për të treguar se ndihet e rrezikuar dhe për të kërkuar mbrojtje. Fatkeqësisht, askush nuk ishte marrë seriozisht me lutjet e saj dhe tani ndodhi kjo që ndodhi, humbi një jetë njeriu, e shumë të tjera u trazuan. Por, a i bije ndërmend dikujt të vendosë drejtësi për këtë rast, ani pse njeriu nuk jeton më, të paktën të kërkohet llogari për vrasjen e saj. Hetimet vazhdojnë, një klishe e njohur tashmë për ne, por a thua vërtet janë duke vazhduar hetimet apo rasti është mbyllur pa u hapur fare?!

Mbi çfarë të besojmë ne se vërtet policia po merret me rastin, se në bankën e të akuzuarve do ta shohim një ditë vrasësin e Dijanës, kur dihet mirë se nëpër gjykatat tona gjenden lëndë të mykura nga vitet?! Çfarë duhet bërë që të ndryshohet ky sistem qeverisës? Një pyetje që vështirë i gjendet përgjigje, sepse cilido të vijë në pushtet është i njëjtë, asgjë veç emrave nuk ndryshojnë nga këta që janë sot. ■

# Erdogani shënoi sërish fitore

Arsim JONUZI

**K**ryeministri i Turqisë, Taip Erdogan dhe partia e tij AK shënuan për herë të tretë një fitore bindëse në zgjedhjet e fundit. Mirëpo edhe pse shumë domethënëse, fitorja nuk arriti numrin e duhur për t'i lejuar Erdoganit ndërrimin e kushtetutës pa referendum. Së këtejmi pritet bashkëpunimi i AK me forca të tjera në vend për zëvendësimin e kushtetutës, e cila ishte shkruar rreth 30 vjet më parë, gjatë regjimit ushtarak. Prandaj kryeministrit Erdogan i nevojitet konsensus për krijimin e kushtetutës së re të planifikuar. Mirëpo a do të mund ta arrijë atë? Erdogan, partia e të cilit e transformoi Turqinë në një nga ekonomitë me rritjen më të shpejtë, ndodhet në një udhëkryq politik, megjithëse kjo mund të mos jetë shumë e dukshme.. Rezultatet ekonomike të vendit gjatë këtyre viteve në pushtet, janë të qarta fare mirë. Janë ngritur tregjet financiare dhe lira turke u forcua kundrejt dollarit, siç bënë edhe bonot turke. Besimi i investitorëve po rritet.

"Kushtetuta e re do të kërkojë konsensus dhe dialog me parti të tjera dhe me shoqërinë në përgjithësi", - tha për Reuters Cengiz Aktar, profesor i Universitetit të Stambollit Bahcesehir. "Duhet të shohim nëse Erdogan është i gatshëm për ndryshimet me maxhorancën e tij, apo nëse do të vazhdojë të imponojë pikëpamjet e tij për Turqinë dhe në këtë rast do të kishim kohë të vështira." Megjithëse Erdogan nuk fitoi vende të mjaftueshme sa për të thirrur një referendum për kushtetutën, AK mori fitoren më të madhe prej ardhjes në pushtet më 2002 dhe gazetaret turke lavdëronin suksesin e tij. "Turqia

e do atë", "Mjeshtri i votave", shkruanin faqet e tyre të para me fotot e Erdoganit të buzëqeshur, duke përshëndetur me dorë mbështetësit e partisë jashtë godinës.

Kritikët tremben se Erdogan mund ta përdorë fitoren për të çimentuar pushtetin dhe kufizimin e të drejtave. Në fjalimin e tij të fitores, përpara mijëra mbështetësve në kryeqytetin Ankara, ai u zotua për "përrulësi" dhe bashkëpunim me të gjithë rivalët. "Njerëzit na dhanë mesazhin e tyre për të ndërtuar kushtetutën e re me anë të konsensusit dhe negociatave dhe ne do ta diskutojmë atë me partitë e opozitës. Kushtetuta e re do të plotësojë kërkesat e paqes e drejtësisë."

Turqia, si kandidate për Bashkimin Europian dhe partia e Erdoganit është cituar shpeshherë si një model i mbështetjes së demokracisë në epokën e kryengritjeve arabe të protestave antiautoritare, siç janë ato të Lindjes së Mesme e të Afrikës Veriore. Por kritikët thonë se partia e Erdogan ka lindur nga lëvizje islamike më parë të ndaluara dhe kërkon të vendosë agjendën sociale konservatore. Pas fitores ndaj partive të stabilimentit të vjetër, Erdogan ka qenë sfidues edhe ndaj gjyqësorit e ushtrisë së ndarë nga feja, me reformat e kuadrit të aderimit në BE. Ai ka krijuar gjithashtu një kurs të ri të politikës së jashtme si anëtar i NATO-s e aleat i SHBA-së, duke krijuar në të njëjtën kohë lidhje të afërta në rajon. Lideri i ri i opozitës ateiste të Partisë Republikane e Popullit (CHP), e cila mori rezultatin e saj më të mirë në 30 vjet me 25.9 të votave, paralajmëroi Erdoganin se do t'i ndiqte nga afër lëvizjet e tij. "Ne i urojmë sukses AKP, por ata duhet të mbajnë mend se tani ka një parti kryesore të opozitës", - tha

Kemal Kilicdaroglu. Analistët financiarë paralajmëruan se një mazhorancë tepër e madhe për AK-në do ta polarizonte vendin, i cili ka ndarje etnike e fetare minoritetesh. Prandaj një mazhorancë e kufizuar shihet si pozitive për trajtimin e disbalancave ekonomike e sociale. "Kjo u hap rrugën autoriteteve për forcimin e politikave të tyre", - tha Benoit Anne, drejtues strategjish i Societe Generale. "Ne do të dëshironim të shihnim më shumë disiplinë fiskale. Kjo mund të arrihet pas zgjedhjeve dhe skenari ideal do të ishte shtrëngimi i rolit të bankës qendrore." Ka pasur spekulime se Erdogan do të kërkojë të vendosë një sistem më shumë presidencial qeveritar, me qëllimin final për t'u bërë vetë president. Përveç ekonomisë, qeveria e Erdoganit duhet të kujdeset dhe për konfliktet separatiste në juglindjen kurde të vendit. Paraqitja e fortë e partisë pro kurde BDP i mohoi shumë vota AK. Analistët thonë se Erdogan do të duhet të fokusohet në iniciativën tashmë të zbehur të aderimit në BE dhe në trazirat në Sirinë fqinje, nga ku mijëra refugjatë po vijnë drejt Turqisë, duke iu larguar dhunës. Më shumë se 3.000 sirianë janë larguar drejt Turqisë për t'i shpëtuar fushatës shtypëse të ushtrisë që autoritetet po përgatisin, teksa Turqia po hap një kamp të tretë për të strehuar mijëra të ardhurit. Numri i të ardhurve të rinj po shtohet teksa ushtria siriane po afrohet në një qytezë pranë kufirit ku më parë ishin regjistruar përplasje, teksa televizioni vendor njoftonte për nisjen e arrestimeve të të ashtuquajturve kundërshtarë të armatosur. Një nga gazetaret kryesore turke, Hurriet, tha se zyrtarët turq po merrnin në konsideratë masa drastike emergjence. ■



# FJALIMI I OBAMËS PËR LINDJEN E MESME: NJË HAP I RËNDËSISHËM PËRPARA, POR NJË RRUGË E GJATË PËR TË SHKUAR

**John ESPOSITO**

**D**uke i folur botës islame, në fjalimin e fundit presidenti Barak Obama u ballafaqua me një audiencë shumë më skeptike, të zhgënjyer për pothuajse pamundësinë për të futur në agjendën e tij atë se çfarë pati thënë në fjalimin e Kajros. Besueshmëria e tij kërkon më tepër se retorikë dhe gjuhë të ndjeshme kulturore – një qasje të re të politikës së jashtme amerikane.

Pa deklaruar në mënyrë të drejtpërdrejtë dështimin e sistemit konvencional të SHBA-së dhe BE-së për politikën në Lindjen e Mesme (duke barazuar mbrojtjen e interesave kombëtare me stabilitet dhe siguri të regjimeve autoritare), Obama e ndërroi këtë sistem me një tregim të ri: ndjekjen e interesave kombëtare për parime të vetëvendosjes, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Obama mori një qëndrim të fuqishëm në mbështetje për ndryshim demokratik, duke theksuar se kjo politikë do të ishte e njëjtë për miqtë dhe armiqtë, se përpjekjet për të marrë pushtetin me dhunë se sa me miratim e pëlqim nga populli nuk do të tolerohen. Në këtë kontekst, ai foli për trazirat në Bahrejn, Jemen dhe Siri. Megjithatë, derisa ai mbështeste ndryshimin paqësor ose jo të dhunshëm demokratik dhe duke kritikuar represionin qeveritar, thirrja e tij për Bashar Assadin ishte që të tërhiqet nëse ai vazhdon t'i rezistojë ndryshimit, sepse kjo nuk përkonte me shembullin e ballafaqimit të familjes sunduese në Bahrejn, që ka qenë brutale në shtypjen e saj dhe të lëvizjes demokratike të popullit të saj dhe të shtypjes së shumicës shi'ite, ose me dhunën e vazhdueshme në Jemen. Një sfidë për administratën e Obamës, që dukej edhe gjatë fjalimit të tij, ishte çështja e reformave në Arabinë Saudite dhe në disa shtete të Këshillit Bashkëpunues të Gjirit dhe mbështetjen e tyre ushtarake për familjen Al Halifa në Bahrejn, përkundër dështimit të saj për të implementuar reformat.

Presidenti mori poenë nga përkushtimi për t'i dëgjuar dhe ndihmuar grupet



e shoqërisë civile dhe duke njoftuar për përkrahjen e madhe të SHBA-së për zhvillim ekonomik. Ashtu siç kanë raportuar edhe sondazhet e fundit të Gallup World dhe Pew, ndihmesa ekonomike, teknologjike dhe edukative janë vlerësuar shumë dhe janë mirëpritur në shumë vende islame dhe do të jenë kritike për demokracitë e reja.

Në mënyrë jo të çuditshme, diskutimi i Obamës për konfliktin izraelito-palestinez dhe procesin e paqes ishte edhe më dëshpërues për të dyja qeveritë, palestineze dhe izraelite. Ashtu si në fjalimin e tij të Kajros, ai përsëri pranoi shqetësimet për sigurinë e izraelitëve dhe vuajtjet e palestinezëve dhe poshtërimit nën një okupim të papërshtatshëm për mbrojtje. Obama, për të befasuar shumicën dhe për të marrë refuzimin e Netanjahut, foli për zbatimin e shtetësisë së Palestinës dhe një Izrael të sigurt të bazuar në kufijtë e 1967-s. Ndonëse kjo vë në pikëpyetje legjitimitetin e të gjitha vendbanimeve, mungonin fjalët e Obamës që kishte thënë në fjalimin e Kajros: "Shtetet e Bashkuara nuk pranojnë legjitimitetin e vendbanimeve të vazhdueshme izraelite".

Kritika e Obamës, e asaj që ai e përshkroi si përpjekje e palestinezëve për të delegitimuar Izraelin dhe "për të turpëruar Izraelin" me rezolutën e shtatorit të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, nuk u shoqërua me kritika ekuivalente të qeverisë së papajtueshme të Netanjahut. Veç kësaj, në vend që të pranojë kushtet që dër-

guan në arritjen e Abasit të Hamsi dhe të drejtën e palestinezëve për të çuar përpara marrëveshjen e unitetit mes Fatahut dhe Hamasit, ai zgjodhi për të theksuar se kjo marrëveshje ngre më shumë vështirësi, duke injoruar faktin se pozicioni i vijës së ashpër dhe politikës së koalicionit Netanjahu-Liberman gjithashtu ngrenë pikëpyetje se sa serioz dhe i besueshëm do të jetë pala izraelite si partner.

Amerika nuk mund të injorojë më interesat e saj në favor të një Izraeli të papajtueshëm që injoron pikëpamjet e SHBA-së në gjëra siç janë vendbanimet. Obama nuk duhet të shpenzojë kapitalin politik në bindjen e fuqive evropiane që të rrëzojnë me votë iniciativën palestineze në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Duke garantuar në mënyrë të palëkundur sigurinë e Izraelit, SHBA-ja nevojitet të lë Netanjahun të ndiejë izolimin në rritje të Izraelit në komunitetin ndërkombëtar.

Fjalimi i presidentit Obama i 19 majit bëri një fillim të mirë në rindërtimin e politikës së SHBA-së drejt Lindjes së Mesme dhe përmirësimin e marrëdhënieve SHBA – Botë Islame. Megjithatë, që nga Kajro e deri më sot, shumica po presin politika dhe vendime të trasha dhe veprime që kthejnë retorikën e administratës në realitet. ■

*Revista 'Paqja' ka leje për t'i botuar shkrimet e prof. Esposito, pasi ka arritur marrëveshje të drejtpërdrejtë me profesorin.*

**Përktheu: Osman D. GASHI**

# Mes jetës dhe të vërtetës

**Adelina AVDULLAHU**

**T**ë synosh të vërtetën nuk është gjë e lehtë, meqë në rrugë të dalin shumë sfida, por megjithatë ai që ka përgatitje profesionale dhe guxim qytetar u del ballë të gjitha pengesave që i dalin. E të synosh të vërtetën në një vend siç është Rusia, ato të vërteta mund t'i paguash me jetë, pasi që Rusia konsiderohet si vendi i tretë i rrezikshëm për ata që pretendojnë të ushtrorjnë profesionin e gazetarisë. Vetëm nga viti 2000e deri më sot, në Rusi kanë humbur jetën 16 gazetarë, ndërkohë që vetëm një fajtor është gjetur dhe dënuar. Një gazetarë ruse, që bën pjesë në këtë listë, është edhe Anna Politkovskaia. Ajo ka punuar për gazetën "Novaya Gazeta" dhe njëkohësisht njihet si një ndër gazetarët e rralla që e ka informuar publikun në mënyrë profesionale për luftën e fundit në Çeçeni. Politkovskaia njihet edhe për qëndrimin e saj kritik ndaj politikës së kryeministrit rus, Vladimir Putin dhe kishte denoncuar shkeljen e të drejtave të njeriut në Çeçeni.

Libri i saj "Çeçenia: Turpi i Rosisë" flet shumë qartë për mizoritë ekstreme që janë bërë në Çeçeni nga politika e vrazhdë e Putinit. Në shtator të vitit 1999 kishte shpërthyer lufta e dytë në Çeçeni. Populli çeçen ndihej i përjashtuar, sepse një i huaj sipas tyre, i ka të gjitha drejtat, ndërsa ata si vendas nuk i gëzonin ato. Gjatë kësaj lufte, vetëm një komandant ishte denoncuar për përdhunim, por kjo kishte ndodhur vetëm se ai e kishte mbytur të njëjtën vajzë. Kjo ka ndodhur ngase në Çeçeni vajzat që përdhunohen nuk kanë të ardhme dhe nëse ndodhia do të kishte vijuar rrjedhën juridike, vajzat çeçene do të vriteshin nga burrat e familjeve të tyre.

Politkovskaia ishte shumë e përkushtuar ta publikonte të vërtetën, ani pse jeta e saj vihej shpeshherë në rrezik. Ajo shkonte nëpër fshatra gjatë natës, rrëshqiste si një dhelprë në shtëpinë ku e prisnin, fliste me banorët, flinte dhe ikte herët në mëngjes që të mos vërehet. Politkovskaia ndihej si një kafshë e ndjekur nga gjahtarët, vetëm se ajo raportonte mbi të vërtetat që ndodhnin në Çeçeni dhe habitej për faktin se si kjo politikë mbështetej nga ShBA-të dhe Ev-

ropa. Politkovskaia ishte rrahur nga ushtarët në fillim të luftës, me rastin e një arrestimi dhe në përpjekjen për të hedhur dritë mbi rrethanat e vrasjes të një banori nga Grozni (Grozni, kryeqyteti i Çeçenisë).

Atij që mund t'i vihet një theks i veçantë është letërkëmbimi i Politkovskaias me një grup ushtarësh, pjesëmarrës në operacionin antiterrorizëm në Republikën Çeçene. Kjo ishte letra e njëqind që Politkovskaia e kishte marrë dhe zakonisht ajo vetëm i lexonte ato, por kësaj here kishte vendosur t'i kundërgumentonte shpifjet që ishin bërë nga ushtarët ndaj saj. "Sa i përket shpifjeve tuaja për "gropa" dhe zidan, të na falni, por ato kanë më shumë pamjen e një hakmarrje femërore: ju hakmerreni për burrat, që kanë penguar suksesin tuaj mediatic. Ju keni rënë shumë poshtë Politkovskaia" - thuhet në letrën e ushtarëve drejtuar Politkovskaias, duke shtuar se ata haptas e kërcënonin atë për vdekje. Për ushtarët dhe kolonelët rusë ajo konsiderohej si armike numër një në Çeçeni. Pavarësisht kësaj, ajo iu kundërpërgjigjet duke ju shkruar "Mos gënjeni! Gjatë kësaj lufte kam pasur raste të mjaftueshme për të parë sa e rrezikoni jetën ju: të shthurur dhe të korrumpuar, që çdo ditë u përkushtoheni djegieve dhe plackitjeve, duke diskutuar "dobinë e luftës" larg fushës së betejës... çfarë turpi".

Plagosja e Aishjes vetëm për një birrë, vrasja e aktivistëve, të cilët e informonin Politkovskaian për krimet që

ndodhnin, ndjenja e çëçenëve se ishin popull i përjashtuar, djegia e gjashtë trupave çeçen, vdekja e shumë të rinjve dhe shumë e shumë mizori dhe krime të tjera, janë fakte reale që ka sjellë Politkovskaia për lexuesin, ani pse për këtë libër është e ndaluar të flitet në Rusi. Meqë çeçenët janë më pak se një milion banorë, historia e tyre të ngjan në historinë e popullit tonë.

Duke cituar Politkovskaian se "vazhdojmë të mbjellim Putinën për të korrur Stalinën", ajo shprehet shumë e zhgënjyer, meqë sipas saj Putini nuk ishte i përkushtuar për paqen dhe begatinë, por për luftën e dytë çeçene, njëra ndër luftërat më mizore e reaksionare, që ka ndër marrë ndonjëherë Rusia.

"Herë- herë personat paguajnë me jetë faktin se duan të thonë me zë të lartë atë që mendojnë. Madje mund edhe të vritet vetëm e vetëm se më ka dhënë një informacion. Nuk jam e vetmja në këtë rrezik, e kam shembuj që mund ta provojnë këtë" - janë fjalët që Politkovskaia i kishte thënë gjatë një konference ndërkombëtare të "Reporters sans Frontiers", e që përkujtohet në çdo përvjetor të vdekjes së saj.

Më shtatë shtator të vitit 2004, në ashensorin e ndërtesës ku ajo banonte, është gjetur e vrarë nga pesë plumba të panjohur, me ç'rast edhe sot e kësaj dite nuk dihet autori i krimit. "Çuditërisht", ditën kur përkujtohet vdekja e Politkovskaias, kryeministri rus Vladimir Putin feston ditëlindjen e tij. ■



**Ana Politkovskaia - autore e librit "Çeçenia: turpi i Rosisë"**

# RRETHIMI I KOSTANDINOPOJËS

Në vitin 57 hixhri, marina e njësitit të tretë do ta zëvendësonte njësitin e parë, mirëpo kësaj radhe ata u goditën rëndë nga një stuhi e madhe detare. Pjesa dërmuese e flotës së njësitit të tretë u përplas në bregun e detit, në pjesën lindore të Kostandinopojës, në vendin e quajtur Banphylie. Ajo që kishte ngelur pa u shkatërruar nga stuhitë do të shkatërrohej nga i ashtuquajtimi 'lëngu grek' i sapo zbuluar nga një emigrant i krishterë sirian

## Muhamed J. KAJOLLI

**P**erandori bizantin do t'i afrohej sërish kufijve të muslimanëve për të nxjerrë eventualisht ndonjë marrëveshje të re, duke qenë se Muavija ende nuk e kishte përfunduar konfliktin me Alinë r.a., mirëpo ai do të kthehej pa ndonjë rezultat. Si duket, Muavia do të ketë pasur informacionet e duhura rreth problemeve të brendshme të tyre, prandaj e refuzoi kërcënimin e tij pa u hamundur fare. Të dhënat historike tregojnë se edhe brenda oborrit të perandorisë bizantine kishte plasur sherri që herët. Aty ziheshin dy rryma ose lëvizje të fuqishme fetare. Lëvizja monotelite me ardhjen e Martës në krye të shtetit kishte mbështetjen e perandoreshës, ndërsa lëvizja e vjetër e monofizistëve ishte ajo që akoma po qëndronte fuqishëm përballë kësaj lëvizje të re.<sup>1</sup> Kur Muavia e kërcënoi me luftë, nëse ai do ta detyronte të bashkohej me kushëririn e tij, Alinë r.a., ai pa u hamundur do të zmbropsej. Një vit më vonë, me t'u mbaruar konflikti civil, Muavija do t'i tubonte komandantët ushtarakë më të njohur të tij dhe do t'i urdhëronte që t'i rikthenin tokat e humbura gjatë konfliktit të brendshëm dhe, njëkohësisht, të mendonin se si të depërtonin sa më thellë në Azinë e Vogël.

## Rrethimi i parë i Kostandinopojës

Paralelisht me këmbësorinë, marinaret do të mobilizoheshin për të treguar aftësitë e tyre menjëherë kur do të merrnin urdhrin për lundrim në detin e hapur. Muavia nuk do t'i vononte aspak dhe marina muslimane doli nëpër Mesdhe. Kësaj radhe ajo do të ankoronte në detin Jon,<sup>2</sup> nën komandën e Busrete ibn Ebi Ertat-it, më vitin 49 h ose 669 g. ose sipas disa historianëve bizantinologë, zbarkimet e marinarëve muslimanë kishin ndodhur në vitin 670.<sup>3</sup> Këto lëvizje bënë që muslimanët t'i rimarrin sërish ishujt e humbur të Rodit, Koosit dhe kësaj radhe do të çlironin

edhe Kiosin dhe, për herë të parë, do të zbarkonin në gadishullin Cizikos që ishte fare pranë Kostandinopojës, rreth shtatëdhjetë kilometra. Kështu muslimanët, tani e tutje, përveç Mesdheut, Egeut, Jonit, do të kontrollonin edhe detin Marmara.

Ndërsa, në anën tjetër, këmbësoria gjithashtu po përparonte duke i rikthyer tokat e humbura. Ajo tanimë ishte drejtuar drejt Kostandinopojës. Ia vlen të theksojmë se në kohën kur Kostanti II-të kishte ripushtuar tokat bullgare, ka të ngjarë se më 44-45 h. ose 665 g. një trup prej pesë mijë ushtarësh sllavë të kenë ikur prej Ballkanit të sotëm dhe të kenë kaluar në anën e arabëve. Ky kontingjent ushtarësh fillimisht ishte vendosur në Sirinë veriore (Hums) për të kaluar më vonë në Libanin e sotëm.<sup>4</sup> Duke i parë sukseset e njëpasnjëshme të marinarëve, Muavia, në vitin 49 hixhri, jep urdhrin për marshim drejt Kostandinopojës. Kjo ushtri do të duhej të udhëhiqej nga djali i tij, Jezidi,<sup>5</sup> mirëpo për shkak se në këtë kohë ishte sëmurë, ushtrinë do ta komandonte Sufjan ibn Auf.

Mirëpo sa më shumë ushtria muslimane po i afrohej kryeqendrës së perandorisë, aq më shumë po haste në rezistencë. Rrethimi zgjati për disa muaj dhe ushtria filloi ta ndiente mungesën e ushqimit. Gjithsesi, edhe klima e ftohtë filloi të ndikojë në ushtrinë muslimane.<sup>6</sup> Thuhet gjithashtu se këtë vit u përhap një sëmundje ngjitëse dhe kjo ushtri do të luftonte edhe me epideminë vdekjeprurëse për të. Hëpërhë, kjo ushtri do të tërhiqej për të fushuar në një vend më të sigurt, derisa t'u vinin përforcimeve nga Damasku.

Kalifi, duke qenë se synonte me çdo kusht Kostandinopojën, nuk do të vononte aspak dhe do të dërgonte një numër të madh ushtarësh në ndihmë të Sufjan ibn Afit. Kësaj radhe, në këtë ushtri, ishin reshtur edhe sahabijtë më të mirënjohur të Medinës, si: Ibni Abasi, Ibn Omeri, Ibn Zubejri, Ebu Ejub Ensariu, Abdul Aziz Zurare el Kelbiu dhe të

tjerë. Në krye të kësaj ushtrie të madhe, që po shkonte në ndihmë të Sufjanit, do të ishte djali i Muavisë, Jezidi.<sup>7</sup> Ishte nder i madh për secilin musliman të binte shehid në Kostandinopojë, aq më tepër kur Pejgamberi s.a.v.s. kishte paralajmëruar se, së pari, do të çlirohej Kostandinopoja e pastaj Roma. Ata luteshin që kjo ushtri të ishte ajo që do ta çlironte këtë qytet, prandaj me të ishin nisur edhe djemtë e sahabëve më të afërt të Pejgamberit s.a.v.s. për të dhënë kontributin e tyre, edhe pse kishin përjetuar momente shumë të hidhura dhe të dhembshme me Muavinë.

## Rënia shehid e Ebu Ejub el Ensariut

Kur ju shkuan përforcimet, ushtria muslimane do të rimerrte forcë edhe për një sulm të ri. Në vitin 50-të ose 52-të<sup>8</sup> u dha urdhri i përgjithshëm për sulm. Pas shumë përpjekjeve dhe pas shumë humbjeve që ushtria muslimane, tani e udhëhequr nga Jezidi, mori sërish si në fushëbetejë përpara mureve, ashtu edhe në detin Marmara, Muavia i pranoi humbet dhe do të jepte urdhrin e kthimit për në Sham. Në rrugën e kthimit, vdiq Ejub el-Ensariu<sup>9</sup> i cili kishte marrë plagë të mëdha në fushëbetejë.<sup>10</sup> Para se të vdiste, ai kërkoi nga sahabët e ngushtë të tij që mundësisht ta varrosnin sa më afër murit të Kostandinopojës.

Kështu u veprua. Një numër i shokëve të tij u kthyen me trupin e pashpirt të Ejubit (All-llahu e mëshiroftë) dhe e varrosën afër murit të kryeqendrës së perandorisë bizantine. Thuhet se ushtria perandorake vetëm i kishte vëzhguar sipër mureve dhe nuk kishte dalë për të luftuar me këtë grup që po bartnin xhenazen. F. Hiti sjell një detaj tjetër interesant rreth varrit të këtij sahabiu dhe mënyrës së mos humbjes së gjurmëve të këtij varri, kur dihet se muslimanët këtë vend e kanë çliruar pas disa shekujve.

Të krishterët, si dhe shumë religjione të tjera, e kishin zakon t'i luteshin varrezave, mirëpo edhe pse Ejub el En-



sariu ishte musliman, varri i tij konsiderohej prej tyre se ishte i shenjtë. “Të krishterët grekë shkonin tek varri i tij dhe luteshin për rënie të shiut në ditët e thata të verës. Në kohën e rënies së këtij qyteti më 1453 nga ana e turqve, në mënyrë të jashtëzakonshme, me anë të rrezeve ndriçuese që dolën në atë vend, u gjend varri dhe në atë vend u ndërdua edhe xhamia me emrin e tij” (F. Hiti: 156)

### Rrethimi i dytë i Kostandinopojës

Kostandinopoja ishte një vend që rrethohej nga uji në tri anët e qytetit, ndërsa në pjesën tokësore ishte e rrethuar me mure shumë të larta. Nuk kishte asnjë teknologji e asaj kohe që mund të depëronte mbi muret e këtij qyteti, gjithashtu edhe anijet nuk kishin mundësi të ankoronin në qytet në gjendje lufte, për shkak të zinxhirëve të trashë të vendosur nga një breg në bregun tjetër të qytetit.

Muavija, i bindur se do ta çlironte Kostandinopojën, sërish do të thërriste për mobilizimin e ushtrisë, ndërsa kjo thirrje nënkuptonte rritjen e taksave, të cilat natyrisht i vilte nga prefekturat që e përbënin shtetin më të madh të asaj kohe. Ky mobilizim nuk nënkupton se të gjitha grumbullimet i bënte vetëm për çlirimin e Kostandinopojës. Ai ishte i

preokupuar edhe për çlirimin e tokave të tjera të njohura në historinë islame.

Për dallim nga rrethimi i parë, ai do ta zgjeronte hapësirën e vendeve, gjegjësisht ujdhesave të çliruara përreth Kostandinopojës, duke e rritur numrin e anijeve të flotës. “Në vitin 53 h.- 674g., ai do të lëshonte në det mbi 1700 anije luftarake. Prej ujdhesave të reja të çliruara përmenden Sawos, Skiros, Chio, Siwnos, Arados. Të gjitha këto ishin parapërgatitje për rrethimin e dytë të Kostandinopojës.” (el-Aseli: 1/202-203)

Kësaj radhe, shumë nga ujdhesat u banuan nga familjet e muslimanëve. Këta ngritën shtëpi dhe i mbollën arat. Kësaj radhe dukej se ushtria mualimane do të qëndronte për një kohë të gjatë, ndërsa kjo nënkuptonte se atyre ju duhej ndihma permanente logjistike dhe ushqimi. Tani hapësira e patrullimeve në det e ushtrisë muslimane ishte zgjeruar dukshëm, ndërsa kjo erdhi si rezultat i çlirimit të ujdhesave të panumërta. Kostandinopojës thaujse ndihmat nga deti i ishin ndërprerë përfundimisht. Çdo ditë e më shumë këtij qyteti po i ngushtohej rrethi.

Muavia do të informohej për çdo detaj. Ai ishte shumë i vendosur për çlirimin e kryeqytetit nga despotizmi i shfaqur brenda këtyre mureve. Për këtë arsye, ai vazhdimisht dhe pa ndërprerje

do t’iu dërgonte edhe mjetet shtesë që u nevojiteshin ushtarëve. Zinxhiri i logjistikës nga qendra po vepronte në mënyrë shumë precize, falë edhe ndihmës ushqimore që ju shkonte nga ujdhesat. Kur bizantinët e panë forcën e re të muslimanëve, lidhën aleancë me bullgarët, të cilët do të ngarkoheshin për furnizimin me ushqim të kryeqytetit perandorak si dhe me armatim, e nëse do të ishte nevoja edhe me ushtarë.

Muavia, për komandant të përgjithshëm të kësaj ushtrie që do ta kishte fatin ta rirrethonte Kostandinopojën, emëroi sahabiun medinas shumë të nderuar Fadale ibn Ubejd el Ensarij (53-57 h.). Ndërsa ndihmësit e tij të tjerë që komandonin ishin:

Admiral i flotës ishte Abdullah bin Kajs el Harithij – sahabij

Ndihmës admiral ishte Xhenade ibn Ebi Umeje (53-60)

Komandant i ushtrisë bregdetare Zejd ibn Shexhere el Rahavij etj.

Kur erdhi koha e sulmit të përgjithshëm, admiral i marinës Abdullah ibn Kajs e ndau flotën në tri njësi. Secili njësi do të zëvendësonte njësitin tjetër në kohën e caktuar, thënë ndryshe, sipas plan programit dhe strategjisë së ndërmarrë në shtabin qendror:

Njësi i parë kishte për detyrë të qëndronte me anijet e veta shumë afër

qytetit të Kostandinopojës, ndërsa njësitit i dytë do të qëndronte në gjendje gatishmërie për ndihmë emergjente të njësitit të parë, i cili ishte ankoruar në hyrje të detit Marmara, në fund të ngushticës së Dardaneleve. Ndërsa njësitit i tretë ishte pozicionuar shumë larg ankorimit të dy njësiteve të para. Ky njësit ishte në perëndim të detit Egje. Shikuar nga afër, ky njësit thuhet nuk ishte fare në betejë. Mirëpo detyra e tyre ishte të furnizonte në mënyrë permanente njësitin e dytë me logjistikë. (Aseli: 1/203)

Rrethimi zgjati për disa vite (thuhet katër vjet të plota). Kësaj radhe sulmet nuk ndërpriteshin me ndryshimin e stinës. Ushtria po qëndronte si në verë, ashtu edhe në dimër, mirëpo në asnjë mënyrë nuk po mund të gjente formën ose pozicionin e duhur të depërtonte brenda qytetit. Në vitin 57h.<sup>11</sup> marina e njësitit të tretë do ta zëvendësonte njësitin e parë, mirëpo kësaj radhe u goditën rëndë nga një stuhi e madhe detare. Pjesa dërmuese e flotës së njësitit të tretë u përplas në bregun e detit, në pjesën lindore të Kostandinopojës, në vendin e quajtur Banphylie.

Ajo që kishte ngelur pa u shkatërruar nga stuhitë do të shkatërrohej nga i ashtuquajturit 'lëngu grek' i sapo zbuluar nga një emigrant i krishterë sirian. "Por fortifikimet detare, përgjatë detit Marmara dhe Bririt të Artë, u bënë ballë sulmeve të tyre. Bizantinët kishin në dorë një armë të fshehtë, zjarrin grek, një përzierje ndezëse me bazë naftë, përbërjen e saktë të së cilës nuk e njohim". (Norwich: 101)

Pas kësaj ngjarjeje, marinarët muslimane sikur e panë veten se nuk kanë më forca për të qëndruar në det. Zinxhiri zëvendësues u këput dhe grupi i parë i anijeve ishte stërlodhur dhe kështu edhe këta pësuan disfatë. Muavija kur mësoi për këtë humbje të madhe u detyrua të bënte marrëveshje me perandorin bizantin, kohëzgjatja e së cilës kësaj radhe ishte tridhjetë vjet. (el-Aseli: 1/203) Ndërsa bizantinologu tjetër, këtë marrëveshje e përshkruan kështu: "Kalifi plak Muavia u detyrua të nënshkruajë një traktat paqeje tridhjetëvjeçare<sup>12</sup> me Bizantin, me anë të të cilit angazhohej t'i paguante perandorit çdo vit një tribut prej tre mijë monedhash të arta, pesëdhjetë robër e pesëdhjetë kuaj." (Ostrogorsky:100)

## Rrethimi i tretë

Kostandinopoja, falë fortifikimit të fortë dhe përvojës perandorake, do

të shpëtonte edhe nga rrethimi i dytë i Muavisë, mirëpo muslimanët asnjëherë nuk do të hiqnin dorë nga ky qytet. Këtë e vërtetoi historia edhe pas Muavisë. Përpjekja e tretë për çlirimin e këtij qyteti gogol për muslimanët, ishte në kohën e kalifit Sulejman ibn Abdul Melik-ut (96-99h. ose 714-717g.)

Parakaluam disa ngjarje të tjera historike për të kaluar në rrethimin e tretë të Kostandinopojës, me qëllim që të përfundojmë me ngjarjet e rrethimit të këtij qyteti, sepse muslimanët nuk do t'ia mësynin më çlirimit të këtij qyteti për disa shekuj me radhë. Pra, deri në kohën e sulltan Mehmet<sup>13</sup>(Muhamed) Fatihut në vitin 1453-të, i cili e çliroi përfundimisht këtë qytet.

Ky kalif, edhe pse qëndroi shumë pak në pushtet, si duket i motivuar nga emri i tij i një pejgamberi, do t'ia mësynte çlirimit të Kostandinopojës. Me t'u emëruar kalif, do të fillonte përgatitjet si në aspektin politik, ekonomik ashtu edhe atë ushtarak. Ai më vitin (97h.-715) pasi kishte grumbulluar, sipas tij, numrin e mjaftueshëm për çlirimin e Kostandinopojës, rreth 120 mijë luftëtarëve, do të caktonte komandantët si vijon më poshtë:

Vëllanë e tij, Muselemen, në krye të ushtrisë tokësore dhe detare,

Djalin e tij, Davudin, zëvendësin e tij në tokë,

Amër ibn Hubejrete el Fezarij admiral flote për Shamin, Egjiptin dhe Afrikën Veriore,

Hadhij ibn Kethir el Xhedhamij, komandat marine të Shamit, me qendër në Akka.

Mugire ibn Ebi Berede el Abderij, komandant marine të Afrikës Veriore,

Sherih ibn Mejmun el Mehrij, komandant marine të Egjiptit.

Ebu Ubejd ibn Ukbe, komandant marine i cili nën komandën e banorëve të Medinës.

Të gjithë këta komandantë të marinës do të kishin në dispozicion një mijë (1000) anije të mëdha të shoqëruara me shumë të tjera të vogla për bartjen e ushtarëve dhe logjistikës. Ky grumbull i madh anijesh kishte mundësi të bartte 80 mijë luftëtarë. Anijet e mëdha ishin pajisur me armatimin e duhur për të sulmuar

qytetin, si dhe kishin marrë masat mbrojtëse nga i ashtuquajturit zjarri grek. Kur mbaroi mobilizimi, vendgrumbullimi i anijeve kësaj radhe u bë në Tripoli të Libisë së sotme. Kalifi Sulejman më 98h. dha urdhrin e përgjithshëm për të sulmuar Kostandinopojën, ndërsa zbarkimi i parë i flotës mualimane ishte Sicilia, të cilën e çliroan pa ndonjë rezistencë të madhe.

Në anën tjetër, ushtria tokësore kishte marrë gjithashtu rrugëtimin për në kryeqendrën e bizantinëve. Për dallim nga herët e tjera, kjo ushtri ishte ngarkuar me farëra të ndryshme të drithërave, të cilat do t'i mbillnin me të arritur në afërsi të Kostandinopojës.

Kjo përgatitje e madhe e ushtrisë së Sulejmanit, i sinjalizoi bizantinët se nuk do ta kishin të lehtë kësaj radhe. Mirëpo përvoja e bëri të veten. Marinarët, me të zbarkuan në brigjet e Kostandinopojës veriore, do të befashoheshin nga ushtarët bullgarë. Teodori i III- lidhur ale-bullgarët sulmonin m u s - ancë q ë m a r i - n a r ë t l i -



manë. Marinarët, në fund, dolën fitues për kjo betejë ju shkaktoi dëmtime shumë të mëdha, saqë muslimanët do të hamendeshin të vazhdonin me rrethimin apo jo.

Në këtë kohë jo stabile të ushtrisë muslimane, vdiq perandori bizantin, ndërsa komandant i ushtrisë bizantine ishte Leoni i III-të. Për t'u bërë perandor, ai u zotua se do të triumfonte kundër muslimanëve, por fatkeqësisht edhe ky nuk ia doli. Pasi i humbi shpresat, ai do të përdorte një hile që është shënuar në librat e historisë së arabëve. Ai, në një farë mënyre, i sinjalizoi arabët se do t'ua dorëzonte qytetin me disa kushte të cilat do të merreshin vesh.

Për këtë lloj marrëveshje, Museleme e dërgoi Amër ibn Hubejrete el Fezarijin. Leoni III-të e shëtiti Amrin nëpër qytet, ndërsa ai mësoi se populli bizantin kishte shumë pak rezerva ushqimore. Leoni e bindi Amrin se populli do t'ia dorëzonte qytetin dhe nuk do të bënte rezistencë sikur t'i jepnin ushqim. Amri duke qenë se ishte kundër gjakderdhjes së mëtutjeshme e pranoi propozimin e Leonit dhe ia parashtroi Muselmës këtë propozim, me të cilën edhe ai u pajtua.

Leoni dërgoi anijet e tij për t'u ngarkuar me ushqimin rezervë dhe pasi u bindën se e morën shumicën e rezervave të ushqimit, ditën e nesërme Leoni mbylli portat dhe iu kërcënua me luftë. Dimri po afrohej, ndërsa arabët do të ngelnin pa ushqim të mjaftueshëm për të vazhduar rrethimin. Ushtria muslimane do të qëndronte edhe për disa muaj me radhë përreth mureve të Kostandinopojës, me ato pak rezerva që i kishin mbetur.

Gjatë periudhës dimërore të vitit 99 h. vdiq edhe Kalifi i muslimanëve, Sulejmani. Në vend të tij erdhi Omer ibn Abdul Azizi, i cili mendonte të vazhdonte rrethimin deri sa Kostandinopoja të çlirohej përfundimisht. Mirëpo, pas shumë debatesh dhe konsultimesh me këshilltarët e tij, ai do të jepte urdhër që ushtria të tërhiqej. Për

tërheqje, Kalifi do të dërgonte pesëqind kalorës të cilët do të siguronin rrugëtimin e mjeteve të transportit për kthimin e ushtrisë muslimane. Përfundimisht, rrethimi i tretë i Kostandinopojës do të merrte fund në gusht të vitit 99h.=717g. (el-Aseli:1/206-208) ■

1 Kostanti II-të, më 647, ishte 18 vjeç dhe nuk ishte i aftë të përzihej në debatet teologjike, mirëpo kur papa Teodori i I-rë e shkishëroi patriarkun e Kostandinopojës, ai do të detyrohej të nxirrte një urdhër që të ndërpriteshin të gjitha polemikat fetare. Ai zyrtar fetar i cili do të vepronte kundër vendimit të perandorit do të shkarkohej nga puna, kurse qytetarët e thjeshtë sanksionoheshin me kamxhik ose me para. Papa Teodori I-rë vdiq më 649, në vend të tij erdhi Martini I-rë i cili i vuri sanksione monoteistëve.

Si duket, qysh nga Koncili i Kalcedonisë, problemet e perandorisë sa vinin e shtoheshin. Kështu vazhdoi deri më 681 kur në perandori u organizua Koncili i Gjashtë Ekumenik. Kundërshtitë monotelite "Acarimi i luftës së monofizitëve sirianë dhe egjiptianë kundër Bizantit kishte lehtësuar pushtimin e provincave lindore nga ana e arabëve". (Otrogorsky:94) Gjithashtu "Afrika veriore ishte në atë kohë djepi i ortodoksisë në luftën kundër monoteizmit dhe si problem shumë i madh brenda oborrit ishin edhe intrigat e Martës (gruaja e dytë e Herakliut, njëkohësisht ishte edhe mbesa e tij).

2 Kisha lexuar në shumë vende të kundërshtonin se ballkanasit nuk kishin dëgjuar për Islamin më herët se me zbarkimin e osmanëve në brigjet e Egjeut. Kjo si duket po rezultoi të jetë gabim, sepse, sikurse bizantinologu Ostrogorsky ashtu edhe Norwich theksojnë se ushtria muslimane kishte zbarkuar në detin Jon në këtë periudhë kohore, ndërsa ky vend historikisht ishte i banuar me shqiptarë. Gjithashtu, burimet tona islame përkujtojnë gjenocidin bullgar kundër saraçenëve (muslimanëve) kur këta kishin pushuar tokat tona në shekullin e IX-të. Mendohet të janë masakruar mbi njëzet mijë muslimanë. Kush ishin këta, shpresoj të mësojmë më vonë dhe sigurisht do të arrijmë të argumentojmë prezencën e muslimanëve të huaj dhe shqiptarë të shekullit VIII-të, inshallah.

3 Nëse i referohemi historianëve arabë dhe Filip Hiti, arabët për herë të parë i kishin rrethuar muret e Kostandinopojës në vitin 49 h ose më 669 gregorian. Ndërsa Ostrogorsky dhe Norwich mendojnë se marina arabe për herë të parë ka zbarkuar në gadishullin e Cizikut më 670-të. Të dhënat historike islame tregojnë se Ejub el Ensariu është varrosur pranë mureve të Kostandinopojës në vitin 49 hixhri. Allahu e di më së miri.

4 Si duket, prej kësaj kohe e deri më sot, të krishterët e Libanit janë pajtuar të jetojnë me muslimanët. Mirëpo herë pas herë ky grupim do shfrytëzohet nga shtetet e perëndimit përgjatë historisë për të destabilizuar rajonin. Vetë fakti se këta krishterë akoma jetojnë në këtë vend tregon se muslimanët asnjëherë nuk kanë ushtruar gjenocid ndaj civilëve.

5 Në këtë kohë Muavia kishte marrë pëlqimin e disa prefektëve që trashëgimtar i fronit pas tij të bëhej djali i tij, Jezidi, sepse në këtë kohë ishte helmuar për vdekje Hasani, i biri i Alisë, i cili do të duhej ta merrte fronin e Kalifit të

myslimanëve pas Muavisë (për këtë ngjarje do të flasim më poshtë). Thuhet se kjo ishte arsyeja pse Muavia duhej ta dërgonte djalin të komandonte në këtë ushtri të madhe dhe me rëndësi të veçantë. Ai do të duhet të tregohej se është i aftë të udhëhiqte një ushtri dhe njëkohësisht ai kishte nevojë për përvojë ushtarake dhe politike.

6 Zakonisht, ushtria muslimane ishte e përgatitur për të sulmuar vetëm në periudhën verore. Disa vite më vonë muslimanët do të formonin edhe ushtrinë dimërore.

7 Shumë historianë arabë thonë se me t'u bashkuar Jezidi me ushtrinë e Sufjanit, ai ia mori komandën.

8 Historianët nuk janë të një fjale rreth vitit të rënies së këtij sahabiu të nderuar. Shumica dërmuese kanë debatuar për vitet 49 ose 50 h., mirëpo kemi hasur në literaturë tjetër (po ashtu arabe, si el Xhuzij), të cilët mendojnë se ai ka rënë shehid në vitin 52 h. All-llahu e di më së miri. Duke qenë se kemi të bëjmë me një ngjarje afër 1400 vjet më parë, për ne tani nuk është edhe aq me rëndësi viti i vdekjes se sa vetë ngjarja.

9 Pjesëtar i betejës së Bedrit, Uhudit dhe i të gjitha betejave në të cilën kishte marrë pjesë Pejgamberi s.a.v.s. Shokët e tij do ta nderonin këtë shehid për hir të lutjeve që ua kishte bërë që ta varrosnin pranë murit mbrojtës të pamposhtur në atë kohë të Kostandinopojës. Historianët nuk na tregojnë saktësisht se në cilin vend vdiq dhe sa larg ishte qyteti i Kostandinopojës prej tij. Disa prej tyre, të bazuar në të dhënat gojore, thonë se edhe gjatë varrimit ka pasur viktima, mirëpo shumica prej tyre e mohojnë një gjë të tillë.

10 Hiti mendon se shkak i vdekjes së këtij sahabiu ka qenë sëmundja e dizenterisë.

11 Shumica dërmuese e historianëve arabë dhe bizantinë mendojnë se kjo ngjarje ka ndodhur në vitin 59h (pak kohë para se Muavia të ndërronte jetë).

12 Shumica e dijetarëve dhe historianëve arabë nuk kanë treguar detajet mbi këtë marrëveshje, gjithashtu as edhe ata bizantinë. Mirëpo, ajo që më bëri mua përshtypje ishte koha e marrëveshjes dhe mu për këtë arsye u detyrova të hulumtoj më gjatë nëpër libra të historisë dhe libra të tjerë, për të vërtetuar se a ka mundur të ndodhë një marrëveshje kaq e gjatë midis dy palëve në konflikt. Prej literaturës së shfrytëzuar konstatova se nuk ka pasur asnjë marrëveshje kaq të gjatë midis tyre në këtë periudhë kohore. Muslimanët, si në këtë kohë edhe për shumë shekuj me radhë, kanë vepruar sipas parimeve të marrëveshjes ose Traktatit të Hudejbijes. Muhammedi s.a.v.s. derisa kishte qenë gjallë kishte bërë marrëveshje dhjetëvjeçare me politeistët e Mekës. Kështu, të gjithë kalifët, nuk kanë pranuar të bëjnë marrëveshje me një shtet tjetër kohëzgjatja e së cilës do të mund të kishte qenë më shumë se dhjetë vjet.

13 Dikush mund të pyesë: emri i çlirimtarit (Mehmet) nuk paska qenë emri i një pejgamberi (siç ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.). Këtyre ju themi se turqit fëmijët e tyre nuk i thërrisnin me emrin Muhamed për arsye të njollosjes së emrit të Pejgamberit s.a.v.s. Për këtë shkak, emri Muhammed ishte zëvendësuar me emrin Mehmet që nënkuptonte Muhammed. Nëse Mehmeti tek turqit thirrej Mehmet, po i njëjti njeri tek arabët thirrej Muhammed. Kur unë egjiptianëve ju tregoja ndonjë ngjarje të shqiptarit Mehmet Ali Pashën, ata më thoshin e ke fjalën për Muhammed Ali Pashën, mbretin e Egjiptit.



# FENOMENI I DIHATJES SË QENIT

**Prim.dr.med.sc. Ali F. ILJAZI**

**A**llahu i Madhërishëm në Kuranin fisnik urdhëron e thotë:

**“Dhe lexoju atyre tregimin e atij që i patëm dhënë dituritë Tona, ndërsa ai u zhvesh prej tyre dhe atëherë atë e shoqëroi shejtani dhe kështu ai u bë prej të humburve. E sikur të donim Ne, do ta ngrinim lart me atë (dituri), por ai nuk iu largua tokës (dynjasë) dhe shkoi pas epshit të vet. Shembulli i tij është si ai i qenit, të cilin nëse e përzë ai e nxjerr gjuhën, por po edhe nëse nuk e përzë ai sërish e nxjerr gjuhën. Ky është shembulli i atyre që i konsideruan të rreme argumentet Tona. Ti rrëfe tregimet (ymetit tënd) në mënyrë që ata të mendojnë.”<sup>1</sup>**

Verseti i cituar, sipas komentuesve klasikë, flet për një njeri tejet të ditur nga populli i Musait, a.s. i cili në një moment të dinamikës së jetës dhe epshëve të ndryshme vendosi për interesa të ngushta dhe kaluese, gjegjësisht u për-

poq që me diturinë e tij të materializojë dhe të maksimizojë kënaqësitë e tij epshore, duke harruar që dituria e arritur obligon dhe zgjeron përgjegjësinë e gjerë shoqërore. Shembulli i përmendur është universal sepse në çdo vend dhe kohë ekzistojnë njerëz që arrijnë në pronësi të informatave të besueshme dhe të rëndësishme në bazë të të cilave mund të sjellin vendime të larta, me rëndësi mbarëshoqërore.

Mirëpo, marrja e vendimeve që i trajtojnë njerëzit nuk është edhe aq në lidhje me posedimin e cilësive të formuara të karakterit. Sepse për njohjen e rrugës nevojitet vetëm dituri, ndërsa për lëvizje në të nevojitet të kesh karakter të fortë e të formuar (p.sh. drejtësia, ndjeshmëria ndaj vuajtjeve të të paafteve, urrejtja ndaj padrejtësisë etj.)

Në kohën e çrregullimit të vlerave, intelektual është bërë secili që ka kohë të mbledhë informata të shumta në një vend, duke i përsëritur me kapacitetin intelektual të papagallit.

Gjeni sot është personi i cili ka arritur dituri përmbledhëse dhe mjeshtri që t'i materializojë nëpërmjet korporatave kapitaliste.

Politikan është personi i cili mban kravatë dhe që ka aftësi përklarëse dhe lojalitet ndaj sistemit të korruptuar, e jo ndaj vlerave të larta.

Ndërsa qytetari i mirë është ai i cili përpin pa shije tërë atë që tre të përmendurit i servirin, etj.

Zoti i botëve, në versetin e cituar në fillim, njeriun i cili mohon të vërtetën dhe virtytin duke pasur qasje në informacione, në krahasim me njeriun e rëndomtë nga masa, e krahason me qenin. Dhe në këtë krahasim thekson një cilësi të qenit e kjo është dihatja (vibracionet) e gjuhës së tij. Dridhjet janë nxjerrja e gjuhës në mënyrë ritmike, zakonisht për shkak të lodhjes, nxehtësisë, etjes, e të gjitha këto me qëllim të vendosjes së ritmit normal të frymëmarrjes.

Është interesant që qeni temperaturën e tij e rregullon nëpërmes sistemit respirator d.m.th. me avullimin e nxehtësisë nga gjuha, e cila i ekspozohet ajrit të ftohtë. Shkencëtarët pohojnë që qentë djersiten vetëm nëpërmes gjëndrave djersore të vendosura në këmbë, duke lënë gjurmë të lagështa.

Është interesant që qeni dihat, për ndryshim nga kafshët e tjera, gjithmonë dhe në çdo pozitë: qoftë ulur, kur ecën, vrapon, kur është i uritur, i etur, etj. Ibn el Kajjim në veprën e tij “*El-Emthal fil Kur’ani el- Kerimi*”, në shqyrtimin e versetit që përmendëm në fillim, thekson në mënyrë të hollësishme disa karakteristika të qenit, duke demonstruar në themel fjalët kuranore, p.sh. mosdurimi i qenit kur është në pyetje etja, dihatja si shprehje e lakmisë së pangopur, serviliteti nga jashtë, tërbimi ndaj personave të panjohur, preferenca e mbeturinave të ndotura mbi ushqimin e pastër, koprancia për ta ndarë gjahun e ngordhur me qentë e tjerë, robërimi ndaj seksit personal me lëvizje lutëse, orientimi i përhershëm ndaj tërë asaj që është e ndotur, duke nuhatur patjetër papanicën etj.

Nga interesimi gjithmonë nuhat tokën duke lëruar në çdo gjë, nga fecesi, cofëtinat që i copëton me epsh, deri të plehu dhe gurët të cilët i bren me lakminë e tij.



Muhammedi, a.s. ka tërhequr vërejtjen për ndryshimin e trurit të qenit dhe gjuhës nëpërmes së cilës të gjithë helmet e qenit dalin jashtë. Mirëpo, edhe gjeneratat bashkëkohore të muslimanëve kanë lënë udhëzime të qarta kur bëhet fjalë për efektet anësore, d.m.th. helmet e proceseve të ndryshme civilizuese, të cilat ofrohen në mënyrë agresive nga mediat. Qeni është i njohur për lojalitet, gjë për të cilën edhe njeriu e çmon jashtëzakonisht dhe e mban afër, edhe pse ai nuk prodhon asgjë konkretisht (duke mos llogaritur qentë special që janë të dresuar). Njeriu e mban lopën sepse ajo jep qumësht, delen sepse jep lesh dhe mish, pulat bëjnë vezë, kalin për bartje dhe kalërim, maçokun për të gjuajtur minjtë, etj. Mirëpo, qeni nuk prodhon asgjë dhe ajo që kërkohet nga ai është bindja ndaj pronarit kur e thërrret dhe cijatja e këndshme kur e lëmon dhe, këtë, natyrisht e bën instinktivisht. Lëpirja dhe paraqitja e gëzimit për shkak të prezencës së pronarit e bën jetën e qenit të këndshme.

Krahasimi kuranor i qenit dhe i njeriut, i cili edhe pse ka arritur dituri, pason epshet e tij dhe anon nga interesat e tij të ngushta në shumë pikëpamje, na bën të ndalemi dhe të trajtojmë një paralelizëm të caktuar, i cili buron nga verseti i cituar.

### Qarkullimi i pështymës në natyrë / shoqëri

Ekzistojnë njerëz të cilët edhe pse kanë dituri dhe ndërgjegje, sikurse qeni, janë robër ndaj njerëzve të tjerë nga interesi, duke blerë animin e tyre me shërbime të vogla. Të këtyllët janë të varur nga lëmimi dhe lavdërimi dhe i nënshtrohen dorës e cila i lëmon. Qeni i bindet dresimit dhe ka aftësi të konsideruar të mësimi, që e bën mjaft të dobishëm për njeriun (p.sh. ruan bagëtinë dhe shtëpinë, udhëheq të verbrit, hulumton drogën, eksplozivin, e kohëve të fundit zbulon edhe kancerin, etj.)

Mirëpo mësimi i tij është rezultat i ndikimeve pozitive dhe negative d.m.th. sjelljes së shpërblimit dhe dënimit, e jo ndërgjegjes së ndërtuar qartë dhe aftësive të vendosjes me kuptim dhe të pavarur sipas kësaj ndërgjegje.

Sistemet moderne të arsimit të nxënësve e studentëve, pikërisht këtë mënyrë e praktikojnë, duke lëshuar nëpërmes programeve të ndryshme të dresimit dhe aftësimit që është tërësisht

jokritik dhe pa qëndrim të qartë moral, që kryen detyra në kornizat e sistemeve ekzistuese, firma, organizata të cilat për këtë japin shpërblime (me të holla).

Sistemi i lartë i shkollimit të dresuar në mënyrë precize sterilizon aparativ kognitiv të njerëzve të rinj me anë të transferit mekanik të diturisë dhe profesioneve, duke zëvendësuar pavarësinë potenciale (mendimin kritik në kokat e tyre të mësuara me reaksionet stereotipe, të cilat na zbulojnë mentalitetin robërues të tyre, d.m.th. kokat që janë vetëm banka (sefa) të ideve të lejuara që më parë. Edhe ky është vend ku duhen kërkuar shkaqet e konformizmit intelektual i cili transformon potencialet shumë të mëdha në sisteme mizere pseudoshkencore.

Jetojmë në kohën në të cilën sa më e vogël që është vetëdija njerëzore aq më i madh bëhet lojaliteti ndaj padronit.

Qeni nuk ka aftësi të mendimit kritik dhe nuk është në gjendje të vlerësojë karakterin njerëzor, duke marrë qëndrim të qartë ndaj njerëzve me profil dhe koncept të ndryshëm. Qeni i nënshtrohet plotësisht pronarit të tij, duke marrë traditat dhe veset e tij, bile me besnikëri imiton disponimin dhe karakterin e tij. Nëse pronari i qenit është i disponuar armiqësisht ndaj ndonjë njeriu mjafton që këtë ta shprehë me shikim p.sh. dhe

qeni do të marrë pozë armiqësore ndaj këtij njeriu, edhe pse nuk e di as vetë përse e urren.

Kjo aftësi e qenit, e adoptimit të shpejtë në kodeksin moral të pronarit, pa marrë parasysh kush është ky pronar, e bën qenin të jetë qen d.m.th. kafshë tejet fleksibile morale me shqisa të mprehta vetëm për nevoja të veta ekzistenciale. Mirëpo është shqetësuese dhe problematike kur njeriu ose tërë populli sillet sikur qeni ndaj pronarëve të tyre, të cilët momentalisht janë dominant në pikëpamje ekonomike dhe politike, duke adoptuar në tërësi kodeksin moral personal dhe qëndrimet sikur të tyre.

Ky qëndrim poltronik pa asnjë thërrmi kritike ushqen krim dhe krijon kultin e individit të letrës, si dhe imperatoritë e fryra artificialisht, të cilët rriten në iluzione të nxitura me cijatje të këndshme dhe lëvizje të bishtit ndaj poltronëve.

Shkaqet e mallkimit të faraonit, si përfaqësues më eklatant i krimit dhe pushtetit të padrejtë, qëndron në lojalitetin e qenit, të bashkëpunëtorëve më të ngushtë të tij, të cilët me konstruktive gjuhësore ushqenin iluzionet e tij:

**“Të parët nga populli i faraonit thanë: ‘A do të lejosh Musain dhe popullin e tij të bëjnë përçarje në tokë dhe të braktisin ty dhe zotat e tu...’”<sup>42</sup>**

Në versetin e cituar qartë theksohet





poltroniteti i dijetarëve dhe njerëzve me famë në sytë e popullit. Ata silleshin sikur qeni, nga se të folurit e tyre ishte sikurse dihatja e qenit lakmues i nxitur nga nevojat personale.

Edhe ky verset, natyrisht është universal, sepse secili vend dhe në çdo kohë i ka udhëheqësit dhe popullin e thjeshtë. Dhe shumë shpesh dikush në sytë e popullit të rëndomtë mund të jetë i ditur dhe i madh, ndërsa në sytë e Allahut të Madhërishëm qen i thjeshtë me ambiciet po të qenit të thjeshtë. Mu për këtë, personi i cili ka dije të caktuar para se të hapë gojën duhet të dijë përse e bën këtë, çfarë dëshiron të arrijë me fjalën e tij dhe a thua të folurit e tij anon nga epshet e ulëta apo nga nevojat sublimë.

Vetëm shoqëritë që kanë masën e shëndoshë kritike të aftë për t'i ftuar udhëheqësit e tyre në përgjegjësi dhe për t'i ballafaquar qartë me parregullsitë e tyre nëpërmes mekanizmave të ndryshme të drejtësisë, pavarësisht nga ideologjia religjioze e civilizuese, meritojnë drejtësi dhe bekim.

Koncepti edukues, i cili nuk ka ushtrimin praktik të gjeneratave të reja për kundërvënien të argumentuar të autoriteteve të ndryshme d.m.th. nëse nuk e potencon trimërinë verbale dhe sinqeritetin si vlerë - prodhon grumbull ankues, lëpirës dhe gënjeshtar.

Mu për këtë fenomen kemi edhe pötencimi i Pejgamberit, s.a.v.s.:

*"Xhiahadi më i mirë është fjala e folur përpara sundimtarit tiran."*

Mallkimi i pushtetmbajtësve (funktionarëve në shtetet islame, si dhe mallkimi i liderëve bashkëkohorë politikë) qëndron në bashkëpunëtorët e ngushtë

të tyre me lojalitet qeni, ndërsa ata kënaqen me një asht të hedhur dhe mundësinë që të dihatin në afërsinë e sundimtarit. Nëse vërejmë mediat (në kuptimin e gjerë të fjalës) do të shohim dihatjen e tyre d.m.th. të folurit, të boshatisur pa asnjë ide origjinale ose koncept me të cilin arrijnë mirësi kolektive ose mënjanojnë dëmin kolektiv. Të folurit e tyre nuk është rezultat i vetëdijes së lartë shoqërore, por rezultat direkt i nevojës fiziologjike më të ulët, i motivuar me lakmi dhe interes të ulët personal (p.sh. nga nevojat materiale dhe psikologjike: nevojat për famë, ndjenjën ekzistenciale, narcizoide dhe zbrazjet më banale emocionale, etj). Të vetëdijshëm për mungesën e ideve të tyre, ata e dinë që aduti i vetëm është lojaliteti ndaj zotërinjve të vet, e që këtë e shprehin me forma të ndryshme të dresurës, duke përsëritur logot demagogjike në të gjitha situatat.

Për këtë Pejgamberi, s.a.v.s. thekson që xhiahadi më i mirë është përpjekja aktive në rrugën e sistemit të drejtë të një shoqërie nëpërmes paraqitjes publike të mendimit kolektiv, i cili trajton më përgjegjësit për padrejtësitë në shoqëri.

### Konkludim

Tërë ajo shoqëri ku nuk mund të gjenden individë trima dhe të përgjegjshëm, të cilët do të shfrytëzonin mekanizmat adekuatë për t'i thirrur në përgjegjësi funksionarët e vet, do të dënohet mu nga këta funksionarë. Mentaliteti i faraonit rritet në terrenin e frytshëm.

Malkomi duke komentuar mospasimin e pushtetit ekzekutues dhe ligvënës të vendit dhe kohës së tij, vërejtje që edhe ujqit politikë dhe dhelprat politike i takojnë familjes së qenit. Dhe ai jetën e tij e ndërtoi në mbështjellësit atmosferikë të shoqërisë amerikane, duke ndikuar në reduktimin e elementëve rrotullues të segregacionit dhe racizmit.

Sa më herët që njerëzit ta kuptojnë adhurimin ndaj Krijuesit të Plotfuqishëm, aq më shpejt do të largohen nga procesi i robërimit ndaj njerëzve (epsheve, kultit të njerëzve dhe karakterit të qenit), duke ndërtuar një shoqëri aktive, djemtë dhe vajzat e të cilëve do të jenë të mëdhenj e të ditur në sytë e Allahut të Madhërishëm, në sytë e Pejgamberit s.a.v.s. dhe në sytë e besimtarëve të tjerë. ■

1 El Aërafë 175-176

2 El Aërafë, 127

# Sëmundje

Mr. ph. Gzonit SALIHAI

**S**ëmundjet ngjitëse të sistemit tretës janë kozmopolite dhe ndër më të shumtat në numër. Për shkak të karakteristikave epidemiologjike specifike, ky grup i sëmundjeve është mjaft kompleks si nga pasqyra klinike, epidemiologjia, masat luftuese, ashtu edhe nga pasojat shëndetësore, ekonomike dhe sociale.

Ky grup i sëmundjeve është i pranishëm kryesisht në vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim, vende këto të cilat nuk e kanë të zgjidhur problemin e furnizimit me ujë të pijshëm, e kontrollit të kualitetit të ushqimit, e eliminimit jo higjienik të mbeturinave, e numrit të madh të insekteve etj.

Disa nga karakteristikat e përbashkëta të këtij grupi sëmundjesh janë:

- ◆ Shkaktarët e sëmundjes janë të njohura (në rast se infeksioni vjen nga uji i kontaminuar, izolohen disa shkaktarë të sëmundjes në analizat laboratorike të ujit, kurse te ushqimi vetëm një shkaktar)
- ◆ Periudha e inkubacionit është e saktë (e shkurtër tek infeksionet me ushqim, kurse e gjatë tek infeksionet me ujë të kontaminuar);
- ◆ Burim infeksioni janë të sëmurët ose mikrobartësit;
- ◆ Mbesin mikrobartës për një kohë të shkurtër (akut) ose të përjetshëm (kronik);
- ◆ Barten me ujë dhe ushqim të kontaminuar;
- ◆ Portë hyrëse e infeksionit çdo herë është mukoza e traktit tretës;
- ◆ Imuniteti është tip specifik
- ◆ Mekanizmi i infeksionit është fekaloral;
- ◆ Shkalla e sëmundjeshmërisë dhe vdekshmërisë është e lartë;
- ◆ Epidemitë janë të shpeshta dhe të natyrës së ndryshme;

Masat parandaluese

Pastrimi i qumështit Zierja ose pjekja e mirë e mishit

Dezinfektimi i ujit për pije dhe pishinave.

Fëmijët duhen mbajtur larg nga ambientet e kontaminuara nga feçet e deleve dhe gjedhëve

# Infektimet ngjitëse të sistemit tretës

- Epidemitë mund të parandalohen
- Për shumë sëmundje të këtij grupi, hospitalizimi është i obliguar
- Në shumicën e rasteve, mjekimi është i plotë dhe pa pasoja.

## Diarreja Akute-Escheria Coli (E.Coli)

Diarreja akute është simptomë e infeksionit të shkaktuar nga agjentë të ndryshëm: bakterialë, viralë dhe parazitare. Diarreja shoqërohet me shenja dhe simptoma të tjera si: vjellje, ethe, dehidrim, çrregullim të elektroliteve. etj.

Diarreja është e ndarë në gjashtë grupe:

1. Diarreja ujore (e thjeshtë) e cila trajtohet lehtë me tretje rehidruse (per os). Etiologjia e sëmundjes nuk është e rëndësishme për të mjekuar sëmundjen.
2. Diarreja më gjak e cila shkaktohet nga mikroorganizma të ndryshëm: shigella, escheria coli dhe mikroorganizma të tjerë;
3. Diarreja e cila zgjat më së paku 14 ditë;
4. Diarreja e llojit të kolerës;
5. Diarretë minimale të shoqëruara me vjellje (stafilococcus aureus, bacillus cereus, Cl. Perfringens);
6. Koliti hemorragjik.

## E.Coli

Është sëmundje karakteristike e moshave të reja. Nëse shfaqet te fëmijët e vegjël, sëmundja është tejet e rrezikshme dhe shkalla e vdekshmërisë është e lartë.

Deri vonë është menduar se E.Coli është banor normal i traktit tretës. Pas izolimit në feçe është arritur përfundimi se, në disa raste, ato janë përgjegjëse për enterocolit, dhe pas studimeve të shumta është parë se ekzistojnë disa tipa të E.Coli-it, prej të cilave disa shkaktojnë sëmundje, të tjerat janë pjesë përbërëse e florës normale të zorrëve.

Sëmundja është e përhapur në gjithë botën. Rastet e sëmundjes janë prezente si në shtetet e pazhvilluara, në zhvillim dhe ato të zhvilluara.

Në maj të këtij viti, kjo epidemi është shfaqur edhe në shtetet e zhvilluara në Evropë. Pas Gjermanisë, ku numri i viktimave shkoi në 14, ai rezultoi të jetë përhapur edhe në Suedi, Danimarkë, Britani, Holandë e Austri. Qendra Europiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve flet për disa të prekur në

këto vende, mes të cilëve edhe fëmijë nën 5 vjeç, ndërsa 87 për qind e rasteve të regjistruara janë të rritur, 68 për qind e tyre e të cilave femra.

Ekzistojnë katër lloje patogjene të E.coli: enteropatogjene – EPEC, enterotoksike – ETEC dhe enteroinvasive – EIEC, hemorragjike – EHEC.

Pasqyra klinike: varet nga lloji i E.Coli-it e cila shkakton sëmundjen.

Të përbashkët kanë sindromin diarreale (barkqitje, mundim, dhembje barku, vjellje dhe ndonjëherë ngritje të temperaturës)

E.Coli enteropatogjene shkaktojnë diarre ujore, pa gjak dhe mukozë. Ky lloj i diarresë është i ngjashëm me kolerën. Mund të paraqiten edhe shtangimet në bark, vjelljet dhe prostacioni. Temperatura nuk do të thotë të jetë e rritur. Mirëpo, vjen deri tek dehidrimi i pacientit. Sëmundja zgjat shkurt, 1-2 ditë.

E.Coli enteroinvazive shkakton diarre të ngjashme me shigellat, sepse edhe këto lokalizohen në zorrë të trashë. Temperatura është e rritur, dhembjet në bark janë të shpeshtuara sikur edhe tenzema dhe diarretë me përmasa gjaku dhe mukusi.

E.Coli hemorragjike EHEC rreth 80% e shtameve i përkasin stereotipit O157:H7. Ky lloj prodhon citotoksin-verotoksinë, që ka efekt citopatik ndaj qelizave “vero” të kulturave indore.


Në bazë të hulumtimeve kjo lloj bakterie E.Coli ka shkaktuar këtë gjendje, e cila pasi kalon në gjak, godet veshkat, duke provokuar komplikacione shumë të rënda: sindromën e uremisë hemolitike. Pasoja më e keqe është insuficienca renale akute që kërkon dializë.

Periudha e infektueshmërisë: korrespondon me kohëzgjatjen dhe ekretimim e shkaktarëve në ambientin e jashtëm, 1 javë te të rriturit, deri 3 javë tek fëmijët.

Rezervuar dhe burim janë: gjethet, personi i sëmurë i cili luan një rol të rëndësishëm në bartjen e sëmundjes nga njeriu te njeriu, uji dhe ushqimi i kontaminuar, sidomos ai jo mirë i përpunuar, si dhe mizat.

Mjekimi: është simptomatik. Konsiston në zëvendësimin e lëngjeve dhe elektroliteve. Përdorimi i antibiotikëve nuk është treguar mjaft i suksesshëm.

Sezoni: rastet e sëmundjes regjistrohen gjatë gjithë vitit, mirëpo më të shpeshta janë gjatë sezonit veror. ■



# Jetë studentore, me një “ëndërr” të vetme jetësore

**Valon GËRBESHI**

*(Shkrimi është shkruar në formën e “Rrëfimit në vetën e parë” pasi që protagonistin e kësaj ngjarjeje nuk dëshiron ta bëjë të ditur identitetin e tij, por ky rrëfim është rrëfim real bazuar në jetën e vërtetë të një studenti, tani më të diplomuar në Universitetin e Prishtinës.)*

**T**uhet se njeriu jeton për të jetuar ëndrrat, ndërsa shpresa për t’i jetuar ato vdes e fundit. Kështu (s) më ndodhi edhe mua. Në adoleshencën time, ëndërroja që e ardhmja të më sjellë një jetë normale... ëndërroja se si do të ishte jeta ime studentore, ëndërroja sepse kisha dëgjuar që kjo kohë të përcakton rrugët jetësore, mendoja për punën time të parë, njeriun e zemrës, e gjëra të tjera. Vitet ikën shpejt, erdhi koha për një jetë të re, kurse ëndrra e dikurshme për një jetë studentore u bë realitet. Tregimet që kisha dëgjuar, nga prindërit dhe miqtë e afërm për sfidat dhe të mirat nga një jetë studentore, tani filluan edhe tek unë të zënë vend. Më kujtohet fare mirë, dita e parë në fakultet. Isha ambicioz më shumë së kurrë ndonjë herë më parë. Pas disa ditësh vijimit të ligjëratave, mendoja se si të gjejë një punë, që të isha i pavarur financiarisht nga familja për të studiuar. Synoja të bëhesha njëri ndër bursistët e Universitetit të Prishtinës, mendoja se si do të ishte dita ime e diplomimit, sepse e dija se vitet do të iknin shumë shpejt. Por, ambiciet për të qenë një student bursist, dëshira për punën dhe ëndrra për të diplomuar, më nuk ishin si dikur. Shumë shpejt, pothuajse u tretën në një ëndërr të vetme... Ëndërrën për diplomim. Por tani, kjo ëndërr nuk ishte si dikur, mbeti e pashoqëruar nga ambicia për të qenë njëri ndër bursistët e Universitetit të Prishtinës, dëshirën për punë, dhe ëndrrat e ambiciet e tjera të shumta që kisha në fillim të jetës sime studentore. Ani pse e vetmuar kjo ëndërr më jepte pak shpresë, për të vazhduar tutje. Por shumë shpejt, gjërat ndryshuan për të keq dhe më pothuajse asgjë s’kishte kuptim si dikur. Atëherë, kur më së shumti, më duhej vullneti dhe ambicia për të vazhduar tutje, në familjen time, dëgjoj fjalosjen e babait me të vëllanë e tij, të cilin e deshi më shumë se vetën.

Mendoja se ishte vetëm një bisedë e dy të rriturve, e cila do të rezultonte shumë shpejt me një zgjidhje të pranuar nga të dy. Isha i brengosur, por së dija se shumë shpejt, kjo mosmarrëveshje, për një copë toke, do të rezultonte më vonë me një urrejtje, të cilën asnjë herë s’do mund ta besoja. Në atë kohë, si çdo student, edhe unë jetoja larg familjes me shokët e dhomës, që asnjë herë s’i kisha takuar më parë. Fatmirësisht kalonim shumë mirë. Shumë shpejt gjeta punën time të parë, por nuk kishte kuptim si dikur... Ndonëse jetoja larg familjes, krahas mallit që kisha për t’i parë, edhe përkundër faktit se kisha çdo fundjavë të lirë dhe mund ta vizitoja familjen, mundohesha që të shkoja sa më pak atje. Arsyetohesha duke ju thënë se këtë fundjavë nuk do të shihemi sepse kam për të punuar dhe për të mësuar. S’doja të shkoja që t’i shihja, sepse asgjë më s’ishte si dikur, kur nga tarraca e ballkonit shihja babin tim dhe vëllanë e tij, se si qëndronin bashkë, se si qeshnin duke kujtuar të kaluarën dhe si qanin hallet për të ardhmen. S’doja të shihja murin e vendosur, në mes të dy shtëpive i cili na ndan. S’doja t’i shihja se si kalojnë fare pranë njëri -tjetrit, pa u përshëndetur dhe s’doja t’i shihja lotët dhe dhimbjen e tim atë nga dëshirimi i vëllait që e deshi aq shumë. Të gjitha këto nuk ishin çmalle për familjaret si dikur, por zëvendësoheshin në vuajtje të zemrës sime që më bënin të vdes për së gjalli.

Semestri i parë mbaroi shumë shpejt. Erdhi koha për provime. Ambiciet për nota të larta ishin tretur dhe këto

ambicie ishin mundur nga dhembja e shpirtit dhe urrejtja e madhe që ishte krijuar, në mes të babait dhe vëllait të tij. Tani më ëndërroja që qoftë edhe për herë të fundit të jetës sime, t’i shihja të gjithë bashkë si dikur... Jetoja për këtë ëndërr. Por si të gjeja një shkas i cili do mundë t’i mblidhte në një kulm të vetëm të gjithë bashkë. Të harronin fjalosjet dhe mosmarrëveshjet që kishin. Mendova gjatë dhe më shkoi në mendje vetëm një zgjidhje. Ndoshta diplomimi im do të ishte arsyeja më e fortë, që për një moment të vetëm do të ishin gjithë bashkë. Kështu ëndrra e dikurshme për diplomim, e cila kishte mbetur e vetmuar, pa ëndrrat dhe ambiciet e tjera të shumta studentore, më jepte shpresë për të vazhduar tutje. Ndërkaq ambiciet për nota të larta pothuajse ishin tretur, jo pse më s’i doja, por sepse doja që sa më shpejt të vinte koha kur do të diploma. Sepse tani mendoja që deri në kohën time të diplomimit urrejtja që kishin do të zbutej, e bashkë me kohën do të rikthehet sërish ideja për një jetë normale dhe, për nder të diplomimit tim, në shtëpinë time do të jemi të gjithë së bashku duke festuar. Ndonëse ishte shuar ambicia për të qenë bursist, tani më ëndrra për të diplomuar, edhe pse s’ishte si dikur, rezultoi me sukses. Për nder të diplomimit tim, pas pothuajse 3 viteve sërish, i shihja bashkë të gjithë. Ndërsa tani jeta ka më shumë kuptime, kurse ëndrra për të cilën jetoja dhe u mundova gjatë tërë jetës sime studentore u bë realitet. ■



**Intervistë me shefin e Sektorit të Departamentit të Rinisë, në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Burim Mexhuani**

## **TË RINJTË DUHET TË JETË PRIORITET PËR QEVERINË**

**Burim Mexhuani thotë se Departamenti i Rinisë bën kërkesë të vazhdueshme për rritjen e buxhetit nga Qeveria**

**Intervistuan: Albana ZENELI & Shkurte KQIKU**

**S**hefi i Sektorit të Departamentit të Rinisë, në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Burim Mexhuan, në një intervistë për revistën "Paqja" thotë se problemi i zhvillimit të të rinjve qëndron në lidhje me themelimet e shërbimeve përkatëse për të rinj, të cilat janë të natyrës financiare, të burimeve njerëzore dhe të vetëdijesimit të të rinjve. Pavarësisht se njëra nga strategjitë e departamentit të rinisë është promovimi i vlerave të të rinjve jashtë vendit, mbështetje të cilën Majlinda Kelmendi kishte pohuar se nuk e ka gjetur, Mexhuani theksoi se me këtë çështje merret ekskluzivisht Departamenti i Sportit.

**PAQJA: Cilat janë programet për të implementuar strategjitë e departamentit të rinisë?**

**MEXHUANI:** Për të implementuar programin e Qeverisë në Kosovë, mandat i Ministrisë për sektorin e rinisë është: që të zbatojë strategjinë dhe planin e punës për sektorin e rinisë në kuadër të kornizës së buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe në konsultim me donatorët dhe me agjencitë ndërkombëtare si dhe me institucionet lokale.

**PAQJA: Njëra nga strategjitë e departamentit të Rinisë është që t'u ndihmojë të rinjve që kanë probleme shëndetësore. Cila është forma që implementoni për t'u ndihmuar të rinjve me probleme shëndetësore ?**

**MEXHUANI:** Problemet në lidhje me themelimin e shërbimeve përkatëse për të rinjtë janë të natyrës financiare, të burimeve njerëzore dhe të vetëdijesimit të të rinjve. Buxheti i ulët për kujdesin shëndetësor e vështirëson problemin edhe më shumë, meqë as shërbimet shëndetësore ekzistuese në Kosovë nuk janë në gjendje të trajtojnë nevojat e të rinjve. Parandalimi është mënyra më e mirë për t'u shmangur shpenzimeve të larta të trajtimit. Në mes të tjerash

funksionon komisioni ndërministror për çështjet e shëndetit të të rinjve. Këto programe për edukim shëndetësor dhe parandalim janë në pajtueshmëri me nevojat e identifikuara të rinisë kosovare, me politikat e institucioneve kosovare dhe në përputhje me politikat rinore evropiane.

**PAQJA: Ministria juaj ka premtuar se do të mbrojë dhe promovojë interesat e të rinjve të Kosovës. Sa janë të mbrojtur interesat e të rinjve nga ky departament?**

**MEXHUANI:** Departamenti i Rinisë, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka si mision: fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathëtsive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale të të rinjtë.

**PAQJA: Sa janë duke u promovuar vlerat e të rinjve jashtë vendit?**

**MEXHUANI:** Departamenti i Rinisë ka përkrahur dhe do të përkrahë financiarisht organizatat rinore për projektet që promovojnë iniciativa rinore dhe të cilat kanë për qëllim të ngritin kapacitetet, kooperimin dhe qëndrueshmërinë afatgjate të tyre si në vend ashtu edhe jashtë vendit.

**PAQJA: Atëherë pse sportistja Majlinda Kelmendi ka pohuar se nuk ka gjetur mbështetje nga departamenti dhe ministria juaj ?**

**MEXHUANI:** Kjo është një çështje që i takon departamentit të sportit. Ministria e Kulturës nuk merret me këto gjëra. Është ekskluzivisht kompetencë e departamentit të sportit.

**PAQJA: Cilat janë format që implementon departamenti i rinisë për t'i aftësuar të rinjtë për punë?**

**MEXHUANI:** Njëra nga format që implementon departamenti i rinisë për t'i aftësuar këta të rinj për punësim është përmes edukimit jo-formal. Përveç kësaj, ekziston edhe programi nga komisioni evropian i quajtur KOSVET 6, përmes të cilit të rinjve në Kosovë u ofrohet



**Burim Mexhuani**

mundësia për hapjen e bizneseve të vogla në mënyrë që ata të jenë vetë ndërmarrës, programi për punësim sezonal të rinjve jashtë shtetit dhe, po ashtu, ekziston edhe nga komponentët e Bankës Botërore për Ndërmarrësi, për të rinjtë.

**PAQJA: A ka strategji për rreth 30 mijë të rinj të cilët i bashkëngjiten tregut çdo vit?**

**MEXHUANI:** Në një vend siç është Kosova, ku papunësia e rinisë është në shkallë të lartë, të rinjtë duhet të konsiderohen si burim i zhvillimit ekonomik. Prandaj qeveria duhet të krijojë mekanizma për të siguruar që të rinjtë të jenë të përfshirë në strategjinë e zhvillimit ekonomik dhe çështjet rinore të jenë prioritet. Për ta avancuar dhe reformuar këtë qëllim, Ministria e Kulturës do të nxisë bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore dhe qeverisë, përkatësisht ndërmjet të gjithave ministrive, veprimtari e cila lidhet me rininë si dhe ndërmjet organizmave qendrore dhe atyre komunale, për të fuqizuar programet e politikave rinore.

**PAQJA: Sa është buxheti që Ministria e Kulturës ndan për departamentin e rinisë?**

**MEXHUANI:** Buxheti i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit për departamentin e rinisë është rreth 700 mijë euro.

**PAQJA: A mjafton kjo shumë e ndarë nga ministria e kulturës për departamentin e rinisë?**


**MEXHUANI:** Një shumë e tillë nuk është e mjaftueshme për departamentin e rinisë pasi që nevojat dhe kërkesat e të rinjve janë duke u rritur çdo ditë e më shumë. Është e pamundur me një shumë të tillë të mbulojmë interesat e tyre, edhe pse të rinjtë duhet të konsiderohen si burim i zhvillimit të vendit.

**PAQJA: Atëherë pse nuk bëni kërkesa për rritjen e buxhetit të këtij departamenti, kur dihet se 70 për qind e të rinjve janë të papunë?**

**MEXHUANI:** Ekziston një kërkesë e vazhdueshme e departamentit të rinisë që të shtohet buxheti për këtë departament. Mirëpo është çështje e prioritetëve të rinisë dhe si i tillë buxheti i Kosovës implikon edhe shumë financiare që ndahet për departamentin e rinisë. ■

Reflektim

## "Dyshimi Kartezian"



**Albion SHERIFI**

**S**i një filozofi e re, moderne e themeluar dhe e artikuluar nga filozofi francez Rene Dekarti, "Dyshimi Kartezian" paraqet tablonë e subkoshiençës labile në perceptimet e asaj që duket qartësisht e sigurt dhe e vërtetë. Kjo nuk hedh anash arsyen dhe as fuqinë njohëse të njeriut, mirëpo si sentiment primar të qëndrueshmërisë racionale ka mendimin, i cila paraqitet në këtë filozofi, sipas thënies "Cogito, ergo sum" - (Mendoj, pra jam).

Dekarti operon me vetëdije të plotë mbi pasigurinë e vetëdijes dhe flak absolutizmin njohës në rrethanat e së vërtetës.

Pa dyshim, kjo ka efektin pozitiv, ngaqë avancojnë njohjen, forcon shtresën kuptimore të së vërtetës, karshi të vërtetës së akceptuar përgjithësisht si absolute, e cila nën mëngët e saj ka lajthitje dhe sforcime esenciale.

Në metodën e pranimi objektiv të një esence të sforcuar, hasim në rrëshqitjen graduale nga subjektivizmi i trajtimit të atij pranimi dhe njëherësh edhe në "kalimin cilësor" në rrafshet e fuqisë njohëse të individit.

Në këtë mes, kjo pikëpamje ngjan utilitare, gjegjësisht si një alienim i "dyshimit kartezian" si utilitar, çka realisht plotëson konditat e të qenit në këtë frymë, ngase hyn në subjektivitetin pranues të mendësisë racionale dhe kjo

natyrshëm është utilitare për individin, pra një pranim i arsyeshëm dhe dobia e mendimit/pranimi të së vërtetës, duke u bazuar në arsyeshmëri.

Pa u futur thellë në semantikën e thënies "Cogito, ergo sum", qartësisht mund të sintetizojmë mendimin se aty bëhet një ndarje e skepsës së bazuar në fuqi njohëse, e cila si filozofi e Dekartit është e qëndrueshme dhe skepsës e cila demobilizon kreacionin e sforcuar të pranimi absolutist të së vërtetës, pa dyshim e ngritur si fillësë racionale për njohjen e qëndrueshme dhe të sigurt të vetëdijes mbi objektin, subjektin dhe gjithçka që si bazë ka rezistencën e mbështetur në racionalitet.

Tani, mund të themi se kemi bërë një sinkretizëm në kuadrin e një thënie si kjo e Dekartit, e cila është shumë-dimensionale në format e ndryshme të interpretimit.

"Dyshimi Kartezian" shemb holizmin dhe fetishizimin e pranimi të papërpunuar të së vërtetës dhe natyrisht ngre intencën e "mendjes së papërpunuar", gjegjësisht pranimi të papërpunuar të një të vërtete, gjithmonë duke u mbështetur në substratin e arsyeshmërisë së Dekartit - "dyshimit kartezian".

Ekzaktësia e "dyshimit kartezian" paraqet fillimin e trajtimit racionale të së vërtetës dhe natyrisht edhe krijimin e një mendësie të "avancuar" të pranimi të së vërtetës së rafinuar. ■



# BESOJ NË FILMIN VENDOR

**Astrit Alihajdari, aktor filmi, sapo ka mbaruar xhirimet në filmin e Agim Sopit “Agnus Dei”. Ai tani ka filluar përgatitjet për të luajtur në filmin e regjisorit kosovar Ernest Mehulli. Filmi do të luhet në gjuhën angleze, ndërsa Alihajdaraj do të luajë rolin kryesor**

**Naser SHATROLLI**

**A**strit Alihajdaraj vjen në Kosovë nga një përvojë ndërkombëtare, ai shkolluar për shirit filmik në Vjenë, një figurë jo edhe aq e njohur për komunitetin vendor, por angazhimi i tij në filmin e fundit “Agnus Dei” të Agim Sopit, në të cilin bart peshën e “fajit dhe të pafajësisë së rolit”, do të bëhet një emër i rëndësishëm edhe për kinematografinë vendore. Për Alihajdarajn, kjo ka qenë eksperiencia e tij e parë në një film shqiptar, në një ambient me ushqim tërësisht tradicional ndryshe nga përvojat e tij evropiane. “Unë kam luajtur në disa filma ndërkombëtarë dhe kam pasur role me peshë, por ky film është i pari që e kam pasur rolin bartës”, - shton Alihajdaraj. Sa i përket dallimeve dhe mundësive që kinematografia vendore të ofrojë karshi asaj evropiane, Alihajdaraj shpjegon: “Në përgjithësi bota filmike dhe krijuesit që do të merren me filmin është nocion specifik për vetë natyrën e krijuesve këtu e atje”. Filmi është shndërruar në industri interesi, të cilën nuk është lehtë për ta përballuar një shtet i varfër siç është Kosova. Edhe pse popujt (përfaqësuesit e filmit) tentojnë që të flasin një gjuhë në ekran, megjithatë në përfundim punohet

shumë, është Evropë fundja, sqaron aktori nga Vjena. Ndërkohë roli që ky aktor shqiptar ka luajtur tek “Agnus Dei” është një serb (personazh me virtyte të përziera) që ka gjak të përzier. “Ky ka qenë roli më intrigues për mua, për faktin se unë si shumë njerëz tjerë kam pasur një konflikt timin personal dhe profesional”. Ideja e këtij roli është koncept gjithënjëzësor, nis në antikë dhe mund të përsëritet si fenomen edhe në kohë moderne. Pra, linja dramaturgjike do të përkojë me linjat e rrjedhave ndërnjerëzore edhe tek këta dy popuj. Ndërsa në lidhje me raportet ose polarizimet e ndërsjella të këtij aktori me aktorët e Kosovës në sheshin e xhirimit, për Alihajdarajn, kjo ide ngelet koncept utopik. “Jam ndjerë krenar dhe falënderues që më është mundësia për të qenë në mesin e aktorëve vendorë, të cilët kishin një energji të pashtershme për filmin”. Alihajdaraj, këto ditë, ka filluar të punojë rreth skenarit të regjisorit Ernest Mehulli dhe diku më 10 qershor do t’i fillojnë xhirimet e këtij projekti të metrazhit të gjatë në Holandë. Regjisorit në fjalë, është i interesuar që të angazhojë mbase dhe aktorë të tjerë, - thotë Alihajdaraj. Alihajdaraj, përveç të tjerash, është nominuar ndërkombëtarisht për realizime

rolesh dhe ka vjelë çmime me valuta artistike. Si duket ylli i tij po rrugëton drejt portave ndërkombëtare. Në lidhje me dhuntinë dhe konceptin “Star”, ai thekson: “Unë besoj në punë”, edhe pse shkollimi në Vjenë, atij i ka dhënë shanse për të zgjedhur role. Në vitin 1999 ka filluar karrierën e tij në filmin “Nordrand” të regjisores Barbara Albert, film me të cilin ka marrë pjesë në festivalin e Venedikut. Që nga ai projekt, Alihajdaraj i janë hapur portat magjike për filmin artistik, atë televiziv, për seriale dhe për teatër. Disa nga projektet e tij në shirit dhe forma të tjera janë: “Balkan Traffic” i regjisorit gjerman Markus Stein, “Tatorit” të regjisorit Nicolaus Leytner, “Der Taeter” e regjisorit Michael Kreihsel. Ndërsa në filma dhe seriale televizive ka pasur këto angazhime: “Kommisar Rex”, “Soko Wien” “Schnell Ermittell” “Lottosieger” etj.

Për fund, ai në formë mesazhi do të shprehë: “E çmoj Terezin për faktin se kam luajtur në shqip, anglisht, gjermanisht, spanjisht, serbokroatisht”. Përveç të tjerash për angazhimin në gjuhën shqipe, Alihajdaraj iu falënderua sinqerisht Agim Sopit. “Ndihem i nderuar përderisa ma besoi këtë rol kaq me peshë.” ■



# PREMTIMI U BË REALITET, MAJLINDA MBRON NGJYRAT E KOSOVËS

**“Ish-ministrat e përparshëm kanë premtuar dhe ato premtime nuk janë realizuar, por kanë mbetur vetëm fjalë. Ministri Memli Krasniqi, është i vetmi ministër që premtimin e bëri realitet në praktikë dhe kjo ishte bindëse që unë të refuzoja ofertën e Federatës së Azerbajxhanit”, - ka thënë xhudistja Majlinda Kelmendi**

**Alban BILALLI**

**K**ampionia e Botës dhe e Evropës në xhudo për juniore, Majlinda Kelmendi (52 kg) ka vendosur që të garojë për Kosovën, duke refuzuar ofertën e majme nga Azerbajxhani. Këtë vendim Majlinda e mori pas takimit që pati me ministrin e sportit Memli Krasniqin. Ajo është shprehur mjaft e lumtur që ministri Krasniqi e ka mbajtur premtimin për mbulimin e të gjitha shpenzimeve për pjesëmarrje në garat ndërkombëtare. “Ish-ministrat e mëparshëm kanë premtuar dhe ato premtime nuk janë realizuar, por kanë mbetur vetëm fjalë. Ministri Memli Krasniqi, është i vetmi ministër që premtimin e bëri realitet në praktikë dhe kjo ishte bindëse që unë të refuzoja ofertën e Federatës së Azerbajxhanit”, -ka thënë Majlinda Kelmendi.

Mjaft i lumtur është shprehur edhe trajneri i Majlindës, Dritan Kuka, për ndihmën e madhe që po i jep ministria

nxënëses së tij. “Janë ditët më të mira të karrierës sime që po përjetoj, pasi bashkë me nxënësen time po e dimë se do të vazhdojmë ta përfaqësojmë vendin tonë”, - tha Kuka.

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Memli Krasniqi është shprehur se ndihet mjaft i lumtur që ministria që ai drejton do ta mbështesë Majlindën. “Kemi gjetur mundësi që si ministri, pra në mënyrë institucionale, së bashku me sektorin privat e donatorë privatë, t’i mbulojnë shpenzimet e saj e të Federatës së Xhudos të Kosovës për pjesëmarrjen në çdo garë ndërkombëtare”, - ka thënë ministri Krasniqi. Më tej, ministri Krasniqi ka shtuar se është krenari që Majlinda garon për Kosovën dhe i ka uruar asaj suksese të mëtutjeshme. “Majlinda na ka bërë të gjithë neve në Kosovë të ndihemi mirë sa herë që ajo merr pjesë në gara ndërkombëtare. Është nder për gjithë Kosovën që e ka Majlindën në mesin e tetë garuesve më të mira në ranglistën olimpikë. E përgëzoj për të gjitha

të arriturat e saj dhe i uroj suksese të mëtutjeshme”, - shtoi ministri Krasniqi.

**Azerbajxhani mbeti me “gishta në gojë”!**

Nga mosinteresi i institucioneve të Kosovës, për të ndihmuar financiarisht Majlinda Kelmendin, ishte Azerbajxhani i cili u mundua të përfitonte nga kjo neglizhencë e institucioneve tona. Federata e xhudos e Azerbajxhanit, i kishte bërë një ofertë të majme Majlinda Kelmendit dhe trajnerit të saj Dritan Kuka. Nëse Majlinda dhe trajneri i saj do ta pranonin ofertën e Azerbajxhanit, ata do të përfitonin nga pesë mijë euro në muaj. Kurse në rast fitoreje të medaljes së art në lojërat olimpikë, Majlinda do përfitonte 2 milionë euro, për të argjendtën 1.5 milion dhe 1 milion për medalje të bronzte. Mirëpo falë angazhimit konkret të ministrit Krasniqi, Majlinda Kelmendi ka vendosur që përfundimisht të garojë për Republikën e Kosovës. Adios Azerbajxhan! ■